

Gratë, Paqja dhe Siguria

E nisën nga zero

Burrat për gratë

Faktet mbi gratë në paqe dhe siguri

72

#09

dhjetor 2024



Za

Faqja e revistës së këtij numri del në kopertinë me një grua, e cila me fuqinë e saj sovrane të dukeshës lufton kundër përdorimit të përdhunimit si armë luftime, krahas mbështetjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale nga zonat e konfliktit.

Revista "Za" mbështetet nga:



Ky publikim është realizuar me mbështetjen e projektit "Mbështetje për Shoqërinë Civile në Kosovë - KSV/025", financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe implementuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Jahjaga Foundation dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Redaktore:

Jeta Abazi Gashi

Autorë:

Nora Nimani Musa
Diona Hoxha
Arif Muharremi
Bleona Hajdari
Hana Morina

Autorë kontribues:

Lauren Lowe

Dizajni dhe ilustrimet:

2vo

Të drejtat e autorit © 2024 Fondacioni Jahjaga.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklarata e lejimit: Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë dhe me asnjë lloj mjeti, elektronik ose mekanik, pa leje me shkrim të lëshuar nga Fondacioni Jahjaga.

<i>gratë, paqja dhe siguria</i>	4
Letra nga redaksia	6
Solidariteti ndëretnik për ruajtjen e paqes	10
Nura në shërbim ushtarak	14
Shqipja e Kosovës	18
Dorë për dorë me të mbijetuarit	22
Në luftë për të drejtën	26
Hafizja në Siguri Kibernetike	28
Fitorja e Arbnorës	30
Një sakrificë si kjo e Besianes	34
Adresa e Sigurisë	36
<i>e nisën nga zero</i>	38
Liria, parakusht i paqes	39
Igo kundër stigmës	42
Gruaja që nuk hoqi dorë nga e drejta për dije	46
Siguria në duart e Afërditës	51
Ndërtimi i paqes përmes edukimit	55
Përpjekjet e Albulenës për një drejtësi më të mirë	58
Drita e guximit dhe drejtësisë	63
Flutura për lirinë e medias në Kosovë	66
Një jetë në shërbim të komunitetit	71
<i>burrat për gratë</i>	74
Historitë e pavdekshme të "Syrit të Tretë"	75
Burimi, një rrëfim mbështetje dhe dashurie	80
<i>faktet mbi gratë në paqe dhe siguri</i>	82



za | Gratë, Paqja dhe Siguria

Kjo temë është duke përjetuar një triumf të madh në mbarë botën. Tema e rëndësia e saj, në Shtetet e Bashkuara, Evropë, e Australi, ndonëse jo me fuqinë e njëjtë, tashmë është aktualizuar edhe në Kosovë. Kjo temë mbështetet nga miratimi zyrtar i Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (UNSCR 1325), e aprovuar tash e 24 vjet.

Profilet e grave të përzgjedhura në këtë rubrikë përfshijnë gra që i portretizon guximi, që kanë treguar forcë dhe qëndresë, si në vendin e tyre ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Pra, gra, që kanë kontribuar para, gjatë dhe po punojnë për të ardhmen e paqes dhe sigurisë së Kosovës. Kontributi i tyre vazhdon me vendosmëri përballë sfidave të tjera, si në terrenin fizik ashtu edhe në atë digjital.

Këto gra që kanë shfaqur guxim dhe nuk kanë pranuar të njohin kuptimin e dorëzimit, duke kundërshtuar nacionalizmin dhe duke luftuar krah burrave, sot, me krenari, mund t'i quajmë gratë e mbrojtjes dhe paqes. Ushtarë, kadete, police dhe prokurore, e kështu me radhë. Gra që e bëjnë mbrojtjen dhe paqen.



Të dashura vajza të reja dhe grua të Kosovës,



*Maria Teresa dhe nëna e saj
©Koleksioni privat i Dukeshës së Luksemburgut.*

Po ju drejtohem sot me plot emocion dhe admirim të sinqertë. Ju tani jeni në një moment kyç të jetës suaj, ku zgjedhjet që bëni dhe ëndrrat që ndiqni do t'i japin formë jo vetëm të ardhmes suaj, por edhe asaj të komunitetit tuaj dhe mbarë botës. Nëpërmjet kësaj letre, dëshiroj të ndajë me ju pak nga rrugëtimi im, t'ju inkurajoj nga zemra dhe t'ju nxis të besoni në aftësitë tuaja dhe në fuqinë e bindjeve tuaja.

Që nga fëmijëria kam qenë e etur për t'iu shërbyer të tjerëve. Kjo dëshirë më kishte lindur nga vetëdija se bota rreth meje shpesh ishte e mbushur plot me padrejtësi dhe vuajtje, e unë doja të ndihmoja në çrrënjosjen e tyre. Që në moshë të re, më motivonte ideja për të sjellë dritë në errësirë dhe për t'ua zgjatur dorën atyre në nevojë. Kjo ndjenjë empatie dhe përkushtimi m'u kthye në një mision të përjetshëm, një vizion që e kam ndjekur me pasion dhe vendosmëri.

Kujtoj kohën kur vija studimet e shkencave politike si një moment vendimtar në rrugëtimin tim për të kuptuar dinamikën që formëson botën tonë. Këto vite më mundësuan të zhvillojë një kuptim më të thellë të mekanizmave të pushtetit dhe proceseve të ndryshimeve shoqërore. Gjatë kësaj periudhe mësova se angazhimi në emër të tjerëve e ka me patjetër përvetësimin e njohurive, kërkimin e zgjidhjeve inovative dhe respektimin e diversitetit kulturor dhe social. Aty mësova rëndësinë e edukimit dhe informimit në arritjen e qëllimeve humanitare.

Më pas, një ditë, jeta ime mori një kthesë që nuk e kisha paramenduar kurrë: u martova me trashëgimtarin e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, u bëra Princeshë, dhe pastaj Dukeshë e Madhe. Në këtë rol të ri, e gjeta veten në një pozitë unike, ku kisha mundësinë që të përdorja zërin tim për të avokuar për kauzat që i kisha për zemër dhe për t'i vënë në pah zërat e atyre që

jo gjithmonë kishin pasur një mundësi të tillë. Nëpërmjet këtij roli, kuptova se jeta nuk ka të bëjë thjesht me atë që mund të bëjmë për veten, por me atë që mund të bëjmë për të tjerët. M'u bë e qartë se duhej t'i kushtoja energji dhe kohë mbështetjes së grupeve më të cenueshme, veçanërisht grave dhe fëmijëve, të cilët, në shumë raste, janë viktimat e para të padrejtësive në botë.

Po ua them këtë sepse dua që ta dini se pavarësisht se nga vini dhe pa marrë parasysh rrugëtimin juaj, është gjithmonë e mundur t'i realizoni ëndrrat dhe t'i ndiqni bindjet tuaja. Kurrë s'më kishte shkuar mendja se do të bëhesha Dukeshë e Madhe ose të takoja figura frymëzuese si Profesor Yunus apo Dr. Mukwege, dy burra që ia kanë kushtuar jetën e tyre mbështetjes së atyre që janë më në nevojë. E megjithatë, me pasion dhe përkushtim, jeta m'i ka dhënë këto mundësi. Për këtë arsye ju inkurajoj të besoni në aftësitë tuaja dhe të mos e nënvlerësoni kurrë rëndësinë e ëndrrave tuaja.

Roli im si Dukeshë e Madhe ma ka mundësuar të ngre zërin dhe ta përdor këtë privilegj për të avokuar për gjendjen e personave të cenuar. Rrjedhimisht, në vitin 2019, u bëra bashkëthemeluese në shoqatën Stand Speak Rise Up!, një nismë kushtuar luftës ndaj përdorimit të përdhunimit si armë lufte dhe mbështetjes së të mbijetuarve të dhunës seksuale në zonat e konfliktit. Ky mision lindi nga bindja e thellë se dhuna seksuale është një instrument terrori dhe shkatërrimi që duhet luftuar me vendosmërinë më të madhe.


Shoqata Stand Speak Rise Up! punon jo vetëm për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për viktimat përmes mbështetjes ekonomike, rimëkëmbjes psikologjike dhe

rrugëtimin të tyre për drejtësi, por, edhe për të ndihmuar në riintegrimin e tyre në strukturën e komunitetit nga i cili janë përjashtuar. Ne si shoqatë përqipemi të ngrisim zërin e tyre në forumet ndërkombëtare dhe të avokojmë për ndryshime legjislative dhe të politikave që sigurojnë drejtësi dhe mbrojtje. Një pjesë thelbësore e punës sonë është edhe njohja dhe mbështetja e fëmijëve të lindur nga përdhunimet e luftës. Këta fëmijë, shpesh të stigmatizuar dhe të privuar nga të drejtat themelore, kanë nevojë për vëmendje të veçantë për të garantuar dinjitetin dhe të ardhmen e tyre. Lufta për njohjen e tyre është thelbësore, pasi vetëm kështu mund të zënë vend në shoqëri dhe të kenë mundësi të barabarta, pavarësisht tmerreve që kanë përjetuar që në lindje.

Siç e përmenda më parë, gjatë rrugëtimin tim më ka rastisur të takoj figura frymëzuese që kanë formësuar thellësisht botëkuptimin tim. Në mesin e këtyre takimeve ishte ai me Maggy Barankitse në Burundi, guximi dhe përkushtimi i së cilës për t'i shpëtuar fëmijët në rrezik më preku thellë. Nga takimi me profesorin Yunus, bankierin e të varfërve, kam kuptuar për dinjitetin që gratë mund ta arrijnë nëpërmjet mikrokredive dhe Dr. Denis Mukwege më ka bërë të kuptoj qëndresën dhe forcën e jashtëzakonshme të të mbijetuarve të dhunës seksuale. Këto takime, veçanërisht me të mbijetuarit, më kanë mësuar se edhe përballë sfidave në dukje të pakapërcyeshme, vendosmëria, solidariteti dhe përkushtimi mund ta transformojnë jetën dhe të sjellin ndryshime të rëndësishme.

Këto figura të shquara, së bashku me shumë të tjera, ma kanë dëshmuar se angazhimi humanitar dhe lufta





"Nëpërmjet këtij roli, kuptova se jeta nuk ka të bëjë thjesht me atë që mund të bëjmë për veten, por me atë që mund të bëjmë për të tjerët"

për drejtësi janë përpjekje kolektive. Guximi i tyre ka shërbyer si frymëzim për mua dhe jam e bindur se në mesin tuaj, në Kosovë, ka gra të reja me forcë të ngjashme, të gatshme për t'u ngritur, për të besuar në një të ardhme më të mirë dhe për të luajtur një rol aktiv në ndryshimin e komuniteteve të tyre. Ju jeni trashëgimtare të një tradite guximi dhe qëndrese që kapërcen kufijtë dhe sfidat.

Gjithashtu dua të theksoj rëndësinë e njohjes së vetvetes dhe të asaj që ju motivon vërtet. Duke e dëgjuar zërin e brendshëm dhe duke i kuptuar vlerat tuaja, vetëm kështu mund të trasoni një rrugë që vërtetë lidhet me atë që jeni dhe atë që synoni. Secila prej jush zotëron një dritë unike dhe një forcë të brendshme që mund të ndikojë pozitivisht në botën përreth jush. Duke dëgjuar këtë zë të brendshëm, do ta zbuloni se çfarë është me të vërtetë e rëndësishme për ju dhe se si mund të kontribuoni në mënyrën tuaj për ta bërë botën tonë më të drejtë dhe më të barabartë.

Ju bëj thirrje që të mos dekurajoheni nga sfidat që i hasni gjatë rrugës. Rruga drejt realizimit të ëndrrave tuaja mund të jetë e mbushur me pengesa dhe është normale të përjetoni momente dyshimi dhe vështirësie. Megjithatë, çdo pengesë është gjithashtu mundësi për të mësuar dhe për t'u zhvilluar. Asnjëherë mos lejoni që dikush t'ju bindë se ëndrrat tuaja janë të pamundura ose që aspiratat tuaja janë të parëndësishme. Brenda jush keni potencial për të realizuar gjëra të jashtëzakonshme, për ta transformuar komunitetin tuaj dhe, pse jo, për të ndikuar në tërë botën. Çelësi është të qëndroni besnik ndaj vetes dhe t'i ndiqni bindjet tuaja me vendosmëri.

Sot, më shumë se kurrë, gratë e reja duhet të jenë në qendër të ndryshimeve shoqërore dhe politike. Roli juaj

është thelbësor në formësimin e së ardhmes. Ju ftoj të krijoni një lidhje simotrash mes jush, të mësoni nga njëra-tjetra dhe ta mbështesni njëra-tjetrën. Së bashku, mund t'i kapërceni pengesat dhe të krijoni komunitete më të forta, dhe më të drejta.

Lëvizja feministe sot tregon se të gjithë jemi të bashkuar në këtë luftë për drejtësi dhe barazi. Pavarësisht a jetoni në Kosovë, Afganistan apo gjetkë, përvojat tuaja kanë si pikëprerje një rrugëtim i përbashkët për respekt dhe dinjitet. Duke i mbështetur të tjerët, ju jo vetëm që kontribuoni në mirëqenien e tyre, por edhe në vet zhvillimin tuaj.

Si vajza dhe gra të reja në Kosovë, e keni një rol vendimtar në formësimin e së ardhmes së vendit tuaj. Ju jeni shpresa e së nesërme, jeni ato që mund të ndërtojnë një të ardhme më të drejtë, më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse. Zëri juaj ka rëndësi, veprimet tuaja janë të rëndësishme dhe së bashku mund të arrini gjëra të jashtëzakonshme. Qoftë nëpërmjet edukimit, vullnetarizmit, aktivizmit apo solidaritetit, ka shumë mënyra përmes të cilave zëri juaj mund të dëgjohet dhe kështu të bëni ndryshime domethënëse në rrethin ku jetoni.

Së fundi, do të doja të theksoja rëndësinë e dashurisë dhe dhembshurisë në çdo gjë që bëni. Dashuria për të tjerët, mirëkuptimi dhe respekti për dallimet janë themelet mbi të cilat mund të ndërtojmë një botë më të mirë. Jam e bindur se dashuria i kapërcen krejt kufijtë dhe mund të shërojë plagët edhe më të thella. Duke e kultivuar këtë dashuri dhe dhembshuri në ndërveprimet tuaja me të tjerët, ju do të ndihmoni në ndërtimin e një të ardhmeje të mbushur me paqe dhe solidaritet.



Të dashura vajza dhe gra të reja të Kosovës, unë besoj shumë në ju. Ju keni rreth vetes shembuj të shquar suksesi dhe ndryshimesh pozitive, si presidentja Vjosa Osmani-Sadriu dhe ish-presidentja Atifete Jahjaga, të cilat vërtet janë burime frymëzimi. Unë besoj në potencialin tuaj, në ëndrrat tuaja dhe në aftësinë tuaj për ta transformuar këtë botë. Rruga mund të mos jetë gjithmonë e lehtë, por është shumë e rëndësishme të jeni këmbëngulëse. Vazhdoni të besoni në veten tuaj, ndiqni pasionet tuaja dhe luftoni për atë që besoni. Vetëm kështu do ta gjeni lumturinë e vërtetë dhe do të lini gjurmë të përhershme në këtë botë.

Me gjithë mbështetjen time, admirimin tim më të thellë dhe me plot inkurajim të singërtë,


Maria Tereza

Dukeshë e Madhe e Luksemburgut
Presidentë dhe Themeluese e Stand Speak Rise Up!
Presidente e Fondacionit të Dukës së Madh dhe Dukeshës së Madhe





Solidariteti ndëretnik për ruajtjen e paqes



Bashkimi kundër shtypjes së përbashkët shpesh lind nga nevoja. Solidarizimi me ata të cilët nuk ndani identitet të njëjtë është zgjedhje e qëllimshme – zgjedhje që mund të çojë në marginalizimin apo edhe përjashtimin tuaj nga komuniteti ku jetoni e veproni. Megjithatë, ka individë që i mbrojnë të drejtat e të shtypurve, edhe kur pushteti autoritar

është mu nga radhët e tyre. Sonja Biserko, aktiviste e famshme për paqe nga Serbia, është mishërim i këtij guximi. Ajo ka avokuar për drejtësi dhe të drejtat e njeriut edhe kur kjo binte ndesh me shtetin ku ka lindur.

Sonja ka lindur në Beograd në vitin 1948. Gjatë fëmijërisë së saj, ajo e përjetoj Jugosllavinë përmes një sërë

vlerash ku kërkohet solidarizim dhe drejtësi për të gjithë. E rritur në një familje antifashiste dhe jugosllave, ideja e solidaritetit dhe përgjegjësisë së përbashkët ndikoi thellë në botëkuptimin e saj. Ajo përqafoi një imazh të botës, në të cilin të drejtat e njeriut janë për të gjithë dhe u përkasin të gjithëve, dhe e tejkalojnë racën, përkatësinë etnike, orientimin seksual, fenë, klasën dhe ideologjinë. Si e tillë, përkatësia e saj bazohet në vlera, në vend që të formësohet nga një kombësi e caktuar.

“Identiteti im është goxha i fortë. Përkatësia ime në këtë identitet është në fakt një ide. Nuk është shteti, por është në të vërtetë ideja dhe vlerat me të cilat jam rritur”, pohon Sonja në fillim të intervistës sonë.

Sonja, 76-vjeçare, me më shumë se dyzet vjet përvojë, thotë se e kishte përjetuar një ndjenjë të “përkatësisë në botë”, botë kjo e cila për të nuk kishte kufij.

Autore e librave *“Shpërthimi i Jugosllavisë – Joshja fatale e nacionalizmit serb”, “Serbia në orient”, “Formimi i konspiracionit antijugosllav”, “Serbia e humbur në tranzicion”,* dhe e artikujve të shumtë, Sonja ka pasur fatin t’i gëzojë përfitimet e sistemit arsimor. Ajo kishte qasje në literaturën bashkëkohore nga e gjithë bota dhe ishte dëshmitare e valëve të aktivizmit studentor ku avokohej për të drejtat civile. Pas mbarimit të arsimit fillor dhe të mesëm në Beograd, ajo vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Beogradit ku u fokusua në disiplinën e Ekonomisë. Njohuritë që i mori gjatë studimeve në universitet mbi situatat socio-politike dhe ekonomike të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ), nxitën interesimin e saj për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci.

Me frymën e aktivistes dhe analistes politike, e cila i kuptonte strukturat politike, ekonomike dhe sociale të shoqërisë, ajo filloi karrierën e saj profesionale si diplomate e Jugosllavisë. E kaloi pjesën e parë të karrierës së saj duke shërbyer në Londër dhe Gjenevë. Në Gjenevë, e cilësuar shpesh si “shtëpia e të drejtave të njeriut”, Sonja ishte dëshmitare e drejtpërdrejtë e punës së organizatave dhe institucioneve të cilat punonin për të drejtat e njeriut, barazinë, drejtësinë sociale dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

“I kam kaluar ca vite të mira në Gjenevë, gjë që më ka ndihmuar të zgjerojë horizontet e mia për sa i përket të drejtave të njeriut.”, thotë Sonja.

Megjithatë, Sonja dha dorëheqje nga Ministria e Punëve të Jashtme pas shpërbërjes së Jugosllavisë (pas Konferencës së Hagës të vitit 1991). Ajo nuk donte të shërbente në ministrinë serbe për shkak të politikave të luftës së Slllobodan Millosheviqit dhe dhunës e përjashtimit sistematik në emër të Serbisë së madhe. Kështu, ajo vendosi të ndërpriste shërbimin e saj si diplomate dhe u kthye si aktiviste.

Ajo ishte aktiviste e guximshme që kishte kurajo të kundërshtonte nacionalizmin serb dhe regjimin brutal, i cili kreu gjenocid dhe mizori fillimisht në Bosnje dhe Hercegovinë dhe më pas edhe në Kosovë. Nacionalizmi serb ishte pikërisht pika e kthesës për të.

“Ishte shumë e papritur dhe askush nuk e kishte parashikuar. Nacionalizmi kishte qenë prej kohësh një çështje që po zihet përbrenda, por askush nuk e kishte parashikuar shkallën e asaj që pasoi. Ishte e vështirë të pranohet që dhuna mund të shpërthente kaq papritur”, tregon Sonja gjersa reflekton mbi kalimin e saj nga diplomacia në një jetë kushtuar mbrojtjes dhe avokimit për të drejtat e barabarta të njeriut.

Në intervistat e mëhershme, zonja Biserko e ka përshkruar luftën në

Jugosllavi si brutale, duke thënë: *“Lufta brutale dhe shpërbërja e Jugosllavisë e ndryshoi rrënjësisht jetën time”.* Ajo e bëri këtë koment gjatë një prezantimi si anëtare e seminarit global të Salzburgut vitin e kaluar.

Sonja themeloi Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi në vitin 1994. Kjo organizatë luajti një rol kritik në zbulimin e krimeve të kryera gjatë luftërave në RSFJ dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ky komitet synonte t’i promovonte të drejtat e njeriut dhe demokracinë në Serbi dhe rajon duke avokuar për drejtësi për viktimat, të mbijetuarit, të zhdukurit, familjet që kanë humbur anëtarët e vet, dhe duke luftuar kulturën e mosdëshkimit.

Kur hyni në faqen zyrtare të organizatës, mund të lexoni si vijon:

“Serbia filloi misionin e saj në periudhën kur nacionalizmi vetëm sa nuk kishte arritur kulmin me luftëra katastrofike, spastrim etnik, krime lufte dhe gjenocid në territorin e Jugosllavisë... Që atëherë dhe përmes qindra projekteve, Komiteti është përpjekur ta ekspozojë ideologjinë mbizotëruese të Serbisë – nacionalizmin – dhe, për aq sa është e mundur, të zvogëlojë efektet e tij fatale në fushën e të drejtave të njeriut... Refugjatët dhe pakicat – etnike, fetare, politike – ishin objektivat e para të nacionalizmit serb në terren (...)”



Presidentja e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, znj. Sonja Biserko, në Universitetin SSSU.

Që nga themelimi i saj, organizata ka luajtur një rol kyç në fushën e avokimit për të drejtat e njeriut dhe dekonstruktimin e nacionalizmit serb dhe promovimin e pajtimit në rajon, gjë që është parakusht për paqe. Janë prodhuar mbi 160 libra të cilët kanë karakter edukativ për të rinjtë, gjë që u ndihmon t'i sfidojnë paragjykimet nacionaliste dhe gjithashtu të nxisin një kulturë të përkujtimit. Puna e Komitetit përfshin edhe përpjekjet për revizionizmin historik, dialogun Serbi-Kosovë dhe adresimin e radikalizimit në rajone si Sanxhaku.

Sonja ka punuar në mënyrë aktive përmes konferencave, shkëmbimeve kulturore dhe bashkëpunimeve me shoqërinë civile për t'i normalizuar marrëdhëniet dhe për ta promovuar tolerancën në vijat etnike dhe fetare, duke u angazhuar vazhdimisht për drejtësi dhe dinjitet njerëzor në Ballkan. Sonjës i duhet të punojë shumë; gënjeshtrat për luftërat dhe dëmet e shkaktuara nga Serbia janë aq të përhapura sa që ato pasqyrohen edhe në tekste shkollorë kombëtare.

"Serbia po refuzon të ballafaqohet me të kaluarën! Mënyra se si janë dokumentuar ngjarjet në librat e historisë në Serbi është sikur të kenë dalë nga hiçi. Në një farë mënyre, ata po e minimizojnë rolin e tyre në dhimbjen që e kanë shkaktuar dhe nuk e mbajnë veten përgjegjës për këtë. Përqendrimi në vetë-viktimizim, që shpesh del të jetë narrativë e ngjarjeve, nuk kontribuon në paqen afatgjatë në rajon." - deklaroi Sonja.

Shumë aktivistë si Sonja po ia rikujtojnë vendit të tyre krimet e kryera gjatë luftërave. Disa organizata u deklaruan kundër luftërave gjersa ato po ndodhnin. Gratë në të Zeza, një grup feminist kundër luftërave në Serbi, e ka kundërshtuar fuqishëm nacionalizmin serb, narrativën e viktimizimit dhe agresionin e luftës.



"Presidenti i Kroatis Stjepan Mesić i dhuron medaljen e artë Sonja Biserkos, shkurt 2012"

"Gratë në të Zeza - me të vërtetë i admiroj për guximin e tyre dhe vazhdimësinë e qëndrimeve të tyre kundërshtuese e të forta në të gjitha rastet. Ato janë heroinat e kohës sonë". Edhe pse nuk është zyrtarisht anëtare, Sonja e ka mbështetur dhe ka bashkëpunuar me këtë grup në nisma të ndryshme.

Pavarësisht sfidave dhe kërcënimeve të vazhdueshme me të cilat është ballafaquar ndër vite, ajo mbetet stoike dhe e patrembur përballë vështirësive. Sonja edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë kryetare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi. Në këtë rol, ajo avokon për paqe dhe pajtim edhe përkundër faktit se mund të konsiderohet tradhtare nga vet populli i saj. Përveç punës së saj të pandërprerë kundër nacionalizmit, ajo gjithashtu avokon për të drejtat e grave përmes kanaleve dhe formave të ndryshme.

Gjatë karrierës së saj, Sonja është vlerësuar me disa çmime dhe mirënjohje për sheroizmin e saj (eng: sheroism), një term i krijuar për t'i dhënë ngjyrim feminist akteve heroike, që tradicionalisht janë konsideruar si burrërore.

Sonja Biserko u nderua me Çmimin për të Drejtat e Njeriut të Komitetit të Avokatëve për të Drejtat e Njeriut në Nju Jork në vitin 1994, Çmimin për të Drejtat e Njeriut të qytetit të Weimarit në vitin 2009 dhe Çmimin për të Drejtat e Njeriut nga Universiteti i Oslos në vitin 2010. Ndërsa në vitin 2005, ajo u nominua në kuadër të projektit "1,000 Gra" për Çmimin Nobel të Paqes 2005. Në vitin 2010 shpallet Qytetare Nderi e Sarajevës; kurse në vitin 2013 mori Medaljen e Presidentit Mesic për punën e saj rreth të drejtave të njeriut si dhe medaljen për punë humanitare nga Presidentja Jahjaga, po atë vit.




Më 17 shkurt 2013, Presidentja Jahjaga i dha Sonjës diplomën dhe medaljen "Nënë Tereza" për humanizëm.

Sonja Biserko vazhdon veprimtarinë e saj si analiste dhe aktiviste. Si mediat lokale ashtu edhe ato kombëtare i vlerësojnë deklaratat e saj për objektivitetin dhe perspektivën kritike mbi marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Bazuar në përvojën dhe njohuritë e saj në këtë fushë, ajo u ngarkua në një rol të veçantë nga Kombet e Bashkuara që t'i hetojë shkeljet e të drejtave të njeriut nga Koreja e Veriut.

Kur e pyetëm Sonjën për pikëpamjet e saj për paqe për të ardhmen, ajo u përgjigj kështu:

“Kur i shohim tmerret e viteve 1990-ta, jo vetëm në Kosovë, por në mbarë rajonin, është e qartë se ndërhyrja ndërkombëtare nuk ishte vetëm për ta ndaluar dhunën, por edhe për të parandaluar përsëritjen e një Bosnje të dytë. Tani, me ndikimin e Rusisë mbi Ballkan, bota duhet të përgatitet për t'i parandaluar luftërat dhe mizoritë e ardhshme. Kështu të rinjtë e kësaj kohe mund ta kenë shansin për të krijuar një të ardhme themelet e së cilës janë të ndërtuara në paqe, unitet dhe dialog.”

Të mbrosh qëndrimet e tua nuk është kurrë e lehtë, veçanërisht kur përballë ke një turmë të tërë që të kundërshton. Është edhe më sfiduese kur ideologjitë që nxisin konfliktin vijnë mu nga rrethi ku jetoni. Megjithatë, është jetike të vazhdoni të punoni për një botë që i takon të gjithëve, pavarësisht dallimeve. Toka është e të gjithëve dhe ky është vizioni që Sonja dhe aktivistë të tjerë të panumërt punojnë pa u lodhur për ta bërë realitet. Kjo botë na përket të gjithëve.



*Ikona nga Gratë në Të Zeza - Serbi
Duke mbështetur viktimat e luftës dhe shtypjes*

*Pra, të dashur lexues,
qëndroni të palëkundur
edhe kur zëri e këmbët
ju dridhen. Ndonjëherë,
vendosmëria në sytë tuaj
thotë shumë më shumë se
sa fjalët. Solidariteti me
ata që janë në nevojë është
thelbësor dhe vendimtar në
njohjen e privilegjeve tona
dhe përdorimin e tyre për t'iu
ofruar ndihmë atyre të cilët
kanë nevojë më së shumti.*

Nura në shërbim ushtarak



Një vajzë që ëndërron përtej kufijve të zakonshëm. Një kadete e përkushtuar, një udhëheqëse ambicioze togu, zëvendëskomandante kompanie, shefe e dhomës së operacioneve, agjuntante e Komandantit të FSK-së, dhe oficerë për bashkëpunim bilateral me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto pozita pasqyrojnë rrugëtimin e pandalshëm të Manushaqe Nurës drejt majave të suksesit, që nga diplomimi i saj në Akademinë Ushtarake të Forcave të Sigurisë së Kosovës në vitin 2008, e deri tani si udhëheqëse e departamentit të burimeve njerëzore në komandën e logjistikës në FSK.

Karriera në ushtri përfaqëson vite të tëra të jetës përkushtuar disiplinës dhe sakrificës. Ata që zgjedhin të mbajnë uniformën e një institucioni kaq të rëndësishëm për vendin dhe qytetarët, përgatiten mendërisht po aq sa edhe fizikisht për një detyrë të tillë. Në radhët e ushtrisë dhe në hierarkinë e saj të ngurtë, shohim më shumë burra dhe djem sesa gra dhe vajza. Historikisht, rolet gjinore

kanë përcaktuar që disiplina e jetës ushtarake dhe të gjitha elementet që vijnë me të janë 'më të përshtatshme' për burrat sesa për gratë. Në fotografitë e këmbësorisë, aksioneve ushtarake dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme, sot shohim më shumë gra sesa në të kaluarën.

Rritja e numrit të grave që punojnë në fushën e sigurisë, përveç të tjerash, mund t'i atribuohet edhe të punës së palodhshme dhe të devotshme të grave dhe vajzave që i janë bashkëngjitur ushtrisë, të cilat kanë dëshmuar se gjinia nuk është parakusht për profesionalizëm dhe përkushtim në këtë fushë.

"Deri në momentin e fundit e ndjej obligim moral me e pasë një performancë të jashtëzakonshme. Të mos jap kontribut vetëm për aq sa paguhem, por ta tejkaloj. Ta tejkaloj gjithmonë atë nivel që FSK-ja e pret nga unë në mënyrë pozitive", nis intervistën Manushaqja. Kur i kërkuam t'i përmendë me radhë të gjitha pozitat që i ka mbajtur ndër vite në FSK, ky citat mund t'ju japë një ide të qartë juve të dashur lexues se sa këmbëngulëse dhe e përkushtuar është Manushaqja, edhe para se t'i keni lexuar të gjitha paragrafët e këtij artikulli.

Nuk e kam ditë apo nuk e kam parafytyru veten të jem ushtarake. Nuk ka qenë një vendim që e kam marrë që e vogël. Por, kur kthehem në retrospektivë, mundem me e kuptu veten se prej kah ka buru vendimi im e që ka ardhë deri tek pika kur unë iu kam bashkangjitur ushtrisë

Manushaqja u lind në vitin 1990 në Vushtrri, ku jetoi deri në moshën 18 vjeçare. Ajo ka kaluar një fëmijëri të ngjashme me atë të shumë fëmijëve të tjerë, duke lozur jashtë me të tjerët në oborret e përbashkëta. Si fëmijë, ajo ishte shumë e gjallë dhe me plot vetëbesim. Nuk dorëzohej e as nuk zhgënjehet lehtë. Manushaqja ishte gjithmonë e gatshme ta ngushëllonte veten dhe të përballëj me sfidat, duke u dalluar për një natyrë këmbëngulëse dhe revolucionare. Kjo prirje për të mos u pajtuar me gjërat që nuk i pëlqenin dhe përpjekjet për ti ndryshuar ato e shoqëruan atë gjatë gjithë jetës, duke ndikuar në rrugën e saj profesionale më vonë, të cilën nuk e kishte ëndërruar kur kishte qenë e vogël.

“

Kam qenë ma
revolucionare dhe ashtu
më kanë njohur të gjithë.

Por, sot e kësaj dite
mendoj që vetë nuk i kam
jep hapësirë askujt me
më paragjyku për shkak
se mendoj ndryshe nga
ajo që pritet.

Fotografi e realizuar nga Majlinda Hoxha

Gratë, Paqja dhe Siguria



Togerja Manushaqe Nura, merr medalje diplomatike në SHBA
Foto e huazuar nga rrjetet sociale.

Kur e pyetëm se a e kishte paramenduar ndonjëherë që do të ishte një nga zyrtaret më të respektuara në radhët e FSK-së, ajo u përgjigj: “Nuk e kam ditë apo nuk e kam parafytyru veten të jem ushtarake. Nuk ka qenë një vendim që e kam marrë që e vogël. Por, kur kthehem në retrospektivë, mundem me e kuptu veten se prej kah ka buru vendimi im e që ka ardhë deri tek pika kur unë iu kam bashkangjitur ushtrisë”.

Pikërisht për shkak të interesit të madh të saj në shumë fusha të ndryshme, ishte e vështirë të parashihej trajektorja e saj profesionale. Ajo jo vetëm që kishte prirje sportive, duke marrë pjesë në gara dhe aktivitete fizike, por kishte edhe një kuriozitet të madh për shkencat. Astronomia, për shembull, ishte diçka që e magjepshte dhe e bënte të ëndërronte për yjet dhe galaktikën. Përveç kësaj, Manushaqja kishte pëlqim të thellë për artin e kulturën. Mahnitej kur shihte balerinat duke vallëzuar në televizor e shpenzonte orë të tëra duke përsëritur në mendje lëvizjet e tyre.

Kjo përzierje e pasioneve të ndryshme, si sporti, shkenca, dhe arti, e bënte Manushaqen një person të gjithanshëm, që qysh herët tregonte një aftësi të veçantë për t'u angazhuar në shumë drejtime njëkohësisht. Kjo prirje për të eksploruar dhe për të përqafuar gjëra të reja ka qenë pjesë e rëndësishme e karakterit të saj gjatë gjithë jetës.

Manushaqja, kur ishte nëntë vjeçare, e

përjetoi luftën si fëmijët e tjerë që ishin shumë pak të vetëdijshëm se çfarë po ndodhte. Përmes syve të pafajshëm, ajo kujton nga ajo kohë një moment të veçantë kur e gjithë familja e saj, si shumë familje të tjera shqiptare, u detyruan të largohen nga shtëpia e tyre. Të gjithë hipën në një traktor për t'u larguar nga Vushtrria. Ajo u ul në një cep të traktorit dhe në vend që të ndiente frikë të madhe, ajo e shihte situatën me një lloj kurioziteti, ndoshta sepse si fëmijë nuk e kuptonte plotësisht rrezikun.

“Nuk e kuptoja pse duhet me u largu nga shtëpia e e pyetsha vetën, a thu kur kemi m'u kthy? A kemi me u kthy?” ndan detaje teksa kujton se si i vështronte shtëpitë e lagjes së saj tek bëheshin gjithnjë e më të vogla.

Vite më vonë, me këtë pyetje në mendjen e saj që shërben si një pikë referimi për atë periudhë të vështirë, Manushaqja vendosi t'i bashkangjitej FSK-së. Ai që e familjarizoi Manushaqen me jetën ushtarake dhe rëndësinë e saj ishte djali i axhës së saj, i cili kishte vendosur t'i bashkohej institucionit dhe kishte filluar përgatitjet një vit më herët. Marrë parasysh që pranimiti në FSK është një proces i gjatë e shumë rigoroz, përgatitjet për secilin që vendosë t'i hyjë kësaj pune fillojnë shumë më herët.

“Përmes tij unë kam qenë e vetëdijshme që ekziston një mundësi e tillë. Në vitet 2006-2008 mundësitë e informimit ishin më të mangëta. Unë fillova

përgatitjet një vit më herët e mësoja për disa landë që më duheshin patjetër për t'u pranuar”, kujton ajo.

Me dedikim e dëshirë për t'u pranuar, ajo përgatitej secilën ditë pas shkollës për testin pranues që në të vërtetë ishin një seri e testimeve me karakter eliminues.

Manushaqja shpjegon që përmes këtyre serive testimesh, FSK-ja synonte të maste individin në disa sfera. “Kanë qenë nja gjashtë apo shtatë teste në total. Test i inteligjencës, test i njohurive të përgjithshme, test i gjuhës angleze, test i aftësive fizike e kështu me radhë”.

Në këto testime, numri i vajzave dhe grave ishte më i vogël nga ai që është sot. Në vitin 2008, kur Manushaqja po përpiqej të bëhej pjesë e ushtrisë, në ulëset e bankave që kryheshin testimet kishte shumë pak vajza. “Ndoshta kemi qenë gjashtë apo shtatë nga ne. Nuk ka qenë numër i madh qysh është sot”, kujton ajo.

Manushaqja i kaloi me shumë sukses të gjitha testimet dhe u pranua si kadete në akademinë ushtarake. Kriteret për t'u pranuar në Akademinë Ushtarake në FSK nuk janë të lehta. Uniforma e një kadeti është më e veçantë - e përbërë nga një kapelë e zezë që i ngjason kapelës së një marinari. Me një uniformë të tillë, Manushaqja dhe kolegët e saj gëzonin respekt të madh nga familjet dhe komuniteti.

“Shumë njerëz e kanë pas një ndjenjë krenarie kur na kanë pa. Kanë ndje

dashuri. Sidomos gjeneratat e vjetra, ndoshta edhe për shkak të atyre kapelave, ia kemi kujtu edhe fëmijët e tyre kur kanë shku si ushtarë në ish-Jugosllavi. Na kanë parë me shumë dashamirësi, sepse kur e dinin që bëhej fjalë për Ushtrinë e Kosovës dhe për ushtarët e Kosovës, normalisht ndjenja ishte e një natyre madhështore dhe të bukur sepse bëhej fjalë për ushtrinë e tyre”, përmend ajo.

Për ata që e njihnin, vendimi i saj për t'u bashkuar me ushtrinë nuk ishte befasues. Që nga fëmijëria, natyra e saj e guximshme dhe mënyra e veprimit në shoqëri i kishin hapur rrugën për një karrierë jo të zakonshme për vajzat e asaj kohe. Ajo kurrë nuk ishte e prirë t'i pranonte padrejtësitë apo të qëndronte në heshtje. Nëse nuk ishte e kënaqur me diçka apo dikë, ajo nuk e linte në nënkuptim; përkundrazi, ndërmernte hapa të vendosur për të shprehur hapur atë që ndiente. Ky guxim dhe vullnet i palëkundur për të vepruar, ishin tipare që e bënin të dallohej nga të tjerët.

Gjersa reflekton mbi karakterin e saj që nga fëmijëria, ajo thotë: *“Kam qenë ma revolucionare dhe ashtu më kanë njohur të gjithë. Por, sot e kësaj dite mendoj që vetë nuk i kam jep hapësirë askujt me më paragjyku për shkak se mendoj ndryshe nga ajo që pritet”.*

Pasi iu bashkua FSK-së, natyra e saj e vendosur mbeti e pandryshuar. Ajo e përdori këtë vendosmëri dhe energji për të përparuar vazhdimisht dhe për t'i vërtetuar aftësitë e saj.

Pasi përfundoi Akademinë Ushtarake në FSK, ajo i vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake Mbretërore *“Royal Military Academy Sandhurs”* në Mbretërinë e Bashkuar. Një nga shkollat më prestigjioze ushtarake në botë prej ku kanë dalë shumë udhëheqës ushtarakë me pozita të larta në ushtrinë angleze dhe liderë eminent të shumë vendeve të botës. Manushaqja e pati mundësinë të jetë përkrah elitës së ushtrive ndërkombëtare, një përvojë unike që vështirë se do ta përjetonte në ndonjë profesion tjetër. Niveli i integritimit ishte i thellë sa që, edhe pas shumë vitesh jetese në atë kulturë, ajo ndihej pjesë e saj ashtu siç ndihej në atë kontekst ushtarak. Gjithashtu, ajo arriti të përfundojë një pjesë të trajnimeve në SHBA. Përvoja të tilla janë të vazhdueshme gjatë gjithë karrierës së saj.

“Nëse do të isha kthi pas në kohë, pa dyshim që do e merrja të njëjtin vendim, sepse sot kam arritur këtë nivel profesional falë mundësive që mu dhanë në FSK”, shton pa hezitim Manushaqja, e cila është shumë e lumtur që ka privilegjin t'i shërbejë ushtrisë së Kosovës dhe popullit të saj.

Përgjatë 16 viteve të shërbimit ushtarak, Manushaqja mbajti pozita të ndryshme brenda hierarkisë së ushtrisë kosovare, duke filluar me udhëheqjen e një trupe që kishte minimumi tridhjetë veta, kur ishte vetëm 22 vjeçare. *“Në atë njësi, nëse jo ma e reja, kam qenë ndër më të rinjtë. Pjesë e njësisë kanë qenë pjesëtarë me moshë të axhallarëve të mi. Kam udhëheqë njerëz që kishin sa dy herë moshën time”,* shpjegon ajo.

Manushaqja fitoi respektin e të tjerëve përmes përkushtimit dhe vendosmërisë së saj. Si pjesë e një brezi të ri, ajo tregoi gatishmëri për t'i shërbyer edhe gjeneratës më të vjetër të ushtrisë, duke fituar besimin e tyre gradualisht. Çështja e moshës është sfiduese në secilën sferë. Manushaqja rastisi në rezistencë diskrete në sektorin e sigurisë. Por, të gjitha rezervat dhe dyshimet që gjeneratat më të vjetra patën për të, ndryshuan falë punës së palodhur dhe të pandërprerë të Manushaqes.

Ky besim u zhvillua jo përmes një shtegu të thjeshtë e të njëtrajtshëm, por përmes një përpjekjeje të vazhdueshme për t'u përmirësuar dhe për t'u dëshmuar si një lidere e respektuar në një fushë që tradicionalisht nuk pritej të udhëhiqej nga një grua e re.

Edhe pse Manushaqja ka korrur suksese të mëdha në FSK dhe për të ky rrugëtim ka qenë i duhuri, ajo bën thirrje për të gjitha gratë dhe vajzat që të për zgjedhin një rrjedhë jete që i bën të lumtura.

“Të gjitha profesionet janë të shkëlqyeshme. Bëjeni secilën punë me dëshirë dhe vullnet, e keni arsye për të qenë krenare. Mos e krahasoni veten me të tjerët dhe respektoni punën e secilës, pavarësisht industrisë apo mënyrës së jetës që ajo ka zgjedhur për të jetuar”, përfundon intervistën ajo.

*Manushaqe Nura merr çmimin "Zemra e Kosovës"
Foto e huazuar nga rrjetet sociale.*

Pra, lexues të ZA-së, Manushaqja na lë me një mesazh të fuqishëm e që është edhe rrënjësor në agjendën e barazisë gjinore. E drejta për të zgjedhur është e juaja dhe të gjithë duhet të punojmë që secila grua dhe vajzë të ketë hapësirën dhe mundësinë e zgjedhjes. Mundësia për të zgjedhur është liri, e pjesa e mbetur është histori.





Shqipja e Kosovës

Në grumbullin e uniformave diku në malet e Grykës së Llapushnikut, në komunën e Drenasit, apo siç njihet në popull, Drenicë, Shqipja po e kërkonte një të tillë për vete. I duhej një në numër shumë më të vogël sepse ato ishin qepur për ushtarë burra. Ajo atëherë ishte 14 vjeçare.

Misioni ishte arritur dhe në fund e kishte gjetë një që do t'i binte tamam, deri diku. Mirëpo, armët ishin krejt të njëjta, nuk kishte të atilla enkas për adoleshente gra. Shqipja rroku kallashnikovin në duart e saj dhe eci në drejtim të Shtabit të Zonës Operative të Drenicës. *“Uniformën fillimisht e kom pas të përgatitun, të qepur nga vet artizanët e Drenicës që e kishin ngjyros atë me ngjyra të veturave. S’kishte shume uniforma ushtarake në fillim ato siguroheshin me shume vështirësi, siç kishte mungesë armatimi. E ngushtova me rrip. Ishte qepur për ushtarë më të dobët, por më ra mua”.* Kështu filloi rrugëtimi i Shqipe Mehmeti Selimit e cila braktisi jetën në Bajern, afër Ausburgut të Gjermanisë, për t’u bashkëngjitur në vijën e frontit luftarak në Kosovë.

Në vitet e 80-ta, babai i Shqipës, si shumë shqiptarë tjerë kishin emigruar për një jetë më të mirë, nga Gjilani për në Zvicër. Shumë shpejtë në vitet e 90-ta ju bashkangjit edhe familja dhe kështu qenë zhvendosur në Gjermani. Shqipja ishte atë kohë 9 vjeçare. Me mendje dhe zemër kishin mbetur të lidhur ngushtë me Kosovën. Gjatë gjithë kohës në shtëpinë e tyre flitej për kontributin që duhej dhënë për atdheun dhe shpresonin për një ditë kur kjo dëshirë do t'u bëhej realitet. Madje në muret e banesës së tyre ishin të varura fotografitë e personaliteteve dhe heronjve shqiptar, si Skënderbeu, mbretëresha ilire Teuta, motrat Qiriazi dhe një grua tjetër luftëtare, Shote Galica. Shqipja me motrën dhe dy vëllezërit e saj po rriteshin edhe me simbolet e tjera kombëtare, përfshirë dhe flamurin kuq e zi me shqiponjën dy krenare. Ishin rritë në pritje.

"Jemi përgatit se një ditë në Kosovë do të ketë luftë. Edhe si e re, e kam pa babin që kishte kontakte me shqiptarë tjerë të ilegales dhe përgatiteshin në mënyra të ndryshme... në shoqëri flitej për Kosovën...prej kur isha 9 vjeçare e deri kur erdhi momenti me u kthi në Kosovë".

Për vitet sa qëndroi në Gjermani, Shqipja ishte përgatitur për ardhjen në Kosovë. Kishte mësuar gjuhën angleze, gjermane, punën me kompjuter, si dhe kishte ushtruar sportin e karatesë. Me mendje në Kosovë, e me trup në Gjermani. Shqipja nuk flet, i kursen ndjenjat. Për të e rëndësishme ishte që ajo të ishte e përgatitur për të mbrojtur vendin e saj. Po bëhej luftë dhe duheshin njerëz, duhej ndihmë.

Më 5 mars 1998 kishte ndodhë ofensiva ndaj familjes Jashari në Prekaz. Ishte ky një operacion ushtarak i forcave serbe kundër familjes Jashari. Pas granatimeve të vazhdueshme, Adem Jashari dhe më shumë se pesëdhjetë anëtarë të tij (përfshirë gratë, fëmijët dhe të moshuarit) ishin vrarë, duke mbijetuar vetëm një nëntë vjeçare, Besarta, mbesa e Ademit. *"Çika jem, është momenti që ne të kthehemi në Kosovë atje lufta ka fillu... a je e gatshme me ju bashkëngjit Ushtisë Çlirimtare të Kosovës?"* ishte pyetja që babai ia bëri Shqipës një pasdite të zakonshme. Shqipja vazhdon rrëfimin, duke treguar në detaje ngjarjet e asaj kohe.

"Pa u mendu dy herë i kom thëne babit po... unë jam e gatshme të vi në luftë

bashkë më ty. Se kur përgatitesh, kur je në ngjarje që diçka ka me ndodh, edhe veq e pret momentin që tash po fillon... në mars të vitit 1998 babi ka ardh në Kosove bashkë me grupin e parë të komandantëve nga vende të ndryshme të Evropës, nëpërmjet Shqipërisë. Ata fillimisht janë armatos në territorin shqiptar, pastaj kanë marshuar drejtë kufirit me Kosovën... janë shpërnda nëpër zonat prej nga ata vinin, në mënyrë që UÇK-ja të shtrihet në gjithë territorin e Kosovës. Babi, ishte vendos në zonën e Drenicës, pasi aty kishte më shumë nevojë për ushtarë. Unë, pastaj ju kam bashkëngjitë babit në fillim të majit", merrë më gjatë kohë Shqipja tek kujton ngjarjet që ja ndryshuan jetën.

Thuhet se kohët e vështira bëjnë njerëz të mëdhenj. Për familjen Mehmeti kishte ardhur dita e shumëpritur që ata të mund të japin kontributin dhe ndihmën e tyre për çlirimin e Kosovës.

"Unë dhe babi në luftë kemi vazhdu me uniformë detyrat tona ushtarake, ndërsa nana me tre fëmijët e tjerë qëndronin nëpër familje të këtij rajoni", kujton Shqipja periudhën dhe ditët e para të kthimit në Kosovë. Në fillim kishte shumë gazetarë ndërkombëtarë, të cilët kishin ardhur për ta vëzhguar situatën dhe për t'i raportuar përjetimin dhe vuajtjet e civilëve shqiptarët nga forcat serbe. Shqipja ishte në kontakt të vazhdueshëm me ta, madje përkthente nga gjermanishtja dhe anglishtja edhe për komandantët dhe të intervistuarit e tjerë. Në të njëjtën kohë kishte edhe luftime. Por, si është ndjerë Shqipja, në kontekstin e atëhershëm? A e kishte luksin që të kishte frikë?

"Jo, asnjëherë. Normalisht kanë qenë ato emocionet, adrenalina, por frikë, asnjëherë...jo. E ke ditë që ose të vret ose e vret, s'ka pas çka me u frikësu. Nuk është diçka e jashtëzakonshme. Ja e kemi tash rastin me Ukrainën, po luftojnë burra e gra, çka kanë ata ma shumë se na, ose na ma shumë se ata". Në moshën 14 vjeçare, përderisa shokët e saj në mëngjes merrnin çantën dhe bëheshin gati për shkollë, Shqipës i duhej ta kapte armën dhe të nisej në front të luftës. Kallashnikovi që mbante në krah për çdo ditë peshonte diku rreth 4 kilogramë. *"Mujsha me qu, sepse fizikisht isha e zhvillume mjaftueshëm, se kisha përgatitjet paraprake në Gjermani. Kështu e morra armën, dhe një revole të vogël, edhe fillova të mësohem me to.*

Pra, në vend të librave e fletoreve kisha uniformën dhe kallashnikovin", sjell krahasime me luftën që po ndodhë aktualisht dhe me paralelet e ndryshme të fëmijëve në kohë krizash dhe në paqe.

Më 7 maj 1998 në Kosovë kishte ndodhë sulmi i forcave serbe në Grykën e Llapushnikut që rezultoi në një betejë të ashpër dhe me pasoja të rënda për civilët dhe luftëtarët e UÇK-së në atë rajon. Ishte kjo përballja e parë kundër forcave serbe në të cilën mori pjesë edhe Shqipja. Aty, ajo thotë se gjuajti me armë për herë të parë.

"I kom dëgju krismat live për herë të parë... është vra një ushtar i joni. Masnej ka ndodh varrimi edhe për herë të parë më kanë parë popullata e cila ishte mbledh në numër të madh për t'i dhënë lamtumirën e fundit ushtarit të vrarë. Reagimet dhe mirënjohjet e masës për mua si vajzë e re në uniformë e me emblemë të UÇK-se ishin të shumta". Shqipë Selimi dhe Xhevë Lladrovci ishin ndër gratë e rralla pjesëtare të UÇK-së në uniformë në fillim të vitit 1998. Gratë në luftë kanë ndihmuar edhe si mjeke apo kanë gatuar për ushtarë, e më vonë numri tyre si ushtarë me uniformë është rritur. Fatmirësisht, Shqipja shpëtoi e gjallë nga lufta e cila zgjati deri më 10 qershor 1999 dhe përfundoi me hyrjen e forcave të NATO-së (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) dhe tërheqjen e forcave të armatosura serbe. Marrëveshja e Kumanovës, që u nënshkrua më 9 qershor po atë vit, shënoi përfundimin e luftës në Kosovë. Shqipja me familjen e saj u kthyen në vendlindjen e tyre në Gjilan.

Vepriktaria e Shqipës pas luftës vazhdoi përsëri me uniformë. Ajo ishte pjesëtare në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), në Departamentin e Operacioneve në Zonën e VI-të Mbrojtëse në kuadër të Shtabit të Zonës. Në vitin 2003 ajo u transferua në Prishtinë në Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës, gjegjësisht në Qendrën Simulative në TMK dhe qëndroi për tri vite.

Kjo ishte një vazhdimësi, tashmë jo luftë frontale, por angazhim për rindërtim dhe themelimin e institucioneve të sigurisë së Kosovës. *"Meqë shpëtuam prej luftës, atëherë vjen pjesa e rindërtimit, e organizimit shtetëror. Aktiviteti im me uniformë në UÇK vazhdoi edhe në TMK pas luftës".*



Shqipe Mehmeti Selimi pjesë e panelit për të diskutuar rreth temës "Roli i parlamentit dhe agenda Gratë Paqja dhe Siguria"

Ishte koha kur po bëhej transformimi i ushtrisë nga TMK-ja në Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK). Gjatë këtij rotacioni, Shqipja po priste fëmijën e dytë. Në shtator të vitit 2005, Shqipja u martua me Rexhep Selimin, dhe së bashku erdhën të jetojnë në Prishtinë.

"Me Rexhën jemi pa në luftë, ndërsa në vitin 2005 jemi martu. Në vitin 2006 jam bërë nanë për herë të parë me djalin Aresin, ndërsa për herë të dytë, me vajzen Ersën, në vitin 2009". Si Shqipja ashtu edhe Rexhepi ishin pjesë e UÇK-së - ajo si ushtarë ndërsa ai komandant dhe ndër themeluesit e parë të UÇK-së. Ky artikull është për Shqipen, por, historia për Rexhep Selimin është një ngjarje e papërfunduar. Ai i takon katër personazheve që janë duke u gjykuar nga Gjykata Speciale në Hagë, që nga viti 2020. Për Shqipen, Rexha, siç e thërret ajo, në fillim ishte një bashkëluftëtar i saj, e më vonë u bë edhe bashkëudhëtar i jetës së saj.

Periudha e luftës, Shqipen e kishte formësuar shumë duke i dhënë *"një vetëbesim të jashtëzakonshëm, për më tepër ma ka forcu ideologjinë familjare për kombin dhe atdhedashurinë,"* siç rrëfëhet ajo, duke shtuar se, *"Nuk kam pasur problem, vetëm dëshirë edhe ma të madhe që me e dhanë kontributin për çlirim, shpëtuam gjallë...se kemi mujt me qenë të vdekur, në shumicën e rasteve si bashkëluftëtarët tjerë, po e kemi dhuratë edhe këtë pjesën e pasluftës... dhe atë e kemi kthyer në shërbim ndaj atdheut".*

"Unë si shtatzënë, thash nuk po ja boj vetit atë mundim, në atë gjendje më ishte dëshirë me shku nëpër teste të ndryshme për me ju bashkëngjit FSK-së. I thash vetes 'step away' [tërhiq]. Vendosa me ju përkushtu familjes dhe botës akademike". Pas më shumë se tetë vitesh si pjesëtare e ushtrisë, Shqipja iu përkushtua familjes dhe vazhdoi studimet bachelor dhe master në drejtimin Ekonomik, Menaxhment dhe Informatikë. Një vit më vonë, bëri një kthesë dhe iu bashkua Lëvizjes Vetëvendosje, LVV. Ishte viti 2021 kur ajo u përzgjedh nga partia që të kandidojë për deputete të Kuvendit të Kosovës. Ishte kryeministri Albin Kurti, thotë ajo, ai që kishte propozuar që Shqipja të kandidonte për deputete. *"Lëvizja Vetëvendosje dhe kryetari Albin Kurti më kanë vlerësuar dhe më kanë nderuar me propozimin e tyre që unë me kandidu për deputete. Normal që unë u*

ndjeva mirë se është vlerësim i punës dhe angazhimit tim”.

Shqipja u rendit në numrin 10 në listën e kandidatëve të LVV-së. Numri ngërthente në vete edhe një simbolikë, jo vetëm që më parë e kishte të njëjtin numër bashkëshorti i saj Rexhepi gjatë kandidaturës së tij për deputet, por edhe në luftë ai njihej me atë numër fati.

“Nuk e di nga kush është propozu që unë të kandidoj me numrin 10, e kam kuptu si gjithë kandidatët e tjerë, atëherë kur listat janë shpallur zyrtarisht. Ishte ky nderimi i dytë që më bëri partia. E kanë vlerësuar që Shqipja duhet me pas atë numër”. Tash e katër vite Shqipja është deputete në Kuvendin e Kosovës, ku në radhët e kësaj partie ajo është anëtare e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Në biografinë e publikuar nga Parlamenti i Kosovës në pjesën e quajtur *“Aktivitete dhe funksione”*, tek ajo janë dy funksione të renditura, ish- ushtarë e UÇK-së, dhe ish pjesëtare e TMK-së.

Ajo me çfarë mburret më së shumti është përfaqësimi që Shqipja ia bën Kuvendit të Kosovës nëpër forumet ndërkombëtare, kryesisht për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, zakonisht të organizuara nga qeveria amerikane si dhe në vende të ndryshme të Evropës. *“Mendoj se me sukses kam përfaqësuar Kuvendin e Kosovës nëpër këto forume, qoftë për integrimin e ushtrisë tonë në NATO, apo për integrimin e Kosovës në Këshillin e Evropës apo në Bashkimin Evropian... aty ndodhin shumë kontakte nga më të ndryshmet... takon deputetë apo edhe përfaqësues të qeverive e ata pastaj kanë ndikim në qeveritë dhe në parlamentet e tyre”.*

Në grupet punuese, fjala e Shqipës ka çdo herë peshë, mendimi i saj vlerësohet nga kolegët e saj deputetë, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, policinë dhe mbrojtjen. Vazhdon të jetë inspirim, ashtu siç ishte inspirim dhe model edhe për burrat e gratë gjatë luftës.

Shqipja vazhdon të jetë shumë krenare. Asnjëherë pishman për kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës. Mirëpo, sot asaj dhe familjes së saj iu mungon Rexhep Selimi, dhe janë duke e pritur gjykimin duke besuar në drejtësi.

“Normalisht që i mungon familjes, por jo vetëm neve...i mungon krejt Kosovës.

Më së paku kishim mendu se ushtarët e UÇK-së kanë me shku në Hagë edhe me u gjyku për luftën e tyre të drejtë”. Rexhep Selimi në Hagë është duke u gjykuar së bashku me ish-krerët tjerë të UÇK-së, ish-presidentin dhe ish-kryeministrin Hashim Thaçi, ish-kryetarët e kuvendit, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin. Shqipja, duke qenë edhe vet pjesëtare e UÇK-së, dhe bashkëlufëtare e të akuzuarve, beson në luftën e tyre të drejtë.

Historia e Shqipës filloi me luftën në Kosovë. Ishte ndër gratë e para që theu stereotipet, ishte shembull dhe tregoi se nuk është problem nëse një vajzë e re e veshë uniformën e ushtrisë apo policisë. Për të, ajo është pjesa më e lavdishme e jetës së saj. *“Në UÇK ka fillu jeta ime, historia ime, tregimi im. Deri atëherë, kam qenë fëmijë, nuk është që kom pas një tregim të jashtëzakonshëm. Por që në moshë të re, me 14 vjet fillon historia ime, një tregim i lavdishëm për jetën time. Ajo më mbushë me krenari, gjithë jetën”.*

Nuk është e lehtë të sqarohet historia me kontekstin aktual. Shqipja ishte kthyer prej një jete të mirë në vendin e saj për të luftuar për liri. Aq shumë e kishin ndërë familja shtypjen politike të regjimit serb në vitet e 90-ta, sa që nuk vendosej në pikëpyetje as moshja as gjinia për të dhënë një kontribut për pavarësi dhe liri. Shqipja e shihte si nevojë që fëmijët në të ardhmen të rriteshin në vendin e tyre të lirë dhe të barabartë—mos të detyroheshin të migronin në vende tjera. Falë Shqipës, UÇK-së dhe forcave ndërkombëtare, Kosova u bë shtet i pavarur dhe sot fëmijët kanë mundësi të rriten dhe ta ndërtojnë shtetin, pa shtypje dhe në paqe për të gjithë. Për Shqipën, shprehja *“Freedom isn't free!”* (Liria nuk falet), nënkupton se liria si koncept nuk vjen pa një çmim.

“Si vend, si komb, kemi vuajtur shumë që të jemi këtu ku jemi sot, pra, lirinë dhe mirëqenien tonë dikush e ka paguar me jetë, dhe ne nuk duhet të harrojmë të kaluarën tonë, duke e nderuar dhe kujtuar të kaluarën tonë heroike, ndërtojmë të ardhmen tonë të sigurtë”, e përmbyll intervistën Shqipe Mehmeti Selimi, deputete në Kuvendin e Kosovës. Dikur mezi i binte një uniformë lufte, e sot mbanë gjithë atë trashëgimi mbi supë dhe është një grua dhe një nënë e fortë që beson që paqja e ka çmimin e vet.



Si vend, si komb,
kemi vuajtur shumë
që të jemi këtu ku
jemi sot, pra, lirinë
dhe mirëqenien tonë
dikush e ka paguar
me jetë, dhe ne nuk
duhet të harrojmë
të kaluarën tonë,
duke e nderuar
dhe kujtuar të
kaluarën tonë
heroike, ndërtojmë
të ardhmen tonë të
sigurtë



Dorë për dorë me të mbijetuarit

Nuk është rastësi që agjenda e sigurisë e ka të integruar paqen. Paqen dikush mund ta paramendojë si një frymëmarrje e gjatë që mbahet, por lëshohet në fund. Dikush tjetër si një hapësirë ku zhurma e kaosi zbehen. A është paqe atëherë kur e kaluara nuk peshon më aq rëndë e plagët shërohen?

Në Kosovën e pasluftës shumë individë kanë kontribuar pikërisht në ndërthurjen e paqes dhe sigurisë. Përmes punës së tyre kanë ndikuar në rindërtimin e besimit dhe qepjen e ngadaltë të jetëve që janë shqyer nga dhuna e trauma. Ndër këta persona është edhe Mirlinda Sada - apo Linda, siç edhe e njohin të gjithë, drejtoresha ekzekutive e "Medica Gjakova" në Gjakovë.

Rrallë ndodhë që puna të jetë edhe pasion për ata që punojnë. Jo të gjithë e kanë fatin të jenë drejtpërdrejtë të përfshirë në atë që edhe i përmbushë. Por, kur puna dhe pasioni bashkohen, ajo që lindë nuk është thjesht një karrierë, por një mënyrë jetese. Për Lindën, është një thirrje që i jep kuptim jetës.

Puna është ekuivalente me pasionin, kështu e sheh Linda. Ajo punon që ta përmirësojë cilësinë e jetës për të gjitha gratë dhe burrat që kanë përjetuar dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Një thirrje e tillë në jetë nuk merrë përgjigje nga secili individ meqë, vështirësitë me të cilat ballafaqohen, mund të jenë dekurajuese e madje edhe zemërthyesë. Por, për më shumë se dy dekada, Linda ka qenë secilën ditë të jetës së saj në shërbim të së mirës së komunitetit duke punuar drejtpërsëdrejti me një grup të shoqërisë, i cili për një kohë shumë të gjatë nuk ishte qendër të temave të drejtësisë tranzicionale dhe madje as në ligjërimin publik.

Por, cili ka qenë rrugëtimi i Lindës deri në angazhimin e saj në këtë kauzë fisnike?

Linda u lind në vitin 1969 në Gjakovë. Kaloi gjithë fëmijërinë e saj dhe ende vazhdon të jetojë po aty. Ndër të tjera, fakti që ishte fëmija i parë në të dy anët e familjes së saj, e bënte atë të kishte vëmendje e kujdes të shtuar nga të gjithë. Fëmijëria e saj në këtë qytet ka qenë shumë e bukur.

Përkundër kujdesit që ajo e gëzoi, ajo vërente pabarazitë mes vajzave dhe djemve dhe mendohej që nëpërmjet veprimeve të vogla të kishte ndikim në rrethin e saj, edhe nëse intervenimi i saj mund të ishte modest. Ajo shqetësohej kur rastiste në veprime që duhej të kufizohej për shkak të gjinisë së saj, derisa bashkëmoshatarët djem e kishin më të lehtë t'i shijonin mundësitë. Këto pabarazi e bënin Lindën që të revoltohej dhe të sfidonte normat shoqërore që paracaktonin rolet gjinore.

Një shembull konkret i një momenti të tillë në jetën e saj ishte aktiviteti i saj sportiv në futboll. Ky sport më parë ishte i dominuar nga djemtë, por ky realitet nuk e ndaloi Lindën për ta ndjekur si pasion. Në

shkollë, ajo nisi të luajë futboll me djemtë, me pasion dhe vendosmëri, përpiquej të ftonde edhe shoqet e saj të shkelin kufijtë e përcaktuar. Futbolli ishte pikërisht mjeti që i ndihmonte asaj për t'i tejkaluar barrierat e shoqërisë. Për të, ishte një akt i fuqishëm i rebelimit.

"Gjithmonë ka qenë tendencë e imja që në diçka të cilën e kanë ndaluar për vajza, unë me shku dhe me kërkun ato dhe me qenë e përfshirë aty", ndan Linda përpjekjet e saja të vazhdueshme për të transformuar botën rreth saj.

Ajo menjëherë pas luftës themeloi klube të futbollit për vajza në shkollat fillore të Gjakovës, ndërsa në vitin 2003 arriti të krijojë Klubin e Futbollit të Vajzave të Gjakovës.

Por, para se të vazhdojmë me rrëfimin e Lindës në periudhën e pasluftës, qëllimshëm po kthehemi sërish tek një periudhë të cilën e kanë përjetuar të gjithë shqiptarët në vitet e '80-ta dhe '90-ta - shtypjen politike e shoqërore nga regjimi i atëhershëm.

"Ne nuk ishim të lirë të vepronim, të mësonim e të punonim," kujton Linda, e më pas ndan të kaluarën e saj si nxënëse para dhe pas sistemit paralel të shkollimit. *"Kemi qenë të rinjtë që pavarësisht vështirësive, asnjëherë nuk dekurajoheshim dhe punonim për t'i arritë ëndrrat tona".*

Ajo pati fatin që në Gjakovë ta përfundonte shkollën fillore dhe të mesme në objekte shkollore, e më pas studimet në degën e Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës. Ligjëratat i mbanin në objekte të shtëpive të familjeve vullnetmirë që kishin lëshuar dhoma, korridore, oborre për të mundësuar mbarëvajtjen e edukimit të rinisë shqiptare.

Teksa flet për këtë periudhë, ajo hedhë sytë poshtë në dokumentet që ishin në tavolinën e zyrës së saj, e me pikëllim kujton: *"Nuk ka qenë bash e lehtë duke i pasë të gjitha këto sfida. Plus unë udhëtoja nga Gjakova në Prishtinë. Kishte kontrolle të shpeshta nga policia serbe e ne duhej t'i fshihnim librat, indeksin, mos me tregu që jemi studentë. Nëse ndonjë gjësend që mbanim me vete kishte pamjen e librit, indeksit, atëherë e kemi pësuar".*

Vështirësitë për t'i ndjekur ligjëratat në universitet ishin vetëm maja e malit me akull. Kur tensionet etnike kulmuan me luftë, Linda dhe familja e saj mbetën të ngujuar në Gjakovë, njërin nga qytetet më të prekura dhe të shkatërruara nga lufta. Pasi u dëbuan nga shtëpitë, ajo me familjen e saj u nisën për të lënë qytetin, mirëpo në mes të rrugës i kthyen sërish. Ata u rikthyen në shtëpi me vigjilencë të lartë e vetëdije të shtuar për situatën. Errësuan dhomat, mbyllën dritaret, lëshuan roletat dhe linin nga një anëtar si rojë gjatë gjithë natës.

"Ka qenë me të vërtetë shumë-shumë vështirë dhe nuk e kemi ditë tamam se çka jemi t'u përjetu. Agresorët hynin në shtëpi dhe me disa preparate i vinin flakën shtëpive.

“

When I remember my first day of work at Medica Gjakova, even now when I'm being interviewed for ZA Magazine, I shudder. When I first met those women, I was so excited that I couldn't hold back my emotions. I took their voice and words home with me and I thought a lot about how I can continue my work from then on.

”

Atifete Jahjaga vizitoi organizatën jo-qeveritare Medica Gjakova të udhëhequr nga Znj. Mirlinda Sada.





Fotografi e realizuara nga Majlinda Hoxha

Shtëpia zhdukej brenda tri orësh, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Nuk i'u interesonte se a ka njerëz e ne donim të kishim mundësi që së paku të dalim jashtë e të mos digjemi për së gjalli”, rrëfen ajo me rrëqethje.

Paqartësia se kush do të mbijetonte, a do të dëgjonin edhe një herë zërin e të afërmeve, a do ta shihnin edhe një ditë tjetër tek zbardhte, ndikonte në mendjen dhe trupin e tyre. E ky ankth i vazhdueshëm ndikon në shtresëzimin e traumave, të cilat duhen trajtuar e mjekuar nga shumë fronte.

Ashtu si çdo gjë tjetër në jetë, edhe lufta më në fund mori fund. Por, përfundimi i saj shënoi vetëm fillimin e një beteje të re, përballja me mbetjet e pasojave shkatërruese. Kjo nënkuptonte jo vetëm rindërtimin e infrastrukturës fizike dhe rithemelimin

e bazave institucionale, por edhe rehabilitimin dhe shërimin e atyre që ishin prekur drejtpërdrejt nga lufta. Shtëpitë u rindërtuan, por mendjet mbetën të lënduara.

Lufta përjetohet ndryshe nga gratë, vajzat, burrat apo djemtë. Mënyra se si lufta ndikon në jetën e secilit prej tyre, ndërlihet edhe me shënjesit e tjerë të identitetit, si moshë, aftësitë fizike e mendore, prejardhja, klasa ekonomike, e kështu me radhë. Trajtimi i secilit person që është prekur nga lufta duhet të individualizohet dhe të ndërmerren masa konkrete që shërimi i atij personi të jetë sa më i plotë. Prandaj, të gjitha këto veçori nuk janë barrë e lehtë as për një organizatë dhe aq më pak për personat që udhëheqin misione të tilla.

Linda filloi punën në këtë drejtim menjëherë pas luftës duke i'u

bashkangjitur “Këshillit Norvegjez për Refugjatë”. Kjo ishte një organizatë ndërkombëtare që merrej me ndihmë juridike falas për refugjatët dhe të rikthyerit. Pas përfundimit të misionit të kësaj organizate, Linda hyri në shoqërinë civile të Gjakovës, duke synuar të avancojë pozitën e gruas në shoqëri. Fillimisht ajo ndihmoi në krijimin e forumit të organizatave joqeveritare të Gjakovës. Gjatë angazhimit në këtë forum, Linda dëshmoi për vullnetin e grupeve që merreshin me fuqizimin e grave dhe të rinjve, e që e motivuan atë të profilizohej.

Puna e saj e zellshme dhe pasioni që kishte për kauzën bëri që ajo të ftohej për menaxhimin e organizatës “Medica Gjakova”. Për Lindën, ishte shumë e vështirë ta linte një shoqëri të cilën ajo kishte ndihmuar për ta krijuar, e të



shkonte në një organizatë tjetër. Por, misioni i organizatës ia theu mendjen, sepse orientohej në mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, duke i fuqizuar ata dhe duke promovuar të drejtat e tyre në shoqëri.

“Kur kujtoj ditën e parë të punës në Medica Gjakova, edhe sot kur po flas me ju për Revistën ZA, rrëqethem. Kur jam taku fillimisht me ato gra kam qenë shumë e emocionuar edhe nuk kam qenë në gjendje me e mbajtë vetën. Zërin e fjalët e tyre i kam marrë me vete në shtëpi e kam mendu shumë se si mundem me vazhdu punën tutje”, deklaroi Linda kur reflekton mbi periudhën e fillimit të punës së saj.

Dy dekada më vonë, Linda vazhdon jetë në krye të organizatës me të njëjtin

dedikim e dëshirë për ta përmirësuar cilësinë e jetës e për të kontribuar në paqe të qëndrueshme përmes fuqizimit të grave e de-stigmatizimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës.

Punën e saj e vështirësonte shumë niveli i lartë i paragjykitimit për dhunën seksuale gjatë luftës, i cili ishte i pranishëm në mbarë Kosovën. Vetëdija ende nuk ishte zhvilluar mjaftueshëm për të kuptuar se dhuna seksuale përdoret si mjet lufte, me pasoja që zgjasin për dekada pas përfundimit të saj. Gratë dhe vajzat, e madje edhe disa burra e djem, jetonin në agoni, pa pasur një hapësirë të sigurtë për t'i ndarë përjetimet e tyre dhe pa gjetur dikë që do t'i dëgjonte me kujdes dhe mirëkuptim në lidhje me betejën që ata kishin përjetuar në trupin e tyre.

Në nivel institucional, çështja e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, e cila për një kohë të gjatë ishte e stigmatizuar dhe e anashkaluar në politikë, u ngrit nga Presidentja Atifete Jahjaga gjatë mandatit të saj në vitet 2011-2016. Ajo luajti një rol kyç në hapjen e diskutimit në Kuvend dhe në jetësimin e idesë për krijimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës.

“Përpara kësaj kohe, ka qenë sfiduese për ne ta hapim këtë temë. Pasi e kemi filluar të flasim për temën në familjet tona dhe familjet e të mbijetuarve, është bërë edhe më e qartë sa e madhe ishte sfida për komunitetin. Kjo ka qenë edhe më e vështirë në zonat rurale, por nuk mund të përjashtoj as qytetet, pasi dhuna seksuale është njëjtë kudo, e shoqëruar me stigmën e madhe si në qytet, ashtu edhe në fshat”, tregon ajo.

Puna me të mbijetuarit është punë që kërkon impenjim të madh emocional. Shumë individë nuk mund ta bëjnë për shkak të peshës së madhe mbi supë që vjen me këtë detyrë. Linda lumturohet dhe motivohet nga rastet kur gratë dhe vajzat që vijnë të marrin shërbime në organizatën e saj. Ajo është dëshmitare se si gratë ndihen më të lehtësuara shpirtërisht, pasi gjejnë prehje tek një komunitet që i dëgjon, e i bën të ndjehen të rëndësishme dhe të përfshira. Prandaj, ajo mundohet t'i ndihmojë në cilëndo formë që është e përshtatshme për to.

“Përmirësimi i jetës së një gruaje është motivimi më i madh për mua. Për këtë

arsye ne vazhdojmë të punojmë dhe do të vazhdojmë derisa ka nevojë të përkrahim dhe të mbështesim të gjithë të mbijetuarit. Shumë nga të mbijetuarit janë lënë anash dhe kanë qëndruar të heshtur; mund të kenë qenë afër nesh, në rrugë, në familje, në punë, por nuk kemi ditur për ta deri kur kemi filluar të flasim të gjithë”.

Vlerat kryesore që vazhdojnë të udhëheqin punën e organizatës dhe Lindës, përfshijnë konfidencialitetin, gjithëpërfshirjen dhe ndërtimin e besimit.

Trajtimi dhe përpunimi i traumës mund të ndalojë përkeqësimin e dhimbjes dhe sëmundjeve post-traumatike dhe të sigurojë një shoqëri që jeton në paqe. Trauma duhet të flitet dhe të trajtohet. Prandaj, puna që Linda ka bërë ndër vite siguron që çdo zë të dëgjohet dhe të mos harrohet kurrë. Në këtë mënyrë arrihet paqja në shoqëri. E kështu mund të deklarohet se paqja është ajo periudhë kur pesha e së kaluarës nuk është më aq e rëndë dhe plagët nisin e shërohen.

“

Përmirësimi i jetës së një gruaje është motivimi më i madh për mua. Për këtë arsye ne vazhdojmë të punojmë dhe do të vazhdojmë derisa ka nevojë të përkrahim dhe të mbështesim të gjithë të mbijetuarit.

”

Në luftë për të drejtën

Njerëzit që e kanë pasion punën e kanë shumë të vështirë të bëjnë muhabet për hatër të të bërit muhabet, pra sa për ta kaluar kohën. Ata kanë aq shumë të thonë, por në vend të kësaj preferojnë të veprojnë, pra të kryejnë punën. Këta njerëz janë aq të përkushtuar që të merren me pasionin e tyre, duke lënë kohën të tregojë rezultatet e përpjekjeve të përditshme.



Për një tridhjetëvjeçare si Arrita Reznici, puna është mishërim i sakrificave për të parë e ngritur efektet e ligjit e drejtësisë në një shoqëri në tranzicion si ajo e Kosovës. Arrita është ngjitur me shumë pasion shkallëve të saj profesionale. Në secilin hap të arritjes e pjekurisë ajo ka mësuar mësimet të vlefshme të cilat nuk i mbanë për vete por i ndanë me të rinjtë që synojnë nivele të larta profesionale.

Arrita Reznici është udhëheqëse e Qendrës për Ndihmë Juridike Falas, në Institutin e Kosovës për Drejtësi. Për këtë punë flet me një modesti të zgjuar. Nëse një gazetar di si të bëjë detyrat e shtëpisë (lexo: të hulumtojë më shumë për personin që e interviston), atëherë e kupton se nga vjen modestia e Arritës - nga sukseset e saj.

Për motivin e saj ajo shprehet shkurt, por hijshëm: *“Mua më shtynë përpara qëllimi dhe rezultatet e punës sime, t’i ndihmoj njerëzit t’i kuptojnë e realizojnë të drejtat e tyre”*, thotë Arrita. Ajo po ashtu udhëheq Programin e Edukimit në Institutin e Kosovës për Drejtësi që i trajnon juristët e rinj në aspektet praktike të profesionit.

E lindur më 1994 në Prishtinë, Arrita e kujton veten si një fëmijë të urtë por me plot kërshe për botën. Ai fëmijë kurioz nuk e ka braktisur asnjëherë. *“E mbaj në mend që bashkë me babin dhe nanën gjithmonë shikonim sport, sidomos tenis e futboll”*, kujtohet Arrita dhe shton se në atë kohë edhe ajo ka ushtruar tenis. Vitet e 90-ta i mban në mend fare pak. I kujtohen sfidat e prindërve për t’ia dalë. *“Më është dukur e çuditshme të flejë me rrobe të ditës”*, tregon ajo për kohën kur familjeve shqiptare iu është dashur të jenë në gjendje gatishmërie.

Pas shkollimit të mesëm ajo tregon se ka pasur dilema që të studiojë mjekësinë, por diçka e ka tërhequr nga drejtësia dhe ligji. *“Ka qenë sfida në fakultet sepse sistemi i të mësuarit aty nuk ka qenë më i miri, ka qenë jo inkurajues ku më shumë është mësuar teoria e jo praktika”*, shprehet Arrita duke shpjeguar se aty e ka kuptuar një realitet të ri, atë të arsimit të lartë në Kosovë.

Pasi që kishte punuar në një zyre avokatie, atje thotë se kishte mësuar abetaren e praktikimit të drejtësisë. Arrita kishte aplikuar për një pozitë në Institutin e Kosovës për Drejtësi në të cilin edhe sot kontribuon me të arritura befasuese. *“Më 2019, kur është themeluar Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së, jam ballafaquar me realitetet e jetës së shumë grave tek ne”*, shprehet ajo duke lidhur këtë me shumë raste të dhunës në familje të cilat e kanë nxitur Arritën të harrojë jetën e saj personale e t’i dedikohet në tërësi kauzës së drejtësisë për gratë viktime.

“Ka pasur shumë raste tejet të ndjeshme kur për shkak të profesionalizmit nuk kam mundur të përzihem në zgjedhjen personale të viktimës. Në ato raste poashtu kam qenë e zhgënjyer në institucionet e drejtësisë

për shkak të mungesës së ndihmës ndaj viktimës”, shpjegon ajo.

Ky vetëmohim i saj profesional poashtu ka kontribuar në ngritjen e standardit të punës në mbrojtjen e grave apo në proceset e hulumtimeve që i kryen në kuadër të punës. Por, nganjëherë e gjithë puna mund të mos përfundojë me triumfin e drejtësisë dhe për këtë ajo e mban në mend rastin e Sebahate Morinës si rastin e saj më të hidhur, që sipas Arritës, institucionet e drejtësisë kishin dështuar tërësisht që t’i ofronin ndihmë viktimës.

Arrita tregon se Qendra për Ndihmë Juridike e IKD-së i trajton 700 deri në 800 raste në vit, ku në rreth 40 përqind të rasteve viktime janë gratë. Me zgjuarsin e me një krahasim interesant, ajo shprehet se gratë duhet ta motivojnë veten më shumë dhe të bëhen të zonjat të marrin mbi vete përgjegjësinë e udhëheqjes së proceseve.

“Drejtësia si emër është emër gruaje [në gjininë femërore, drejtësia], por është një fushë që në përgjithësi dominohet nga burrat. Nuk kam lënë rast pa e shfrytëzuar për tu bërë thirrje grave që të punojnë fort në përfaqësimin e tyre në sistemin e drejtësisë në vend”, tregon ajo.

Për Arritën siguria nënkupton lirinë për tu shprehur. *“Forma e sigurisë që cenohet më së shumti tek ne është siguria fizike. Kjo është alarmante”*, shprehet Arrita dhe shton se në raste të cenimit të sigurisë së tyre, gratë nuk duhet të hezitojnë për të kontaktuar me qendrën që ajo e drejton. *“Qendra jonë ka ekipe mobile, gjë që na mundëson të jemi në secilin qytet të Kosovës”*, njofton Arrita.

Ajo thekson se pabarazia gjinore ndikon jashtëzakonisht negativisht në shumë dimensionet e jetës së grave, si në familje, në karrierë apo në pasuri dhe në këtë mënyrë nuk mund të flitet për një shoqëri progresive apo sundim efikas të ligjit kur gratë i nënshtrohen presioneve të këtitilla shoqërore.

Dita e Arritës fillon herët dhe në vete mban një llojllojshmëri interesante të angazhimeve, qoftë në hulumtime, shqyrtime të rasteve, edukimin e juristëve të rinj apo këshillimin e kolegëve gazetarë për temat nga fusha juridike. Pa marrë parasysh se një ditë i ka 24 orë, ajo prapë gjen kohë për lexim të literaturës profesionale por edhe të ndonjë autobiografie, një zhanër shumë i pëlqyer i Arritës.

Sfidat e saj për t’i ndihmuar të njerëzit e prekur nga padrejtësitë – në çfarëdo forme qofshin ato – janë të përditshme, serioze dhe ballafaqimi me to kërkon shumë fokus, koordinim e zgjuarsin. Por, përvoja e saj e deritanishme ka treguar se këmbëngulja dhe përcaktimi për të sjellë drejtësi për viktimat është një përmbushje morale që e motivon atë dhe ekipin e saj fantastik.

“Sado e vështirë situata, ta dini se ka gjithmonë zgjidhje. Lufta për të drejtën gjithmonë ia vlen të luftohet”.

Hafizja në Siguri Kibernetike

Është pak e vështirë të gjesh një profesioniste me etikë aq të lartë pune sa Hafize Bajrami. Ajo ka aq shumë të tregojë për veten e saj, por në intervistë është aq hijshëm e matur e diskrete dhe rezervohet për t'i treguar sfidat e saj të cilat kanë rezultuar me aq shumë suksese në jetën e saj profesionale.

Profili i Hafizes si inxhinierë në fushën e teknologjisë informative fokusohet në sigurinë kibernetike. Në Kosovë është aq i rrallë por tejet i kërkuar dhe ajo bën çmos për t'i inkurajuar gratë e reja që t'i rreken kësaj lëmie të paeksploruar.

“Qysh kur kam qenë në shkollë fillore e kam dashurë punën me numra”, kujton Hafizja. Ajo sot punon në Ministrinë e Mbrojtjes si udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtje Kibernetike.

Aftësitë dhe interesimi i saj në shkencat natyrore e veçmas në matematikë, ashtu dhe kapaciteti i saj për të analizuar operacione e procese matematikore kanë rënë menjëherë në sy tek mësimitdhënësi i matematikës i cili e ka trimëruar Hafizën që t'i ndjekë shkencat e inxhinierisë si profil profesional. Por, edhe këtu, Hafizja nuk e ka pasur të lehtë të dallohet.

“Në shkollë ka pas, të them, profilizim të fëmijëve, ku kanë qenë të veçuar fëmijët e qytetarëve të cilët kanë qenë më të privilegjuar edhe nga mësimitdhënësi”, tregon Hafizja duke shtuar se reputacionin në shkollë e ka fituar vetëm duke i kushtuar shumë kohë mësimit. *“Kur kujtohem tash, e kuptoj se si janë bërë dallimet brenda fëmijëve, por unë nuk pajtohesha me këtë dhe më është dashur mjaft punë që të ‘pranojem’ në mesin e nxënësve të dalluar”.*

Këtë rrugëtim Hafizja e ka pasur të pamundur ta bëjë pa përkrahjen e familjes. *“Në fillim, familja ime ka pasur dëshirë që unë të studioj mjekësinë, por kur e kanë parë që unë jam shumë e vendosur janë pajtuar me vendimin tim”,* rrëfen Hafizja e

cila është fëmija më i vogël në familje. Ajo kujton se si fëmijë ka qenë e urtë por me një aftësi të jashtëzakonshme vështruese që i vërehet edhe sot në shikimin inteligjent.

Ajo tregon se lufta në Kosovë e ka kalitur dhe e ka pjekur më herët. *“Klasën e tetë e kam vazhduar si refugjate në Shqipëri”,* thotë duke mos u lëshuar shumë në atë episodë të jetës. Pas shkollës së mesme në Vushtrri, përcaktimi i saj për ta vazhduar shkollimin në teknologji informative ka rezultuar me shumë sukses pas përpjekjeve të mëdha.

“Konkurrenca për tu regjistruar në fakultet ka qenë shumë e fortë, por vendosmëria ime për t'ia dalë mbanë ka qenë shumë më e madhe”, shprehet Hafizja duke kujtuar se në atë kohë – më 2003 – bleu edhe kompjuterin e saj të parë personal që e kujton me nostalgji.

Vullneti i çeliktë për të arritur suksese në jetë është shenja dalluese e Hafize Bajramit. Studimet e përfunduara në afatin rekord nuk e kanë lënë të kënaqur. Po me atë këmbëngulje Hafizja ka përfunduar edhe studimet në nivelin Master në Universitetin e Prishtinës.

“Pas studimeve dëgjova nga një kolegë i shkollës së mesme dhe fakultetit për një pozitë pune dhe më pyetën nëse isha e interesuar të punoja në një fabrikë. E bisedova këtë punë me familjen dhe ata më mbështetën menjëherë”, shpjegon Hafizja e cila tregon se si e kishte fituar punën e parë si inxhinierë e informatikës në një fabrikë afër qytetit të saj të lindjes, Vushtrrisë.

“Në fillim ka qenë mjaft e vështirë të ambientohem, ka qenë një punë e dominuar nga meshkujt në të cilën është përdorur një teknologji mjaft e vjetërsuar”, rrëfen Hafizja për fillet e sfidave të jetës së saj profesionale. Ajo shton se me kalimin e ditëve në punë, motivimi për të punuar aty është ngritur dukshëm. Por, puna në një fabrikë asnjëherë nuk ka qenë caku përfundimtar i Hafizës.

“U bënë disa vjet angazhim në fabrikë por unë kisha nevojë të sfidohesha profesionalisht e intelektualisht, por ja atëherë fati trokiti kur atëherë Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës hapi një konkurs që i përshtatej profilit tim profesional”, tregon ajo duke mos fshehur krenarinë që e ka privilegjin të kontribojë për forcimin e shtetit të Kosovës.

Sektori i sigurisë njihet se dominohet shumë nga meshkujt por Hafizja tregon se është ambientuar shpejt në punë, kjo edhe për shkak të mbështetjes së pakursyer nga kolegët e saj. *“Kam qenë më e reja në moshë nga të gjithë kolegët dhe kam mësuar shumë prej tyre”,* shpjegon ajo duke shtuar se përveç kësaj ka vijuar edhe trajnime të specializuara për sigurinë kibernetike, disa prej tyre edhe jashtë Kosovës.

Në mesin e shumë episodeve të rëndësishme në jetën e saj ajo e veçon momentin kur Forca e Sigurisë së Kosovës transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës. Sidomos e veçantë për të u bë ngritja e Qendrës Trajnuese për Siguri Kibernetike në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes. Hafizja ka qenë bartëse e këtij projekti dhe jep më të mirën për ngritjen e kapaciteteve të sigurisë kibernetike brenda institucionit.

Në jetën personale, Hafizja është nënë e përkushtuar e dy fëmijëve, ndërsa merr mbështetje të pakursyer nga bashkëshorti. Dita e saj e zakonshme, edhe pse nga jashtë mund të duket e njëtrajtshme, nuk është aspak e tillë.

“Dita ime fillon shumë herët. I dërgoj fëmijët nënë në kopsht dhe shkoj në zyrë ku merrem me shumë detyra që kanë të bëjnë me implementimin e strategjive për siguri kibernetike. Puna ime kërkon përkushtim i cili nuk mungon. Jam shumë krenare për këtë”, tregon Hafizja. Ajo poashtu tregon se ndihet tejet e plotësuar kur vitin e kaluar kishte fituar çmimin e parë *“Gratë në Sigurinë Kibernetike – Çmimet për Profesionisten e Shquar”,* (“The Cyber Security Women – Game Changer Awards”) e cila qe zhvilluar

në kuadër të konferencës “Cyber Zero” të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Sigurisë Kibernetike dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi. Ky çmim i ka vënë në pah aftësitë e pakontestueshme të Hafizes dhe faktin se kemi të bëjmë me një profesioniste që nuk heziton të japë më të mirën për shtetin.

Për Hafizen, nocioni i sigurisë ka të bëjë me ndjenjën e të jetuarit pa frikë. Sipas saj, që një grua në Kosovë të ketë sukses duhet mjaft vendosmëri për t'i arritur qëllimet që ajo ia parashtron vetes. “Gratë tek ne nuk kanë mundësi të barabarta dhe mungesa e veprimit i

shton pabarazitë. Ato duhet të përpiqen më shumë”, thotë Hafizja duke shtuar se ekziston një mungesë guximi tek gratë për t'ia mësyer ngritjes e zhvillimit personal e profesional. Hafizen e motivon familja dhe sukcesi që deri tani e ka arritur me punën e saj vetëmohuese. Ajo nuk e ka ndërmend të ndalet.

“Tani jam e angazhuar në një ekip punues për t'i përgatitur studentët për një garë të rëndësishme të sigurisë kibernetike dhe unë kam shumë besim tek ta”, tregon ajo. Hafizja shton se gratë duhet të shohin potencialin e tyre për tu marrë

me siguri kibernetike sepse mendon se kontributi i tyre është shumë i vlefshëm në këtë fushë për shkak të aftësive të tyre për t'i parë proceset më ndryshe.

Për mendimin e Hafizes – një profesionisteje të rrallë në fushën e sigurisë – të rinjtë e të rejtat e Kosovës duhet të ngriten e të mos ndalen para pengesës së parë që iu del përpara. Mendja e saj analitike e personaliteti këmbëngulës e i guximshëm thotë se përcaktimi dhe vendosmëria janë çelësi i suksesit. “Mos hezitoni dhe mos i ndalni ambiciet për t'i arritur qëllimet tuaja”.



Gratë tek ne nuk kanë mundësi të barabarta dhe mungesa e veprimit i shton pabarazitë...

...Ato duhet të përpiqen më shumë.





▪ **za** | Gratë, Paqja dhe Siguria

Fitorja e Arbnorës

Historia Inspiruese e Arbnorës. Për çdo vit, në Las Vegas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, organizohet ngjarja për dhënie të çmimit për sigurinë kibernetike, e quajtur “Gruaja e Vitit në Sigurinë Kibernetike”, apo në gjuhën angleze “Cybersecurity Woman of the Year”.

Nominohen gra dhe vajza nga mbarë bota: Kanada, Brazili, India, Mbretëria e Bashkuar, SHBA-të, Australia, dhe jo vetëm. Shpërblehen gratë që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e sigurisë kibernetike. Në gala mbrëmjen e kësaj ngjarje, me flokët e saj të zeza plot shkëlqim, e me një fustan të zi elegant, eci në tapetin e kuq edhe Arbnora Tahiri, vajza nga Kosova. Ajo ishte në treshen finaliste të të nominuarave për çmimin Siguria Kibernetike “Zgjedhja e Popullit” (Cybersecurity People’s Choice), për vitin 2024.

Në fëmijëri, Arbnora kishte pasion matematikën dhe arkitekturën. As në ëndërr nuk e kishte parë që një ditë emri i saj do të lartësohej edhe përtej oqeanit në fushën e sigurisë kibernetike. Misioni i saj në fëmijëri të hershme, ashtu si edhe i shumë bashkëmohatarëve të saj, e besa edhe i të rriturve, ishte mbijetesa.

Vitet e 90-ta ishin vitet kur interneti filloi të zhvillohej me të madhe. Me të rritej edhe përdorimi i rrjeteve kompjuterike që çonte edhe në rritjen e mundshme të sulmeve kibernetike. Mu në këtë kohë, në qytetin e Gjilanit, lindi një yll që do të shndriste dhe t’i luftonte sulmet kibernetike, madje edhe në nivel ndërkombëtar. Arbnora ishte fëmija i parë në familjen e saj gjashtë-anëtarëshe. Pritshmëritë e prindërve për të ishin çdo herë të mëdha. Fëmijërinë e hershme e kaloi në kohën kur në Kosovë mbretëronte një gjendje e rënduar ekonomike, si pasojë e shtypjes nga pushteti serb dhe pastaj edhe luftës. Prandaj, misioni i vetëm i saj në atë kohë ishte se si të mbijetonte.

“Kam pasur një fëmijëri të lumtur, të mbushur me plot dashuri dhe mbështetje, por edhe me sfida të ndryshme. Nuk mund ta harroj luftën dhe kushtet e vështira ekonomike në fillim, të cilat na bënë të gjithëve më të fortë dhe më të vendosur për të ecur përpara”, shpalos kujtimet Arbnora duke kursyer detajet.

Për të ndihmuar sadopak ekonominë familjare, Arbnora dikur ishte punësuar në një dyqan ushqimor. Edhe pse punë jo e ndërlidhur me profesionin e saj, ajo e vlerëson lartë këtë përvojë. E bëri më të zonja në ndërtimin e marrëdhënieve dhe komunikimin efektiv.

“Fillova punën si pjesë e një sektori ushqimor dhe më pas kalova në arka,

e më vonë në zyrë, për regjistrimin e produkteve. Çfarë më kujtohet më shumë nga kjo përvojë është se puna e palodhshme është çelësi për të arritur gjithçka. Ndonjëherë duhet të fillosh nga një nivel më i ulët, por me përkushtim dhe përpjekje, mund të arrish majat që synon”.

Pasioni për matematikën dhe arkitekturën vetëm sa rritej, gjë që e shtyri të vijonte shkollën e mesme në gjimnazin e përgjithshëm “Zenel Hajdini” në Gjilan. Gjatë shkollës fillore ka marrë pjesë në gara kombëtare në matematikë dhe e ka përfaqësuar vendin në rajon. Ende nuk e kishte idenë që një ditë do të bëhej ndër gratë e para në Kosovë që studiojnë në fushën e teknologjisë informative, e që më tepër të specializohet në sigurinë kibernetike, apo që do të bëhej lidere në këtë fushë.

“Që në moshë të re, kam pasur një pasion të madh për matematikën dhe kjo më ndihmoi të zhvilloja një mendje analitike dhe të strukturuar, gjë që më ka shërbyer shumë në karrierën time të mëvonshme, në teknologji dhe siguri kibernetike”.

Ishte viti 2008, një ditë e zakonshme mësimi në shkollë, kur shokët e Arbnores po bisedonin për një kurs programimi kompjuterik. Ajo vendosi t’iu bashkëngitej. Kjo përvojë u bë dhe shkas që në vitin 2009 ajo t’i fillojë studimet për Teknologji Informative në Universitetin e Prishtinës. Globalisht ishte viti i shqetësimeve në lidhje me sigurinë kibernetike, madje edhe sigurinë e sistemeve zgjedhore dhe potencialin për ndërhyrje kibernetike.

Arbnora u largua nga familja dhe shoqëria në moshën 18 vjeçare. Filloi një kapitull të ri të jetës në qytetin e Prishtinës. Nga një shtëpi përplot me dashuri dhe mbështetje, kaloi në një dhomë në konviktin numër 3 të Universitetit të Prishtinës. Dhomën e ndante me “cimere” (bashkëjetuese) të cilat nuk i kishte njohur më parë. Ajo kishte ambicie të larta për t’u zhvilluar në profesionin e përzgjedhur, dhe fokusin e kishte vetëm tek mësimet. Nuk kishte kaluar as edhe një dekadë që nga themelimi i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Kushtet nuk ishin aq të mira, mungonte sidomos pjesa praktike. Kjo ishte koha e kompjuterëve që kishin shtëpizën deri në 10 kilogram, dhe ekranet që

poashu mund të ishin deri në 20 kg. Më i rrallë ishte posedimi i laptopëve personal.

“Kam filluar studimet në shkencat kompjuterike pa pasur kompjuter personal, gjë që e bënte mësimin dhe praktikën shumë të vështirë. Përveç kësaj, mungesa e mbështetjes ishte një tjetër pengesë e madhe. Drejtimi i studimeve në shkencat kompjuterike nuk ishte shumë i zhvilluar në atë kohë dhe kishte shumë pak studentë të interesuar dhe aq më pak vajza, të cilëve mund t’u drejtohesh pa ndihmë dhe mbështetje”.

Gjatë vitit të parë të studimeve, Arbnora u impresionua me lëndën e Kriptografisë, përmes së cilës mësohet procesi i kodimit të informatave.

“Mu pat duk shumë interesant fakti se si përmes algoritmeve të ndryshme, mund të maskohet kuptimi i një teksti duke e koduar atë, dhe duke e bërë që vetëm personi që disponon çelësin e algoritmit të jetë në gjendje të dekodojë dhe ta lexojë mesazhin”.

Në vjeshtën e vitit 2012, familja e Arbnores festuan me plot krenari diplomimin e vajzës së tyre të madhe. Me kalimin e kohës, familja ishte mësuar të jetonte dhjetëra kilometra larg njëri-tjetrit. Por, kjo largësi do të rritej edhe më shumë vitin vijues. Arbnora vendosi që mësimet për siguri kibernetike t’i vazhdonte në Oslo të Norvegjisë. Ndoshta për shkak të dashurisë së saj për matematikën, e panjohura kishte gjithmonë një joshje të veçantë për të.

“Norvegjia ofronte një program të avancuar në siguri kibernetike dhe një ambient të shkëlqyer për studime dhe kërkime. Përveç kësaj, vendet nordike ishin shumë pak të njohura për mua, dhe ky kuriozitet për të panjohurën më shtyu të zgjedhë Norvegjinë. Dëshira për të eksploruar një kulturë dhe sistem arsimor të ri ishte një faktor tjetër që ndikoi në vendimin tim”.

Në një shtet nordik, Arbnora ishte gruaja e vetme në klasë. Megjithatë, ishte e bindur se ajo si grua ka një rol të rëndësishëm dhe mund të kontribonte shumë në këtë fushë.

“Unë besoj dhe mendoj se diversiteti në këtë lëmi jep rezultate shumë më të mira, duke sjellë perspektiva të ndryshme dhe zgjidhje më inovative për sfidat e sigurisë kibernetike”.

Sipas Arbnore, përfshirja e grave në këtë drejtim tejet të dominuar nga burrat, sjell perspektiva dhe zgjidhje të reja për sigurinë kibernetike. Ky sektor nuk ka më shumë se diku pesëdhjetë vite, por është një pjesë e domosdoshme e jetës sonë moderne. Sa shumë informata i hedhim sot në internet, prej datës së lindjes, një foto duke vallëzuar e deri tek kartelat bankare. Madje mund të na ndikohet edhe vendimi se kë duhet votuar. Çdo aspekt i jetës sonë, nga komunikimi e deri te financat është i lidhur me teknologjinë, ndaj dhe duhet mbrojtur. Siguria kibernetike na mbron nga përdorimi i teknologjisë dhe na ndihmon të ruajmë integritetin dhe sigurinë e të dhënave tona personale dhe profesionale.

“Si shembull, kur përdorim telefonin për të kontrolluar emailin, për të bërë blerje online apo për të komunikuar në rrjetet sociale, ne jemi të varur nga siguria kibernetike. Nëse këto sisteme nuk janë të mbrojtura, të dhënat tona personale mund të vidhen, ose identiteti ynë mund të komprometohet”.

Me zhvillimin e Inteligjencës Artificiale, shkurt IA, nevoja për siguri kibernetike është bërë më urgjente se kurrë. IA është thikë me dy tehe: edhe ofron shumë mundësi për ta përmirësuar jetën tonë, por krijon sfida të reja dhe të komplikuar. Derisa sulmet kibernetike bëhen më të sofistikuara, mungon pjesa e rregullimit normativ të mbrojtjes. Kjo do të thotë se duhet të zhvillohen rregullore më të forta dhe më të përshtatura për të mbrojtur të dhënat dhe sistemet tona, sidomos atë çka është private dhe çka mund ta dijë publiku, që sipas Arbnore është e nevojshme në një botë ku IA po përdoret gjithnjë e më shumë për analizimin dhe përpunimin e tyre.

“Kjo kërkon një qasje të bashkërenduar që përfshin inovacionin teknologjik, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe trajnimin e vazhdueshëm të profesionistëve të sigurisë kibernetike. Ne duhet të jemi të përgatitur për këto sfida të reja dhe të sigurohemi që teknologjia të përdoret për të mirën e të gjithëve, duke mbrojtur të dhënat dhe sistemet tona nga çdo kërcënim i mundshëm”.

Sot, Arbnora është pjesë e një kompanie ndërkombëtare të teknologjisë dhe shërbimeve të biznesit me seli në Oslo. Sipas saj, kompania është e njohur për zhvillimin dhe ofrimin e zgjidhjeve të ndryshme softuerike.

“Unë jam pjesë e ekipit të sigurisë në Visma Group dhe aktualisht mbaj dy role të rëndësishme: Jam udhëheqëse e sigurisë për Visma Cloud Delivery Model (një model i krijuar për të zhvilluar dhe operuar produkte të sigurta në cloud) dhe gjithashtu udhëheqëse për programin e sigurisë së Visma Solutions”.

Kompania shquhet si kryesorja në Evropë për zgjidhjet e softuerit dhe shërbimeve të menaxhimit të biznesit. Dhe, në të dyja rolet, Arbnora e lehtëson zbatimin dhe adoptimin e Programit të Sigurisë së kompanisë në të gjithë organizatën. Puna e palodhshme, dedikimi dhe pasioni çdo herë shpërblehet. Përveç avancimit në karrierë dhe pozita më të larta, Arbnora nominohet për çmimet më të larta në fushën e teknologjisë informative. Këtë vit ajo kishte hyrë edhe në mesin e Top 50 grave në teknologji në Norvegji.

“Të jesh e zgjedhur si një nga gratë kryesore në teknologji në Norvegji është vërtet një nder i madh. E shoh këtë si një vlerësim për punën e palodhshme, përkushtimin dhe kontributet që kam dhënë gjatë rrugëtimit tim në këtë industri, dhe mendoj se ka pasur disa faktorë që më kanë çuar në këtë arritje në karrierën time”.

Rrugëtimi ka qenë dhe vazhdon të jetë përplot sfida. Ajo çdo herë është e gatshme edhe t'i marrë përsipër ato, por dhe t'i shtyjë kufijtë për t'u avancuar. Mbështetja e mentorëve, kolegëve dhe rrjeteve brenda komunitetit të teknologjisë nuk i kishte munguar dhe vazhdon edhe sot.

“Momenti më i vështirë gjatë gjithë këtij rrugëtimit, definitivisht ishte shpërngulja nga Kosova në Norvegji për t'i vazhduar studimet master dhe për të avancuar në karrierë. Ky vendim kërkonte kurajë dhe përkushtim, pasi duhej të përshtatesha me një kulturë të re dhe të përballoja sfida të reja akademike dhe profesionale”.

Studimet në Norvegji i ofruan një platformë të shkëlqyer për t'i zhvilluar aftësitë e saj dhe për ta ndërtuar një rrjet profesional të fuqishëm, që ka qenë vendimtar për suksesin e saj në fushën e sigurisë kibernetike. Pikërisht këto njohuri dhe aftësi, Arbnora planifikon që t'i shfrytëzojë edhe për ta ndihmuar vendin e saj.

“Një pjesë e rëndësishme e planit tim është edhe mbështetja e vajzave në Kosovë që dëshirojnë të hyjnë në këtë fushë. Për

këtë arsye, kam zgjedhur të jem pjesë e komunitetit “Women4Cyber Kosova”. Aty angazhohem për ta promovuar dhe përkrahur përfshirjen e grave dhe vajzave në teknologji dhe siguri kibernetike. Kjo iniciativë synon të krijojë mundësi të barabarta dhe t'i inspirojë vajzat që t'i ndjekin pasionet e tyre në një fushë që tradicionalisht ka qenë e dominuar nga burrat”.

Duke qenë vet dëshmitare e rëndësisë së edukimit të vazhdueshëm, Arbnora është padyshim avokuese e edukimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes së komunitetit në sigurinë kibernetike.

“Mbështetja e komunitetit, përmes rrjeteve profesionale dhe grupeve të interesit, ofron një platformë për ndarjen e njohurive dhe zgjidhjen e problemeve. Edhe roli i modeleve frymëzuese është thelbësor. Të kesh figura suksesi në fushë motivon dhe inkurajon gratë dhe vajzat e reja që të ndjekin dhe t'i arrijnë objektivat e tyre, duke ndihmuar në krijimin e një ambienti më të larmishëm dhe gjithëpërfshirës”.

Arbnora po që është një figurë suksesi me një personalitet inspirues që motivon sidomos gjeneratat e reja të grave. Nga një qytet i vogël, e lindur në kohë trazirash, Arbnora na dëshmon se pasionin duhet ta ndjekim, e ta ushqejmë me punë.

“Vajza dhe gra, mos dyshoni kurrë në ëndrrat ose potencialin tuaj. Nëse keni një pasion për teknologjinë, ndiqeni atë me gjithë forcat tuaja. Punoni fort dhe mos hiqni dorë nga aspiratat tuaja, çfarëdo që të jenë ato. Më e rëndësishmja, kërkoni mundësi për mentorim dhe lidhje e rrjetëzim. Krijoni lidhje me gra të tjera dhe profesionistë në komunitetet e teknologjisë dhe sigurisë për udhëzime, mentorim dhe mbështetje”.

Nga një fëmijë që ëndërr e kishte mbijetesën, rrugëtimi i Arbnore deri tek suksesi, tregon se me vendime dhe plane të mira, pasion dhe dedikim të palëkundur, arritjet janë të mundshme dhe shpeshherë të jashtëzakonshme. Arritjet e saj në Norvegji dhe SHBA janë dëshmi e fuqisë së këtyre vlerave, duke e bërë atë një shembull frymëzimi për të gjithë ata që ëndërrojnë të arrijnë më shumë. Sot, Arbnora jeton në shtëpinë e saj në Oslo, së bashku me bashkëshortin dhe dy vajzat e vogla të cilat e përmbushin jetën e tyre me shumë dashuri.

“

Vajza dhe gra, mos dyshoni kurrë në ëndrrat ose potencialin tuaj. Nëse keni një pasion për teknologjinë, ndiqeni atë me gjithë forcat tuaja. Punoni fort dhe mos hiqni dorë nga aspiratat tuaja, çfarëdo që të jenë ato. Më e rëndësishmja, kërkoni mundësi për mentorim dhe lidhje rrjetëzim. Krijoni lidhje me gra të tjera dhe profesionistë në komunitetet e teknologjisë dhe sigurisë për udhëzime, mentorim dhe mbështetje.



”

Foto nga ngjarja Norway's Top 50 Women in Tech

Një sakrificë si kjo e Besianes

Është e pabesueshme e për çudi se çka mund të rezervojë e ardhmja. Për dikë që jeton në një komunitet të marginalizuar të një qyteti të vogël të Kosovës, ndodhë një ditë bëhet një nga heronjtë e përditshëm në shërbim të njerëzve. Në ata heronj që e kanë për detyrë të kujdesen për sigurinë e mirëqenien e të gjithëve.

Për 20-vjeçaren nga Peja 'të jesh në gatishmëri çdo ditë për të ndihmuar të pafuqishmit e të cenueshmit është puna më e mirë në botë'. Për këtë punë ajo flet me një seriozitet të një profesionisti me karrierë. Shumë rrallë më ka rastisur të flas me dikë që i ka dy dekada jetë. Ajo kur flet për punën e saj, shprehet me kompetencë të natyrshme saqë të lë përshtypjen se ka lindur për atë punë dhe ajo uniformë është prerë për të.



Besiana Sejdijaj është police e rendit në Republikën e Kosovës. Qasja e saj e punës e bën atë që të jetë më shumë se aq. Personaliteti dhe afërsia e saj që vibron, ndikon jashtëzakonisht shumë në ngritjen e besimit në unifromën e policisë tek njerëzit që ajo i ndihmon. Qasja e saj pozitive është tejet e rëndësishme në lokacionin e ndjeshëm ku është aktualisht e vendosur, në Zubin Potok.

“Më tregojnë se kur kam qenë 3-vjeçare, e kam parë një polic në unifromë derisa ka hyrë në spital dhe jam frikësuar shumë”, qesh Besiana duke treguar se si fati e preku si në përrallë. *“Me të vërtetë, kur e kam veshur unifromën për herë të parë nuk e kam njohur veten. E kam përjetuar jashtëzakonisht si një transformim shumë pozitiv në jetën time”,* shprehet me plot krenari Besiana teksa mban veshur një fustan të hijshëm veror.

Tani ka gati një muaj e gjysmë prej se ka nisur punën e rregullt në stacionin policor në Zubin Potok. Për të shkuar atje, Besianës i duhet një disiplinë e vullneti i jashtëzakonshëm që çdo ditë të zgjohet në orën 4 në mëngjes, rreth 60 kilometra vajtje- ardhje. Udhëtimin e përditshëm e bën bashkë me kolegët e saj, duke u nisur nga Peja me veturë për në komunën e Mitrovicës së Veriut. Ajo është gruaja e vetme që udhëton bashkë me kolegët e saj për në stacion.

Gjatë shkollës së mesme Besiana ka punuar edhe si vullnetare, në rolin e mediatores e përfaqësueses së komunitetit Egjiptian në organizatën “Syri i Vizionit” në Pejë. Përvoja i ka dhënë njohuri të rëndësishme jo vetëm mbi punën në këtë institucion por, edhe është njohur me nocionet e të drejtave njerëzore. Për më shumë, ajo ka punuar edhe si asistente juridike, punë e cila i ka mundësuar asaj për të kuptuar se si funksionon e si duhet të zbatohen ligjet.

“Kam qenë e angazhuar edhe si mësimdhënëse e klasave shtesë për ciklin e arsimit të ulët e njëkohësisht kam marrë edhe certifikata për trajnimet në të cilat kam marrë pjesë me shumë përkushtim”, tregon ajo me modesti. Por, me të mbaruar edhe shkolla e mesme, kishte përfunduar edhe angazhimi i saj vullnetar në atë organizatë.

“Por edhe pas kësaj, jetës nuk i dihet. Më pas, një familjar imi kishte biseduar me

një polic i cili i kishte treguar se në janar hapet konkursi për të apliku në Polici për komunitetet në veri. Nuk kam menduar dy herë”, shprehet me entuziazëm Besiana, duke rrëfyer se fillimisht familja e saj ishte skeptike për këtë angazhim. Por as dyshimet e familjes nuk e kishin zbehur përcaktimin e Besianës për t’iu bashkuar forcave të rendit. *“Kam diskutuar punën me familjen dhe ju kam thënë se jam e gatshme ta jap edhe jetën për vendin tim”,* thotë Besiana me vendosmëri edhe sot.

Pasi që familja ishte pajtuar me vendimin e saj, Besiana është përballur me një seri fazash jo të lehta të testeve para se t’i bashkohej Akademisë së Policisë në Vushtrri.

Për veten ajo thotë se gjithmonë ka qenë fëmijë paqësor që është përkrahur nga prindërit në çdo moment. *“Kam ditur mirë si ta shfrytëzoj lirinë time, edhe në shtëpi me familjen por edhe në shkollë me shoqërinë, gjithmonë kam ditur që t’u rri larg njerëzve me influencë negative”,* shprehet Besiana duke shtuar se veten e sheh si person motivues.

Pas tre muajve në Akademinë e Policisë caktohet të punojë në stacionin e komunës së vendosur në Rrethin e Mitrovicës në Kosovë, në Zubin Potok. *“Kur e kam veshur unifromën herën e parë jam ndjerë shumë speciale, jam ndjerë si në film”,* thotë ajo me gaz në buzë dhe shton se për ta bërë punën mirë së pari duhet që ta duash atë.

Një ditë e punës së Besianës duket krejt e zakonshme, por vetëm nga jashtë. Ajo tregon se çdo ditë ka përvoja të reja, pozitive dhe negative dhe se pak i pengon që nuk e kupton mirë gjuhën serbe. Shprehet se ndihet shumë mirë kur merr komplimente për sjelljen dhe përkushtimin në punë nga njerëzit që i takon.

Puna e sigurisë – edhe e asaj publike – në përgjithësi nga njerëzit perceptohet si punë burrash për shkak të stereotipeve që bartin profesionet. Kjo e bën Besianën të nxjerrë në pah anën luftarake të saj e cila nuk pajtohet me botëkuptime të prapambetura.

“Po ka sfida për një grua të punojë në polici, por ka poashtu edhe paragjykimet nga qytetarët sepse mendojnë se gratë nuk duken mjaftueshëm të afta për të qenë police”, shpjegon Besiana duke shtuar se ajo e ushtron detyrën sipas ligjit e

për këtë e ndihmojnë edhe parimet e saja profesionale. *“Nuk më pengon që më gjykojnë”,* thotë tutje duke shtuar se përkushtimi i saj profesional nuk bën dallime në mes gjinive.

Besiana ka pasur mjaft raste kur e ka dhënë më të mirën për t’i ndihmuar gratë kur kanë qenë në rrezik sigurie. Këto raste kur ajo ka ndërhyrë me shumë kujdes e zgjuarsi, janë ato që janë raportuar në stacionin ku ajo punon si raste të dhunës në familje.


“Nuk më pëlqejnë traditat e prapambetura që nuk e fuqizojnë gruan, më saktësisht vajzat e reja sepse ato duhet të kenë mundësinë për t’i kontribuar zhvillimit të shtetit, por për këtë së pari duhet të edukohen”, vlerëson Besiana duke përmendur edhe gratë e komunitetit Egjiptian të cilat thotë se duhet të kenë mundësi më të mëdha. Ajo e drejton gishtin tek prindërit, sidomos tek baballarët për të cilët thotë se duhet t’i nxisin vajzat e tyre që të arrijnë më shumë e jo të jenë pengesë në zhvillimin intelektual e profesional të grave.

“Unë bëj aq sa mundem për të diskutuar me prindërit e vajzave dhe u them se ata duhet t’u japin liri atyre që të shkojnë në shkollë e të edukohen që të arrijnë diçka në jetë”, tregon Besiana dhe shprehet se ende ka shumë dhunë në familje dhe ka shumë gra që nuk lejohen të ecin përpara.

Edhe pse nuk ka shumë kohë të lirë, Besiana thotë se këto ditë vere po i shfrytëzon për t’i dedikuar për pasionin e saj jetësor, leximin. Ajo tregon se këto ditë e ka përfunduar një libër biografik për një person mjaft interesant. *“Është biografia për muzikantin Ukë Gjakova, që njihet si defatori më i njohur i komunitetit Egjiptian. Ai tani jeton në Gjermani dhe ka qenë shumë i kërkuar sidomos nëpër dasma”,* tregon Besiana duke shtuar se jeta e tij është një histori e pabesueshme peripecish e aventurash. Por, tregimi i tij e motivon.

Për veten tregon se ka shumë nevojë për t’i inspiruar e shtyrë të tjerët që t’i arrijnë qëllimet në jetë. *“Unë e konsideroj veten në shërbim të njerëzve. Motivi im jetësor është atdheu e familja”,* thotë Besiana duke inkurajuar gratë që t’i vënë vetes qëllime e mos të ndalen derisa t’i realizojnë ato.

“Në jetë duhet të jesh vetvetja, e zonja e vetes. Motivoni veten e kurrë mos hiqni dorë nga synimet për tu bërë më të mira”.



Adresa e Sigurise

Qetësia është virtyt i njerëzve të fortë, i atyre individëve që kanë pasur ditë të panumërta sfiduese, por, jo nga ato sfida për të cilat njerëzit ankohen duke pirë kafe me shoqërinë.

Jubilea Kabashi është zonjë, por jo një e zakonshme. Ajo është një zonjë e qetë. Zëri dhe sytë ia zbulojnë se sa e fortë është ajo. E sa është e fortë, kjo nuk mund të matet, e më së paku me fjalë.

E lindur dhe e rritur në Prizren, Jubilea ka ardhur në jetë në ditën e jubileut të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, datë kjo nga e cila edhe e mori emrin. Megjithatë betejat e jetës së saj si grua janë kronika personale tejet të vështira për tu thënë e për tu shkruar, e lëre më të imagjinohen.

Si nënë e dy vajzave që kanë nevojë për përkujdesje dhe si udhëheqëse e Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, Jubilea Kabashi ka kurajë guri për tu zgjuar herët çdo mëngjes e për të marrë mbi vete dhimbjen e dramës personale dhe atë të qindra grave që i besojnë asaj.

“Jam rritur në një familje me shumë dashuri për njëri-tjetrin. Jam rritur tu besoj njerëzve dhe jam rritur me dëshirën për punë”, tregon ajo duke shtuar se ka qenë e veçantë dëshira për lexim që asaj ia kultivoi babai i saj. Shprehet se ka qenë fëmijë i urtë dhe se gjithnjë ka bërë zgjedhje të urta.

Jubilea dëfton se karakteri dhe këshillat e prindërve të saj e kanë ndihmuar shumë në sfidat e pandalshme me të cilat ajo do të ballafaqohet më vonë. *“Në shkollë kam qenë një nxënëse tejet e qetë por, shumë aktive...shkruaja poezi e bile kam marrë pjesë në shumë orë letrare që organizoheshin në atë kohë”*, shpjegon rrugëtimin e saj Jubilea.

Pas studimeve, ajo punoi si mësimdhënëse e gjuhës angleze në disa fshatra të Prizrenit, por e ndërpreu këtë punë pas martesës me dashurinë e saj, Edmondin. Në vitet e '90-ta ajo qëndroi në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët.

“Edmondi ka qenë argjendar, artizan i filigranit. Kemi pasur dyqanin në Shadërvanin e Prizrenit”, rrëfen Jubilea. Ka një pauzë dhe për një moment e ndalon bisedën për të kujtuar dhe nuk flet. *“Më ka pëlqyer shumë ta shikoj Edmondin duke punuar në filigran”*. Ky zanat është i rrallë dhe i veçantë që kërkon shumë forcë për ta tërhequr telin e argjendit apo të artë, të cilat bëhen hijshëm në trajtën e një dantelle të thurur me fije të holla e të dredhura. Prandaj, më rrallë punohet nga gratë për shkak të forcës fizike.

Vitet e 90-ta për Jubilenë kanë qenë dramë në vete. *“Ne kemi banuar në shtëpinë tonë në Shadërvan dhe gjatë bombardimeve shpesh e kemi pasur të pamundur të dalim të blejmë ushqim. Kemi qenë tërë kohën në shtëpinë tonë në Prizren”*, tregon ajo. Shton se fqinja e saj serbe i ka ndihmuar që ta dijë nëse është e sigurtë për të dalë nga shtëpia për ushqim. *“A po del me ble limona a?”*, ka qenë kodi i fshehtë për t'ia bërë të ditur Jubileas se është rrezik të dalë nga shtëpia sepse paramilitarët ishin afër shtëpisë së tyre.

Gëzimi i çlirimit të Kosovës për Jubilea Kabashin nuk zgjati. Vetëm gjashtë muaj pas hyrjes së forcave të NATO-së (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) në Kosovë, Edmondi, filigrinasi

i saj e i dantellave të Prizrenit, ndërroi jetë duke e lënë Jubilenë me dy vajza të vetme. *“Ajo periudhë më tjetërsoi. Pa burrë, pa punë e me dy fëmijë të vegjël, mendova se ky ishte fundi i jetës”*, shprehet. Por ky epilog ishte vetëm fundi i një episode në rrëfimin e saj sepse jeta kishte plane tjera për Jubilea Kabashin.

Më 2002, pas afërsisht dy vitesh përpjekje për sigurim të jetesës nga muaji në muaj, një ditë Jubilea e pranon një telefonatë nga mikeshja e saj Elita, e cila i propozon asaj angazhim në Qendër të Viktimave të Dhunimit. *“Atë telefonatë nuk kam për ta harruar asnjëherë në jetë, ka qenë diçka aq e papritur dhe aq e pabesueshme”*, mallëngjehet ajo duke shtuar se puna në atë qendër e ka bërë atë të kuptojë një realitet të cilin as nuk e kishte imagjinuar. *“Aty kam kuptuar se në çfarë përmasash të paimagjinueshme mund të shkojë tragjedia njerëzore”*, shprehet ajo. Ajo telefonatë në mbrëmje, do ta përfshinte Jubilean në ujëra të cilat nuk i kishte paramenduar se ekzistojnë as nëpër filma e lëre më në jetën reale.

Pas pak kohe programi i Qendrës mbyllet dhe Jubilea sërish detyrohet të rikthehet në rolin e shtëpiakes, nënës, kujdestares e kryefamiljares për dy vajzat e saj. Por prapë, jeta kishte plane tjera për zonjën Kabashi.



Ceremonia e pranimit të Mirënjohjes!

Foto e huazuar nga rrjete sociale.

“Në më pak se një vit, dy punëtorë ndërkombëtarë më kërkuan të takoheshim për të parë strehimoren e vjetër dhe pas kësaj ata më propozojnë që unë ta udhëbeq”, rrëfen Jubilea duke shtuar se fondet mbështetëse për nisjen e punës kanë ardhur nga një agjenci e Kombeve të Bashkuara.

Angazhimi me viktimat e dhunës ka lënë gjurmë të pashlyeshme tek Jubilea. Ajo shpjegon se rrëfimet e grave kanë ndikuar shumë keq në mirëqenien e saj, për shkak se karakteri i saj human dhe empatik nuk ka mundur të besojë në ekzistencën e atij niveli të ligësisë ndaj gruas.

“Trupat e KFOR-it (Forca e Kosovës), kanë qenë gjithnjë në ndihmë dhe vëzhgim e poashtu kemi pasur edhe vullnetarë që na kanë ndihmuar”, tregon ajo duke shtuar se megjithatë në qytet ka pasur mjaft paragjykime jo të mira për punën e saj në strehimore për shkak të pikëpamjeve e qëndrimeve konzervative mbi gruan e familjen. “Ka qenë luftë e vërtetë të sigurosh fonde për qendrën”, thotë Jubilea duke bërë të kuptohet se shpirti i saj luftarak e ka bërë më të mirën që puna në qendër të vazhdojë e viktimat e dhunës të kenë një vend të sigurtë dhe larg frikës.

Ajo shprehet me një falënderim të madh për mjekët e qytetit të cilët kanë qenë gjithnjë në dispozicion të viktimave të strehimores. “Mjekët poashtu më thonin që edhe unë duhet të kem kujdes e të mos i marr afër zemrës rastet. Ne kemi punuar me shumë zemër e me shpirt e kur punon ashtu çdo ditë duke mos e kursyer asnjëherë veten, kjo nganjëherë mund të ndikojë keq në shëndet”.


Jubilea tregon se ka dallim të madh prej rasteve të viktimave atëherë krahasuar me sot, për shkak se sot gratë janë shumë mirë të informuara për të drejtat e tyre, “Sot janë më të arsimuara, i dinë shumë qartë se cilat janë të drejtat e tyre. Mentaliteti më parë ka qenë shumë më kërcënues”, thotë ajo gjersa rikujton viktimat që strehoheshin me fëmijë të vegjël të uritur.

Jubilea, rëndësinë e sigurisë si koncept e krahason me kushtetutën e një vendi. “Siguria është elementi esencial për mirëqenien e njerëzve e të shoqërisë. Pa siguri nuk ka zhvillim shoqëror”, thotë ajo. Për ta ngritur aspektin e sigurisë tek gratë viktime, strehimorja i angazhon ato në programe për aftësim

profesional, pas të cilit potencialisht ato pavarësohen. “Unë kam dëshirë me e pa vendin tim me njerëz që jetojnë me dinjitet”, shpjegon Jubilea duke shtuar se edhe pabarazia sociale është një faktor madhor i dhunës. Ajo na tregon se në shtëpitë ku njëri partner e kontrollon kuletën e të ardhurat, aty ka shumë potencial për dhunë ekonomike.

Për Jubilean, rrugëtimi i saj profesional është një tregim i bukur i fuqisë e qëndresës së shpirtit njerëzor. Ashtu edhe do të vazhdojë. “Unë i kam dy shtëpi, atë timen dhe strehimoren e në mes tyre ndodhë jeta ime”.

Siguria është elementi esencial për mirëqenien e njerëzve e të shoqërisë. Pa siguri nuk ka zhvillim shoqëror.



za | e nisën nga zero

Mbrojtja e sigurisë dhe paqes është një rrugëtim i gjatë...

Dreshaj dhe Shala me kolegë tjerë studentë, filluan angazhimin në akcionin për pajtimin e gjaveve, duke pa këtë si të vetmen formë për të krijuar rezistencë ndaj regjimit të atëhershëm.

Liria, parakusht i paqes

*Çfarë është paqja për ju? -
e pyetëm Hava Shala Gërgurin.*

“Parakusht i paqes është liria dhe barazia. Pa qenë të lirë pjesëtarët e një shoqërie, nuk mund të ketë paqe shoqërore. Pa qenë njësoj të trajtuar të gjithë pjesëtarët e të gjitha grupeve etnike të një shoqërie, nuk mund të ketë asnjëherë paqe. Barazia dhe paqja shoqërore janë parakushti i përparimit dhe i mirëqenies. Paqja fillon me mua”, u përgjigj ajo.

Me thënien, *“paqja fillon me mua”*, Hava Shala Gërguri mishëroi epitetin e një aktivisteje të palodhshme. Një luftëtare për drejtësi, edhe kur kjo i kushtoi asaj lirinë apo edhe i rrezikoi jetën. Angazhimi i saj nuk u ndalë as pas torturave dhe viteve të kaluara në burg, as atëherë kur me guxim filloi Aksionin e Pajtitimit të Gjaqeve, duke u rreshtuar në vijën e parë të kësaj nisme që ndryshoi fatet e shumë familjeve. As në persekutimet politike. As vështirësitë e jetës si emigrante në Zvicër nuk mundën ta thyejnë shpirtin e saj të papërkulur. Hava mbeti një zë i fuqishëm dhe i patrembur. Ajo është një simbol i kurajos dhe përkushtimit ndaj kauzave të mëdha, duke u bërë frymëzim për të gjithë ata që kërkojnë ndryshim me çdo çmim.

Historia e Havës fillon në fshatin Rashiq, në lugun e Baranit, në vitin 1966. U lind në një vend të bukur malor, të cilin izolimi nga fshatrat e tjera dhe mungesa e mundësive të qarkullimit e bënin të dukej si një vend idilik. Jeta në mal dhe mentaliteti i kohës padyshim që paracaktonte edhe detyrat, përgjegjësitë dhe rrjedhën e jetës për të gjitha gratë dhe vajzat... mbase jo për të gjitha, sepse kishte edhe vajza të tilla të cilat “devijonin” nga kjo rrjedhë, e ndër to ishte edhe Hava.

Është e vështirë që guximi e vendosmëria e Havës t’i atribuohet vetëm një elementi burimor. Padyshim që karakteri i saj luftarak dhe ndjeshmëria ndaj padrejtësive ka luajtur një rol të madh, por edhe të pasurit model figura të grave që nuk dorëzohen ishte rrënjësore për të. *“Unë jam rritë në një familje ku gjyshja ka pasë një rol shumë shumë domethënës në familje. Ajo i ka rritë fëmijët vetëm sepse gjyshi më ka vdekë shumë i ri. Ajo i takonte gjeneratës kur shumë burra ishin vrarë në Luginën e Baranit si pasojë e kolonizimit të malazezëve”*, fillon intervistën Hava.

Gjyshja e saj ishte kryefamiljare që nuk i lëkundej qerpiku para telasheve me të cilat e përballte jeta. Me përpjekje të

vazhdueshme për ta mbrojtur shtëpinë e familjen, ajo vet i rriti fëmijët e shërbeu edhe si grua model për pasardhësit e saj. “Molla kurrë nuk bie larg pemës” thotë një proverb. Hava mori shumëtribute nga gjyshja e saj.

Dëshira që Hava kishte që të bënte diçka me jetën e saj, e shtyu atë që t’i dedikohet shkollës dhe të edukohet përmes librave. Edhe si nxënëse, mendja e saj kurioze dhe nevoja për të ditur se si ishte situata politike në Kosovë, i vinte në pozitë të sikletshme mësuesit e saj përmes pyetjeve, përgjigjet e së cilave nuk mund t’i ndanin me të tjerët për shkak të persekutimit. Në vitin 1981, atëherë kur tensionet etnike filluan të ngritshin, Hava ishte në shkollë filllore në klasën e tetë në Lugun e Baranit.

Potenciali për një shpërthim të luftës nuk e stepi Havën për të kërkuar tutje zhvillim intelektual. Vendosi të regjistrohej në shkollë të mesme në Pejë së bashku me kushërirën e saj. Në njërën anë, rezistencë pothuajse e patejkalueshme ishte shkollimi në gjuhën shqipe që mendohej të sabotohej nga regjimi serb. Në anën tjetër, të përshkohsh dhjetra kilometra në rrugë të pashkelur nga Rashiqi në Pejë si një vajzë e re ishte e mundimshme.

Hava e emocionuar na tregon: *“Në atë kohë nuk ke pasë alternativa të shumta. Ose të heshtësh dhe të mos jesh vetja jote, ose të flasësh dhe të marrësh përsipër përgjegjësinë për fjalën tënde. Hava prek të gjitha format e lirisë tekta flet se si ishte e drejta për të marrë përgjegjësitë “për këngën, poezinë, për ngjyrat, për protestën, për një pamfletë të shkruar, për një pllakatë, të cilat ishin rreptësisht të ndaluara”*.

Në vitin 1984, kur ishte vetëm 17 vjeçare, ajo u arrestua së bashku me gjashtë vajza dhe dy djem të tjerë. Për shkak të numrit më të madh të vajzave në të, grupi njihet si «Grupi i Vajzave të Pejës». Secila komunë kishte grupet e ndara. Arrestimi i tyre ishte i motivuar politikisht, si pasojë e përpjekjeve për të protestuar kundër padrejtësive të përditshme që hasnin në shkolla dhe në rrugë, dhe për të mbrojtur lirinë e shprehjes.

“Në shtatorin e vitit 1984, ne, vajzat dhe djemtë, shokët, shoqet tona, shkruam një letër protestë dhe e shumëzuam në formën e pamfletit dhe e shpërndamë. Për këtë vepër të jashtëzakonshme u dënuam”, kujton ajo periudhën e

cila i kushtoi me burgim për katër vite, duke e ndërprerë shkollimin e mesëm. Në këtë pamflet të shpërndarë flitej për pabarazinë e skajshme dhe diskriminimin intensiv të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, që iu ipte të drejtën legjitime për të protestuar në të gjitha mënyrat për mbrojtjen e së drejtës për të jetuar me dinjitet.

Shërbimi sekret serb zbuloi aktivitetet e tyre të cilat ata i etiketonin si nacionaliste dhe propagandistike, e që i dërgoi këta të rinj në burg. I keqtrajtuar fizikisht dhe emocionalisht. Hava qëndroi në burg katër vite, nga viti 1984 deri në dhjetor të vitit 1988, kryesisht në burgun e Mitrovicës. Një pjesë të konsiderueshme të kësaj periudhe e kaloi në qeli, e izoluar, duke mos pasur kontakt me askënd.

“Burgu i Mitrovicës ka qenë brutal. Ka provuar në çdo mënyrë, të thyejë njeriun dhe ta reduktojë esencën e tij njerëzore... atë ditë kur jam transferuar në burgun e Mitrovicës kam parë sa i hollë është kufiri mes jetës dhe vdekjes”, shpjegon ajo.

Muajt dhe vitet kalonin, por për Havën koha kishte humbur kuptimin. Megjithatë, vizioni i një Kosove të lirë, ku secili kishte të drejtën të merrte frymë, të punonte, të arsimohej dhe të shoqërohej pa frikë, e mbante atë larg dorëzimit në dëshpërim. Edhe në një ambient ku shpresa dhe ëndrrat ishin të destinuara të shuheshin, Hava ruante gjallë brenda vetes edhe ato pak shkëndija të fundit të pozitivitetit.

“Kam qenë në qelinë numër tre. Vetëm. Krejt vetëm. Ka qenë një kapitull i veçantë i jetës sime sepse atë ndjenjë nuk mund ta përshkruaj me fjalë. Ka qenë lufta më intensive për të mos u çmendur”, rrëfen ajo duke rindjerë vetminë që i kishte izoluar mendjen e shpirtin e duke mos arritur ta artikulojë asnjëherë me fjalë atë që ajo ka përjetuar në atë masë sa e kishte përjetuar në të vërtetë. Mbase, Hava dëshiron që t’i kursejë dhe të mos i trishtojë ata që dëgjojnë e lexojnë rrëfimin e saj. E me një ton të qetë nëpërmjet të cilit mund ta ndjesh një buzëqeshje në fytyrën e saj, ajo thotë: *“Kam kënduar shumë, kam improvizuar, kam pasur nevojë ndonjëherë që thjeshtë të këndoj në kupë të qiellit për ta thyer atë heshtje të tmerrshme”*.

Qëndresën, si cilësi, mund ta ketë marrë nga gjyshja dhe nga telashtet e njëpasnjëshme me të cilat e kaliti jeta, sepse ajo nuk u ndal edhe pasi u lirua nga burgu.

“Ne u burgosëm sepse gjithçka ishte e ndaluar. Gjithçka shqiptare. Qenia jonë ishte e ndaluar. Është dashur të mos jesh ajo që je ose të luftosh për të mbetur ajo që je”.

Në fillim të vitit 1990, Kosova humbi autonominë e saj kulturore dhe politike, dhe shqiptarët filluan të përjashtoheshin masivisht nga jeta sociale. Vendi ishte përfshirë nga një valë protestash dhe demonstratash paqësore kundër padrejtësive. Regjimi serb nuk ngurronte të përdorte forcën ndaj demonstruesve, duke i portretizuar vrasjet e tyre si qerime hesapesh familjare. Këtë pretendim e përforcoi edhe ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë me një deklaratë pas vrasjes së disa të rinjve dhe të rejave shqiptare nga policët serbë gjatë protestave, të cilat i konsideroi si vrasje për gjakmarrje mes shqiptarëve e jo si të bëme të policisë serbe, thotë Hava.

Ishte pikërisht kjo deklaratë që e shtyu Havën të takohej me shoqen e saj të ngushtë (po ashtu ish e burgosur politike), Myrvete Dreshaj, për të diskutuar idenë e nisjes së pajtimit të gjaqeve. Qëllimi i tyre ishte t'i hiqnin regjimit mundësinë për të përdorur gjakmarrjen si alibi për vrasjet mizore. Idenë e bashkëbiseduan me aktivistë të tjerë dhe u vendos që Aksioni i Pajtitimit të Gjaqeve të fillojë të realizohet.

Aksioni filloi duke përzgjedhur fillimisht familjet që ishin raste që kërkonin ndërhyrje urgjente në mënyrë që gjaku të falej. Padyshim që në këto diskutime kërkohej durim e maturi. Duheshin argumente të qëndrueshme e bindëse, në mënyrë që një familje të tejkalonte humbjen e një anëtarit. Një nga argumentet më të fuqishme që Hava dhe të tjerët vazhdimisht përdornin ishte që falja dhe bashkimi ishin domosdoshmëri e periudhës në të cilën po jetonin. Kjo e shpjegon më së miri që falja e gjaqeve në Kosovë ishte e suksesshme sepse shqiptarët i bashkonte nevoja për të qenë të bashkuar kundër një force tjetër që ishte shtypëse.

Një pjesë e madhe e këtyre diskutimeve ndodhnin nëpër oda, rrethuar me burra dhe kryepelq. Tradicionalisht në hapësira dhe diskutime të tilla, gratë dhe vajzat nuk janë pranuar as të hynin në to. Hava dhe shumë bashkëpunëtore të saj hynë nëpër këto hapësira duke ndryshuar rregullat patriarkale. Hyrja e tyre arriti të gëzojë respekt të veçantë

për këtë ndërmarrje paqësore. Të burgosurat politike çmoheshin edhe më shumë nga populli, me ç'rast hyrja në oda bëhej e pranueshme, sepse ata e kuptonin që ishin gratë ato që kishin refuzuar regjimin. Prandaj, paralelisht me shtypjen etnike, vajzat e përfshira në Aksionin e Pajtitimit të Gjaqeve luftuan edhe shtypjen gjinore duke dëshmuar që hyrja e tyre në jetën publike ishte një domosdoshmëri.

Përndjekjet politike u bënë shumë më intensive dhe Hava u detyrua që aktivizimin e saj ta vazhdojë nga pozicioni i një refugjates në Zvicër, Seuzach. Vendimi për ta lënë Kosovën ishte një nga vendimet më të rënda që mori në jetë.

“Lashë aktivitetet në Kosovë për t'i vazhduar më pas në mërgimin që fatkeqësisht po shtohet. Fatkeqësi, e cila falë aktiviteteve të organizuara, po kthehej fuqishëm edhe në një forcë të rëndësishme përkrahëse në Kosovë”, rrëfen me pikëllim ajo.

Edhe larg Kosovës, ajo ofroi nxitje të reja të aktiviteteve me nxënësit e shkollës shqipe dhe prindërit e tyre. Ajo përpiquej ta kompensonte mungesën e lidhjeve me vendlindjen. Angazhimi në institucionet e vendit ku tanimë jetonte i mundësonte të informonte mbi gjendjen e rëndë të popullit të saj dhe të fitonte mirëkuptim dhe mbështetje.

Hava vazhdon të jetojë në Zvicër, përkatësisht në Seuzach. Ajo punon si këshilltare në Zyrën për Integrim në Winterthur dhe si mbështetëse sociale-pedagogjike për familjet emigrante. Përvoja e saj jetësore dhe ndjeshmëria ndaj gjithë atyre që kishin lënë vendin e tyre për një jetë më të mirë e bëri atë një zrytare shumë të përshtatshme për ta mbajtur këtë pozitë.

Lugu i Baranit të Pejës nxori një personalitet që ndryshoi rrjedhën e historisë së Kosovës. Hava shpërfaqti fuqinë e lirisë dhe tregoi se një jetë pa të është e pavlerë. Ajo bëri që të kuptohej se liria është jo vetëm një ideal, por një parakusht për paqe të qëndrueshme. Me veprimet dhe qëndrimin e saj të palëkundur, Hava ngriti flamurin e luftës për liri dhe paqe, duke frymëzuar një komb të tërë dhe duke e bërë këtë kauzë një pikë kyçe në betejën për drejtësi dhe jetë me dinjitet.



Kam kënduar shumë, kam improvizuar, kam pasur nevojë ndonjëherë që thjeshtë të këndoj në kupë të qiellit për ta thyer atë heshtje të tmerrshme



Igo kundër stigmës

“Një e vetme e mirë mund të ndihmojë për ta ndryshuar botën, dhe ky ndryshim fillon me një veprim të vogël.” – kishte thënë Shën Nënë Tereza. Nuk është e rastësishme pse po përmendim simbolin e filantropisë shqiptare.

Kështu kishte filluar edhe Igballe Rogova, me veprime të vogla por që çuan në ndryshime të mëdha dhe ndikuan në mënyrë pozitive në përmirësimin e pozitës së gruas në Kosovë.

Vendosmërinë e kishte shprehur qysh në moshë të re. Ishte 14 vjeçare kur trajneri i karatesë i kishte thënë që nuk mund të ushtronte me djem. Sporti i karatesë i interesonte më së shumti prej krejt sporteve.

“Është interesant, e kom lon në momentin kur trajneri tha ‘jo, s’guxon ti me u rre as me ushtru me djem’. Neve çikave na shtike me bo veq ‘kata’ me ‘imaginary opponent’ (kundërshtar imagjinar), edhe nuk munesh me luftu... unë kisha qef me luftu e ai thojke s’bon. Edhe e kom lon...e kom pas shiritin kafe”. Shiriti kafe është niveli i pestë, i parafundit para të ziut që është niveli më i lartë.

Igballja, apo siç njihet në publik, Igo, ishte fëmija më i vogël. Ishin gjashtë motra dhe tre vëllezër, dhe mund ta imagjinojmë dinamikën në shtëpinë e tyre në qytetin e Prishtinës. Emri i saj në shqip do të thotë ‘fat i mirë’, dhe si më e vogla që ishte, të gjithë kujdeseshin për të. Prindërit kishin një dyqan, babai qepte jorganë, nëna edhe ndihmonte me punët e dyqanit dhe poashtu kujdesej për punët e shtëpisë dhe fëmijëve. Igballja kujton nga fëmijëria se *“edhe pse prindërit me arsim jo të lartë, kurrë, na kanë thonë, as motrave dhe as mu, se qyq që kjo është për ty se je çikë, apo kjo nuk është për ty se s’je djalë. Ka qenë liria totale.”*

Fuqizimin e parë që Igballja kishte marrë nga familja ishte kur motra e saj, Safete Rogova, vendosi t’i vijonte mësimet për aktore. Ishte në mesin e aktoreve të para në Kosovën e asaj kohe kur mendohej se aktrimi dhe teatri nuk ishin për gra; ishin vitet e 60-ta. Safetja theu stereotipet, dhe në këtë rrugëtim kishte mbështetje nga familja. Ajo u bë frymëzim për motrat e saj por, edhe për vajzat dhe gratë e tjera të asaj gjenerate.

“Frymëzimi im gjithmonë ka qenë Safetja, se kur ajo ka shku për aktore, e kanë sulmu babën, akrobatë, rrethi...Edhe baba ju thoshte, kadalni more... se çika jeme është”.

Motrën e saj Safeten, Igballja vazhdoi ta ketë frymëzim dhe mbështetje gjatë gjithë jetës. Andaj, jetën e saj nuk mund ta tregojmë pa praninë e Safetes.

Që kur ishte e vogël, Igballja kishte dëshirë të mësonte gjuhë të reja dhe të udhëtonte nëpër botë. Pas përfundimit të shkollës së lartë, ajo shfaqti interesim të punësohej në Radio Televizionin e Prishtinës (RTP) në departamentin e filmit – kinematografisë. Aplikoi dhe e fitoi punën.

Punoi në RTP deri në mbyllje të dhunshme nga forcat serbe, madje ende e ka kartelën e punës të cilën e ruan me dashuri të veçantë. Ishte kjo kohë e bukur, deri sa forcat e dhunshme serbe nuk filluan të shtrijnë kthetrat e tyre në Kosovë duke e vështirësuar shumë gjendjen ekonomike në vend. Në këtë kohë filluan edhe hapat e parë të aktivizimit të Igballes. Së bashku me Safeten, filluan t’i ndihmonin familjet në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë. Mblidhnin ushqime dhe gjësende dhe i dërgonin nëpër familje me kushte më të vështira ekonomike.

“Krejt Kosova ka thon’ duhemi me bo dishka për vendin. Na fillum me Kodrën e Trimave se atëherë njëfaj si lagja më e varfur. Edhe na shkum aty me ndihmu, e kemi nis me qese, kemi vazhdu me valixhe, kemi përfundu me kamion, se njerëzit jepshin”.

Sasia e ushqimeve sa shkonte e rritej, e motrat Rogova e kishin të vështirë t’i sistemonin ato. Kërkuan nga gratë e kësaj lagjeje që t’u bënin një listë të familjeve të cilat kishin nevojë për ushqime, për fat u habiten nga përgjigjja e tyre. Vullneti i tyre ekzistonte për të ndihmuar, por, gratë nuk dinin shkrim dhe lexim, duhej që krahas ushqimit të mendohej edhe ky aspekt.

“Nuk dim me shkru e me lexu...jom met për muri...midis Prishtinës...edhe i thash Safetes duhemi me bo dishka për këto gra, hajde po i mësojm shkrim lexim, bile qëto gra”.

Shumë shpejtë u organizuan, dhe filluan t’u mbanin kurse grave në Kodrën e Trimave. Ishin vitet e fundit të 80-tave. Revista “Kosovarja”, atëherë gazetarja Sanije Gashi, nxori artikullin për kursin e parë për gratë kundër analfabetizmit. Kjo u bë e madhe në publikun kosovar. Filluan të merrnin ftesa nga të gjitha anët e Kosovës për të hapur kurse të tilla. Kjo situatë bëri që Igballja, Safetja dhe bashkëshorti i saj, Nuredin Loxha, të themelonin një organizatë të cilën donin ta quanin “Nënë Tereza”, idhulli i motrave Rogova. Mirëpo, qe hapur edhe një organizatë tjetër me të njëjtin emër e cila veprroi në sistemin paralel të atëhershëm.

“Në atë kohë, unë kam qenë shumë e lidhur me “Bashkësinë Protestante” këtu në Prishtinë, ku një Xhon (John) ka qenë njëri që predikonte dhe e solli një artikull ku shkruante që Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi kishin hapur shkollën e parë të vashave në Korçë, Shqipëri. Dhe na e kemi marr emrin që mi kthy historinë. E botum librin Motrat Qiriazi, të shkruar nga djali i Sevastisë. Edhe sot jemi krenare që e kemi kthy emrin e tyre dhe sot ka edhe shkolla dhe rrugë me emrin e tyre”.

Kështu nisën themelet e organizatës “Motrat Qiriazi” në Kosovë në vitin 1989, me mision të vetëm që t’i mësojnë shkrim dhe lexim gratë në Kodrën e Trimave. Jeta na dërgon në drejtime të ndryshme, shpesh të paplanifikuara. Igballes në këtë kohë iu desh të ikte në Shqipëri sepse forcat serbe kishin hyrë me dhunë në RTP, ndërsa punën në organizatë e vazhdoi Safetja me shumë akademikë dhe intelektualë të tjerë.

Në vitin 1992, Nuredin Loxha, përderisa ishte duke mbajtur ligjërata në teatër, para 400 njerëzve, vdiq në skenë me laps në dorë. Ishte ngjarje e rëndë për familjen, dhe meqë mbështetja e njëra tjetrës ishte bërë normë mes motrave Rogova, Igballja u kthye në Kosovë shumë shpejtë. Kësaj radhe filloi punën me organizatën Oxford Committee for Famine Relief (OXFAM), në shqip, Komiteti i Oksfordit për Ndihmën nga Uria.

Punën e vazhdoi në fshatin e Hasit në periferi të Rrafshit të Dukagjinit, por e donte motrën afër. Lidhje e fuqishme mes motrave Rogova.

“Fola me Safeten, thash po veprojmë në Has, se aty i fejojshin çikat në djep. Hajde po shkojmë me funksionin për arsimimin e vajzave. Mezi që e kom bind, se ishte ajo në depresion të madh. I thash që unë nuk muj vetëm, më duhesh. Kuku çfarë jete masnej, kemi një përvojë shumë, shumë, të bukur në Has... burrat masnej, çfarë përkrabhje”, tregon Igballja për përvojën e saj të papërsëritshme në Has.



Organizata “Motrat Qiriazit” fillimisht kishte nisur veprimtarinë me kurse për zhdukjen e analfabetizmit, pastaj në Has u ndërroi misioni, qëllimi i tyre u bë arsimimi për vajza dhe ndërtimi i lidereve të reja.

“Shkoni te njerëzit. Jetoni me ta. Duajni ata. Mësoni nga ta. Filloni me atë që ata dinë. Punoni me ta. Ndërtoni me atë që ata kanë... Por, me liderët më të mirë, kur puna të jetë kryer, detyra e përmbushur, njerëzit do të thonë ‘Ne e kemi bërë këtë vetë’”, kuotë filozofike kineze nga Lao Tzu të cilën motrat Rogova e përdornin si pasaportë që ata u jepnin aktivisteve të reja.

“Na e kemi pas gjithmonë qëllimin, edhe vazhdoj sot me pas, me ndërtu lidere. Në Has pat lëvizje të mëdha se aty pat lidere të mëdha... Marta Prekpalaj, Dilja, lidere të mëdha, lidere të forta”. Në vitin 1998, për shkak të zhvendosjes së popullatës, Hasi ishte bërë rajon që mbikëqyrej fort nga policia serbe, për shkak të kufirit me Shqipërinë që ishte afër. Kjo situatë ia vështirësoi Igballes shkuarjen atje.

Pas mbarimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, ndërtimi i shoqërisë civile

u shfaq si një prioritet thelbësor për stabilizimin dhe zhvillimin e vendit. Krijimi i një ambienti të ri dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët kishte si parakusht forcimin e strukturave shoqërore dhe promovimin e aktivizmit qytetar. U krijuan shumë organizata të reja të cilat patën rol kyç në mbështetje të reformave demokratike, në promovimin e të drejtave të njeriut dhe në ofrimin e ndihmës për grupet më të prekura nga konflikti.

“Mas luftës jena kon disa organizata, dhe përnjëherë mrena javës u bon 200. Edhe tham që duhemi me bo dishka edhe nisëm takimet”, na sqaron Igoja me një theks të bukur Rugove.

Kështu, në vitin 2000 u themelua Rrjeti i Grave të Kosovës si një rrjet joformal që bashkonte grupe dhe organizata të grave nga rajone të ndryshme të Kosovës. Ishte vazhdimësi e një rrjeti të grave (Rrjeti Rural) që kishte filluar katër vite përpara. Që nga fillimi, RrGK-ja ka evoluar në një platformë të fuqishme që avokon për të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Igballe Rogova është drejtore ekzekutive.

“Për mu është kënaqësi që përmes rrjetit kemi tregu, se jemi lidh masnej me rajonin dhe botën, dhe i kemi tregu botës se këtu ka shumë gra të afta, me të vërtetë ka, këtë e them shumë krenari, që Kosova ka shumë gra të forta në shoqëri civile, në politikë”.

Kontributi i Igballes për fuqizimin e grave shkon edhe përtej kufijve. Qe dy herë radhazi ftohet për të qenë anëtare e Panelit Këshillues të Shoqërisë Civile të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO-s) për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Së bashku me koleget e saj, nëpër botë e kishin shtyrë përpara në agjendë Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe themelimin e zyrës së Raportuesit Special të Rezolutës 1325. Kjo rezolutë, e miratuar në vitin 2000, është një dokument që thekson rëndësinë e përfshirjes së grave dhe vajzave në proceset e ruajtjes dhe ndërtimit të paqes, si dhe në trajtimin e pasojave të konflikteve të armatosura.

“Me punën tonë ka ndryshu NATO-ja, tash kur të shkon nëpër misione nuk i shohin gratë vetëm si viktime. Sot, në këtë panel, shqyrtojmë dokumente të

ndryshme të NATO-së që me pas barazi gjinore, sidomos kur kanë plane ose dojnë bo naj vizitë, e me u siguru që kanë kontakte me organizata të grave në ato vende”.

Përveç aktivizimit të saj për të drejtat dhe fuqizimin e grave, Igballja njihet edhe për thyerjen e tabuve – ishte gruaja e parë në Kosovë për të cilën u raportua se ishte në lidhje dashurie me një grua tjetër. Edhe pse shumë personale, dhe u bë e ditur pa dëshirën e Igballes, ndarja e informatës ishte e papritur dhe ndikoi mjaft keq në disponimin e saj.

“Në vitin 1996, kur unë dhe ish partnerja ime vendosim me bo dasmë jo formale, tre shokë të mi që kanë punu në “Koha Javore”, në atë kohë magazinë, e bon një far triku me mu, më than urime, edhe më pyetën a mujm me botu lajmin. U thash jo, se kjo është private. Ata e kishin botu. Edhe na shkum në honeymoon (maujin e mjaltit) në

Budva, dhe mandej kur jom kthy krejt më kqyrshin ndryshe. Krejt e kanë ditë po më thojshin pse e qite publike?”.

Igballe Rogova po që ishte person i vendosur dhe mban këtë karakteristikë, por, ajo kishte mbështetjen e familjes në vazhdimësi, si në ditë të mira si në ditë të vështira.

“Krejt ky aktivizëm i ka rrënjët te familja, qashtu më kan mësu, edhe natyrisht familja është arsyeja pse unë kom qëndru këtu, sepse më kan përkrah, me qëndru këtu. Kurrë se harroj, kur erdha nga muaji i mjaltës, nuk dilsha jashtë. E urrejsha qat treshen e revistës “Kohës”. Dy javë ditë u mshela në banesë”.

Igballja edhe ishte fytyrë publike, e kjo e bënte situatën edhe më të rëndë. Por, si çdo herë, motra e saj Safetja, e mori situatën në duart e saj dhe ia rikujtoi Igballes se kurrë nuk duhet ta mohonte veten.

“Ka qenë motra dhe Ilirjana, vajza e saj, që më than qu vishu dhe po shkojmë. Nëse ti mshefesh, e mohon kush je, ata kanë fitu. Nëse ti vazhdon me qenë kush je, edhe nuk e mohon kush je, ti ki me fitu”.

Pati batica e zbatia në jetën e saj. Nuk është e lehtë të thyhen stereotipet dhe tabutë. Kishte edhe kërcënime me jetë, por kur nuk e lëshoi asnjëherë

Kosovën. Nuk ndalej te frika, por e kalonte. Është e lumtur me punën e saj, nuk ndalej para asgjëje, as atëherë kur ishte kërcënuar me jetë. Krejt ky aktivizëm dhe punë e vazhdueshme e Igballës u kurorëzua këtë vit, kur së bashku me partneren e saj Nikole, e festuan 20-vjetorin e dashurisë dhe bashkëjetesës së tyre mu në Prishtinë në praninë e familjarëve dhe miqve të tyre. Ishte festë e qetë pa raportime në media, pa skandale—por me plot dashuri.

Por, a mendon Igballja se ishte me “igball”? *“Shumë, shumë...për zotin. Sor e kësaj dite u thom kolegeve e krejtve... valla shumë me fat jom”.*

Fatin në krahë dhe me besim, por punën nuk e ndaloi, me vepra të mëdha, si zhdukja e analfabetizmit, ashtu edhe me iniciativa më të vogla, si rikthimi i emrave të grave që kanë kontribuar në histori. Motrat Rogova, një model i motrave Qiriazia.

[...] i kemi tregu botës se këtu ka shumë gra të afta, me të vërtetë ka, këtë e them shumë krenari, që Kosova ka shumë gra të forta në shoqëri civile, në politikë.



Gruaja që nuk hoqi dorë nga e drejta për dije

Shumë tituj mund ta prezantojnë këtë personazh, një pioniere, udhëheqëse, aktiviste, pedagoge e sociologe janë vetëm disa prej tyre. Mihane Nartilë Salihu Bala zgjedhë të deklarohet fillimisht si grua dhe nënë, përtej bagazhit të gjerë të përvojës së saj profesionale e personale.

E lindur në prill të vitit 1973, rritur dhe formuar në Prishtinë, ajo kujton fëmijërinë e rininë e saj në lagjen “Kodra e Trimave”. Rugët e dyert e shtëpive të asaj zone jetojnë si imazhe të qarta edhe sot. Ato janë simbolet e jetës së asaj kohe. Fëmijërinë e saj e përshkruan si një fëmijëri të “shekullit të kaluar” por të mbushur me dashuri dhe ëndrra.

Mihanja thekson se formimi i saj dallohet nga pesha e luftës për ekzistencë. Luftë kjo që gdhendi atë së bashku me moshatarët e saj dhe që u rritën në një kohë që asgjë nuk ishte e premtuar. Kjo mpreheje përbëhej nga rebelizmi, situata politike e kohës, ndikimi i rrethit dhe figurave shoqërore që bënë shtytje në të rinjtë e atyre viteve. Të rinjtë tek të cilët dallimet shoqërore e klasore ishin të pakta, askush s’ishte e nuk shihte më larg se lagja e qyteti ku jetonin.

Ky imazh jetoi tek Mihanja deri në kalimin në shkollën e mesme. Aty ajo u gjend para paragjyqimeve të para për lagjen dhe standardin e jetesës. Megjithatë, këto paragjyqime nuk i ndikuan në rëndësinë që ajo i jepte shtëpisë së saj, e cila drejtohej nga një baba dhe një nënë për të cilët shkollimi ishte prioriteti kryesor. Edhe pse kushtet e tyre ekonomike ishin të vështira, përpjekjet e tyre për të siguruar arsimimin e saj ishin të pareshtura.

Mihanja thekson se studentët e viteve 90’ ishin luftëtarë të një lufte për ekzistencë dhe mbijetesë morale, intelektuale e fizike, gjë që i dallon nga studentët e vendeve tjera. Sigurisht i dallon dukshëm edhe nga studentët e kohës së sotme, të cilët uron të mos e përrjetojnë asnjëherë ngarkesën e politikës ditore që e shoqëroi atë. Ngarkesë kjo që vepronte kundër shtytjes së vullnetit dhe ëndrrave, e përtej qëndresës shkaktoi një humbje

të madhe të ambicieve të tyre. Për ta, drita e vetme në këtë errësirë ishte universiteti – një pishtar që ndizej nga ajo energji e mbetur nga beteja e përditshme e mbijetesës fizike.

Mirëpo për Mihanën 20 vjeçare, vijimi i universitetit ishte një derë e mbyllur nga regjimi i padrejtë i kohës dhe nga rreziku i të qenit student shqiptar. Ndonëse ajo kishte regjistruar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), studimet iu desh t’i ndërprente për shkak të situatës së destabilizuar politike dhe ekonomike në Kosovë.

Mihanja kujton se trimëria e saj dhe e moshatarëve buronte natyrshëm, dhe pavarësisht rrethanave, ata gjenin kohë për të vazhduar jetën. Jetonin përmes mbledhjeve modeste, debateve, bisedave të qeshura dhe intelektuale, dashurive dhe sfidave të përditshme. Përkundër presioneve shoqërore dhe politike për t’u ndalur, ata vazhdonin përpara. Në kujtimet e saj, dëshira dhe vullneti për të bërë diçka të drejtë ishin themeli i përpjekjeve të tyre, pavarësisht kushteve të vështira për të studiuar.

“Kur liria është e garantuar, kur ti e di që ajo është aty për ty dhe e di që nuk ta merr askush, nuk ke nevojë me luftu për të”, ky është dallimi që Mihanja veçon nga jeta e kohës së sotme.

Për të, e vetmja liri ishte ajo e shpirtit dhe mendjes, me të cilat nuk mund të shpalohe potencialin e saj pasi mbijetesë ofrohej prej aftësive fizike përkundër kapacitetit intelektual. Kjo mbijetesë nuk mbetet për tu gjykuar sot pasi ishte e vetmja që kishte dhe Mihanja thekson se *“ne jemi rezultat i gabimeve tona, jo i sukseseve”*. Sipas saj, ata nuk mbetën robër të momentit dhe përkundër sfidave vazhdonin të ecnin përpara. E në këtë rrugëtim, rol kyç kishte familja, sepse çdo nanë e babë shtynte me zor përpjekjet e fëmijëve të tyre. Mihanja thekson se njohja e kontributit të këtyre prindërve është e pakët, por, është pikërisht shtytja e tyre ajo që i udhëheqte para. Ajo e kujton qartë bisedën me nënën e saj kur ajo i thoshte t’i mbaronte studimet ose të martohej, kur e dyta mundësi as nuk ishte në plan. Ishte pikërisht

ky ultimatim që e shtyu Mihanën të merrte dokumentet e të vazhdonte pa pasur ide se ku ishte nisur.

Në mars të vitit 1994, ajo u nis në tatëpjetën e Dubrovnikut në Prishtinë, apo siç e quante rrugën e “San Franciskos”, në drejtim të Fakultetit Filozofik. Në kërkesën e saj për bartje nga Fakulteti i Elektros-FIEK, asaj i pranohen vetëm dy provime dhe përpjekjet e saj të deritanishme zbehen, duke e detyruar të fillojë nga zero. Përkundër kësaj sfide, Mihanja me dhimbje rrëfen se goditja më e madhe si studente ishte rikthimi në shtëpitë-shkolla. Për Mihanën, studimet nuk mbështeteshin në libra akademikë ose platforma të pasura me burime, por në skripta të thjeshta, të cilat kalonin dorë më dorë dhe përmbanin pak nga çdo student.

Në vitet ‘90, kur autoritetet serbe ndaluan mësimin në gjuhën shqipe, shkollat u improvizuan në shtëpi private. Ajo kujton me qartësi dhomën e improvizuar të klasës. Aty profesori qëndronte në një karrige të thyer, dhe blloqet e kuqe që shërbenin si dërrasa e zezë për të shkruar. Në ato kushte të vështira, ajo vijoi vitin e tretë të studimeve. Mihanja mbanë mend një rast kur pas provimit me gojë profesori ishte deklaruar që ajo ka marrë notën 6, dhe ajo pa u munduar të kontrollonte indeksin është kthyer pa e ditur që nota e vërtetë ishte 9. *“Për mua ishte sfidë të fillojë studimet, të mbijetojë, të bëj diçka për veten”,* thotë ajo, dhe lumturia e saj nuk përshkruhej nga nota në indeks apo komenti i profesorit, por nga krenaria për vijimin e provimit.

Në vitin pasues të 1995-ës, ajo kyçet në Unionin e Pavarur të Studentëve, përmes së cilit u bë pjesë e lëvizjeve. Mirëpo këto nuk ishin fillimet e aktivizmit të saj, pasi fillet e para i hodhi gjatë punës si aktiviste e lagjes në vitet ‘88-‘89, kontributit në Shoqatën “Nënë Tereza” dhe organizimit të forumeve të partive politike dhe grupeve shoqërore. Gjatë kësaj periudhe ajo tregon se si gjithmonë ka gjetur dyer të hapura përkundër frikës dhe se asnjëherë njerëzit nuk hezitonin t’i ndihmonin të tjerët. E gjithë kjo ndihmesë dhe punë për të

“

Ne jemi rezultat i gabimeve tona, jo i sukseseve.



mirën kolektive është bërë në baza vullnetare, sepse për Mihanen dhe familjen e saj ishte e papranueshme të mos bëhej kjo. Për këtë, ajo vlerëson se ishte kjo mendësi që e bën një person vetkritik dhe e shtyn të punojë përpara.

“Unë është dashitë që të fitojë gjithçka që kam në jetë, nga zero, dhe asgjë nuk më është dhënë e gatshme, e s’ka qenë as mendimi i familjes time që duhet të më jepet diçka e tillë sepse duhet të bëhesh e zonja e vetes”.

Gjatë angazhimit të saj si aktiviste, Mihanja dhe moshatarët e saj përballuan shumë sfida. Megjithatë, ajo që i bëri të suksesshme iniciativat e tyre ishte bashkëpunimi dhe solidariteti. Nuk ishte e rëndësishme kush ishte individ apo nga vinte, por se ata ndihmonin dhe mbështesnin njëri-tjetrin për t’i arritur qëllimet e përbashkëta. Mihanja veçon Lëvizjen e Studentëve, ku së bashku me studentët e tjerë, prej të cilëve më tepër se gjysma ishin vajza, vepruan për të drejtën e tyre për shkollim.

Për Mihanen, të qenit e vetmja vajzë në kryesi të Unionit të Pavurur të Studentëve të Univeristetit të Prishtinës (UPSUP), pa asnjë prapavijë politike e pa kurrfarë ekspozimi ishte krejtësisht normale. Për të, mjaftonte besimi se kishin të drejtë për shkollim të lirë. Mihanja ende çuditet nga format e komunikimit që i krijonin mes vete, duke përdorur gjuhën e trupit, shenjat dhe mesazhet e fshehta për të mbajtur lidhjen dhe informacionin të ruajtur. Gjatë gjithë angazhimit të tyre, ajo kujton se prapa tyre ishin prindërit, ata të cilët lëshonin fëmijët e tyre pa e ditur nëse do t’i shihnin përsëri. Përkundër kësaj pasigurie, ajo rrëfen se asnjë nënë nuk i ndalonte fëmijët e saj dhe ndrydhte dhimbjen për t’u pajtuar me fatin. Këtë lloj solidariteti, Mihanja e konsideron si një forcë të madhe shpirtërore, ku nuk ekzistonte egoizmi.

Përvoja e Mihanës gjatë udhëheqjes së Unionit të Studentëve, thekson rëndësinë e përpjekjeve individuale dhe kolektive për ruajtjen e arsimit dhe zhvillimit në periudha krize. Mihanja, duke e kaluar këtë periudhë me sakrificë dhe përkushtim, tregon se si përpjekjet e individëve, veçanërisht të grave, janë thelbësore për ruajtjen e shpresës dhe stabilitetit në shoqëri.

Përkundër ngarkesës emocionale të këtyre kujtimeve, Mihanja rrëfen qartë disa momente gjatë angazhimit të saj: *“Më kujtohet kur punoja si përkthyes vullnetare në fund të vitit 1998, dhe rastisim të shkojmë në Kishnarekë; atë moment filluan bombardimet. Ishim shumë njerëz dhe përsëritëm me njëri tjetrin në mes të një qetësie disa minutësh. Nga aty deri në Prishtinë nuk e mbajë në mend sa herë na ndaloj policia, kur për një moment jam zgjuar nga qentë e tyre. Akoma i kam frikë qentë.”*

Mihanja kujton edhe një përvojë tjetër nga puna e saj si përkthyes për organizatën “CARITAS”, gjatë fillimit të bombardimeve të para.

“Një rast tjetër më ka ndodhur gjatë punës me Caritas-in në Pagarushë, ku një nënë dhe fëmija i saj i sapo lindur ishin në gjendje të rëndë. Më kujtohet që mundësitë për ndihmë ishin të pakta, mirëpo e mbajë në mend që secili shqiptar që punonte aty ofroi vendin e tij për t’i dërguar në spital. Rregullat nuk e lejonin këtë, mirëpo një djalë i ri doli nga vetura dhe ia lëshoi vendin.”

Këto përvoja janë të paharrueshme për Mihanen dhe këto momente ishin vendimtare për ta vazhduar jetën. Përdërisa për të janë akoma të qarta, Mihanja tregon se shpesh harrohen dhimbjet dhe si pasojë gabimet përsëriten. *“Gabimi ynë është se kemi përvetësuar momentet historike si pronë private”* deklaron ajo, duke theksuar



Mihanja në Universitetin e Prishtinës.
Foto e huazuar nga rrjetet sociale.



Foto e huazuar nga rrjetet sociale

se ky përvetësim pengon ndarjen e përvojave kolektive dhe krijon distancë mes brezave që duhet të mësojnë nga e kaluara. Për ta evituar këtë, ruajtja e historisë kolektive duhet bërë përmes punës institucionale dhe se historia nuk duhet shtrembëruar, por duhet shkruar drejt, pa anime pa zmadhime.

E pyetur mbi dominimin e një gjinie në kujtesën historike Mihanja thotë se: *“Titulli i nanës ka qenë titulli më i madh i kësaj shoqërie, mirëpo titulli i nanës ka qenë mbrenda rrethojave të oborrit të shtëpisë”*.

Kjo tregon se, ndonëse roli i grave si nëna është vlerësuar, ky vlerësim është kufizuar brenda sferës private, duke lënë jashtë kontributin e tyre në jetën publike dhe historinë kolektive të shoqërisë. Me fillimin e lëvizjeve shoqërore, gratë vendosen në prapavijë dhe shoqëria jeton në kujtesë momentale ku minimizohet kontributi i këtyre individëve. Mihanja tregon se si shoqëria është e prire të mendojë se historinë e bëjnë burrat, mirëpo veçon se pas secilit luftëtar qëndron një nënë, grua, vajzë. Për t’i ndryshuar këto mendësi, Mihanja rithekson se puna institucionale është esenciale, pasi faktet, materialet dhe kujtesa e njerëzve të gjallë janë akoma këtu.

Mihanja thekson se familja është themeli i shoqërisë dhe ngritja kolektive fillon nga shtëpia. Ajo poashtu tregon se vendimi për t’u bërë nënë ka qenë vetëm i saj dhe për të amësia ishte përbushje. Përkundër komplikimeve gjatë nëntë shtatzënive, ajo sot gëzon dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë.


Prindërimi përfshin disiplinë dhe shumë komunikim me fëmijët. Në familjen e saj, dhuratat më të dëshiruara janë frutat në vend të lodrave, dhe monedhat e vogla të cilat fëmijët e saj i kursejnë për shpenzimet e tyre. Mihanja rrëfen se si fëmijët janë mësuar të kursejnë për dëshirat e tyre, e se i vetmi shpenzim që nuk ka nevojë për arsyetim janë blerjet e librave. *“Biseda e sinqertë me fëmijët është shumë e rëndësishme”* thotë Mihanja dhe çuditet me pyetjet që fëmijët mund t’i parashirojnë. Ajo vlerëson se një prind i cili është i sinqertë me fëmijët u tregon se dashuria e prindit nuk është një kontroll i shtrënguar, por një kujdes ndaj tyre.

“Për të arritur në këtë moment të jetës time ka qenë një rrugëtim i rëndë, dhe unë kam dashur që të mos jem si prindërit e mi. Por në fund të fundit edhe unë do të bëhem si ta” thotë Mihanja, teksa përshkruan se dashuria e prindit për fëmijën është e çuditshme dhe vështirë të krahasohet me arsyen.

Për të ilustruar këtë thënie ajo kujton një anekdotë, *“një fëmijë e humb nënën e tij në treg, dhe kur e pyesin se kush është nëna jote, fëmija thotë se nëna ime është gruaja më e bukur në botë.”* Pa pasur parasysh rrethanat, për fëmijën tënd do të jesh nëna më e mirë në botë, thotë ajo, teksa vlerëson se të qenit nënë është një dhuratë që nuk duhet të keqpërdoret.

“Burrat e mëdhenj bëjnë luftën, burrat e mëdhenj korrin fitoren, por ushtarin e lind nana” thotë ajo. Mihanja ua rikujton vajzave e grave që po lexojnë rrëfimin e saj që *“të mos e tradhtojnë vetën qoftë moralisht, qoftë intelektualisht, qoftë shpirtërisht e qoftë financiarisht. Është i dhimbshëm tregimi që një grua humb lirinë e saj kur është e varur nga partneri”*.

Mihanja, si grua dhe nënë, ka kontribuar në formimin e një brezi të ri të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, duke u bërë një shembull i fuqishëm i forcës dhe rezistencës që gratë mund ta ofrojnë në promovimin e paqes dhe sigurisë. Pjesëmarrja e saj në Lëvizjen e Studentëve për të drejtën për arsim, dhe veçanërisht roli i saj si aktiviste gjatë periudhës së luftës në Kosovë, tregon angazhimin e saj për të krijuar një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë.



Sigurria në duart e Afërditës

“Dita e sotme paraqet një ditë me rëndësi për të ardhmen dhe prosperitetin e Kosovës, sepse paraqet ditën që për herë të parë në historinë e Kosovës kemi një polici të Kosovës, të qytetarëve të Kosovës. Të nderuar studentë, të nderuar policë, ju do të jeni e ardhmja e Kosovës, e ardhmja e sigurisë, e ardhmja e paqes e demokracisë dhe lirisë së plotë të Kosovës.”

Ishin këto fjalët e Hashim Thaçit, në atë kohë kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, gjatë ceremonisë së hapjes për herë të parë, të Shkollës së Policisë, më 6 shtator të vitit 1999.

Në Vushtrri, 176 kandidatë po fillonin trajnimin si gjenerata e parë e pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës. Në mesin e tyre ishte edhe Afërdita Mikullovc. Ajo sot udhëheq Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicë. Afërdita Mikullovc i ka mbi 650 punonjës nën komandën e saj. Një grua, një armatë.

Ky ishte viti kur për herë të parë po bëhej Policia e Kosovës, pra viti kur Kosova u çlirua nga tirania shumëvjeçare serbe. Policia nuk kishte qenë profesion që planifikohej të ndiqej nga rinia kosovare, për arsye se në Kosovë asokohe ky shërbim udhëhiqej nga autoritetet serbe. Njëjtë edhe për Afërditën, ajo po studioje për t'u bërë pedagoge dhe as mendja nuk i kishte shkuar ndonjëherë të bëhej police. Krejt ndodhi në mënyrë spontane.

“Fillimisht, ishte shoqja ime e shkollës, bankës, Florie Hajra (sot kolonele në Policinë e Kosovës) më ka pyetur se a do të aplikojë, meqë ajo planifikonte të aplikonte për vete”, tregon Afërdita për ditën kur mori vendimin që i ndryshoi karrierën përgjithmonë. Shoqja e frymëzoi, por ishte babai i saj që e bindi të aplikonte për të qenë pjesë e Policisë.

“Kam aplikuar ditën e fundit të konkursit të parë dhe jam përzgjedhur për gjeneratën e parë, ku më pas normalisht se është dashur t'i nënshtrohemi testeve dhe të gjitha procedurave të kërkuara. Në fund, pasi që të gjitha janë kaluar me sukses, jam ftuar që të filloj me 6 shtator 1999”.

Lufta kishte shkaktuar dëme të mëdha, kishte ndarë familje, njerëz të humbur, qytetarë të traumatizuar, varfëri, e shumë dhimbje. Erdhën shumë organizata ndërkombëtare dhe sollën qasje dhe metoda të ndryshme të punës. Ishte fazë e vazhdueshme e tranzicionit e shumë ndryshimeve tjera në shoqërinë

“

Ata janë aq te vetëdijshëm dhe mirë kuptueshëm se qëllimi i çdo detyre dhe obligimi shtesë ka të bëjë me sigurinë dhe vendin, dhe asnjëherë të vetme nuk ka ndodhur që të kundërshtohem nga kolegët për asnjë detyre dhe obligim.

”

kosovare. T'i takosh pikërisht gjeneratës së parë të Policisë së Kosovës në një transformim politik, social dhe të sigurisë, ishte sfidë në vete.

“Vështirësitë kanë qenë të njëpasnjëshme dhe shumëdimensionale dhe ndoshta nuk mundemi as t'i përshkruajmë. Por, falë vullnetit të madh për punë, ndjenjës dhe dashurisë ndaj vendit dhe punës, ashtu dhe respektit të madh të qytetarëve ndaj nesh, bashkëpunimit dhe përkrahjes së tyre, të gjitha janë tejkaluar”, tregon Afërdita për vështirësitë fillestare duke qenë çdo herë mirënjohëse dhe falënderuese ndaj qytetarëve.

Gradën e parë Rreshtere, Afërdita e mori fill pas dy vitesh pune në polici. Ishte viti 2001 dhe nuk kishte literaturë të mjaftueshme në gjuhën shqipe në këtë fushë. Gratë edhe kur janë të afta për pozita vendimmarrëse, pyesin nëse janë të zonja, mos është diçka ashtu apo kështu.

“Fillimisht kam hezituar të aplikoj për këtë gradë, mendoja se jam shumë e re dhe se ka kush gradohet. Në fund vendosa të aplikoj, dhe nuk ka qenë fare e lehtë pasi që në atë kohë nuk kemi qenë të orientuar shumë rreth natyrës së testit, përveç se kam vendosur të lexoj shumë material të fushave të ndryshme lidhur me sigurinë”.

Testi i kishte 150 pyetje. Nevojitej koncentrim i lartë dhe qetësi. Afërdita arriti sukses maksimal, duke u renditur e dyta në Kosovë në testin për rreshterë në nivel kombëtar. Paso i provimi me gojë dhe verifikimi nga Standardet Profesionale, ashtu dhe rekomandimi i mbikëqyrësit dhe vlerësimi i kompetencave të kandidatit për atë pozitë. Ishin një mori faktorësh dhe procesesh, të gjitha stresuese dhe të vështira, pavarësisht përgatitjeve dhe vullnetit. Gradimi në pozitën si rreshtere solli krenari dhe gëzim në familjen dhe rrethin e ngushtë, por jo edhe tek të gjithë kolegët e saj.

“Në momentin që e kam kaluar testin me shkrim për rreshter, kanë filluar sulmet anësore apo edhe të drejtpërdrejta nga kolegët meshkuj, jo momenti vartës të drejtpërdrejt”, tregon Afërdita për këtë fazë. Më tutje ajo tregon se kjo gjendje reflektonte shumë situata jo aq të volitshme dhe mjaft problematike për të sepse, “përveç përgjegjësisë së drejtpërdrejt në terren, menaxhim të ekipit, dhe duke qenë të graduarit e parë në rajon, nuk ishte aq e lehtë që kjo të pranohej nga disa kolegë të cilët në fakt unë i respektoja dhe të njëjtit kishin respekt dhe autoritet në komunitet, por që nuk kishin pasur fatin që të gradohen për shumë arsye”.

Si rreshtere e re, Afërdita u caktua shefe e ndërrimit në Stacionin Policor në Vushtrri. Ishte 25 vjeçare. Ballafaqimi me vështirësi në baza ditore e bënte atë më të fortë. Ajo reflektonte një karakter luftarak dhe të drejtë dhe madje këto situata e bënë të mos dorëzohej dhe të punonte edhe më shumë.

“Grada e rreshterit me caktim në detyra operacionale, është grada e cila të zhvillon më së tepërmi, dhe varësisht prej qasjes, rezultatit, suksesit apo dështimeve, do të identifikohesh pothuajse gjatë tërë karrierës. Këtë kësbillë ia përcjellë të gjithë mbikëqyrësve të vijës së parë pasi që kjo gradë është baza zhvillimit profesional dhe rrugëtimit në të ardhmen”.

Duke punuar me një zell dhe përkushtim të pasohq, Afërdita vazhdoi të avancohej në karrierë por, në të njëjtën kohë përfundoi studimet themelore në Fakultetin Juridik, dhe pastaj edhe ato master në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë. Një dëshmi tjetër se si gratë ia dalin.

Nuk ndaloi së punuari asnjëherë. Në vitin 2007 kaloi nga Akademia Policore në Vushtrri, në vendin e saj të lindjes. Atje mori pozitën më të vështirë në karrierën e saj, si shefe e Operatives Rajonale në Mitrovicë. Kishte shtatë stacione policore në mbikëqyrje, jug dhe veri, njësinë speciale, dhe njësi tjera rajonale, dhe kishte rreth 1200 vartës. Në vitin 2009 u emërua si zëvendës drejtoreshë rajonale për hetime. Pozitën më të lartë në karrierën e saj e mori në vitin 2018 kur u bë Drejtoreshë Rajonale e Policisë në Mitrovicë të Jugut, ndërsa gradën më të lartë në polici e fitoi në vitin 2019, kur Afërdita u bë kolonele. Pas dy dekadash përkushtim dhe punë.

“Është një ndjenjë e veçantë, posaçërisht kur e din se me sa meritë, me sa mund, me sa suksese, me sa përkushtim e ke marr këtë gradë, dhe pikërisht këtu qëndron kënaqësia e gradës kur të gjithë janë të vetëdijshëm me sa meritë e ke marr këtë titull dhe sa respekt ngërthen në vete merita e kësaj grade”.

Natyrisht, Afërdita tregon se kjo gradë ngërthen shumë përgjegjësi në vete që ndërlidhet edhe me pozitën të cilën e mban aktualisht në krye të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicë.

Në polici asgjë nuk është rutinë. Ditët janë të ndryshme, nga më të zakonshmet deri tek ato më të vështira që lënë gjurmë të thella në zemrën e Afërditës.

“Gjëja më e dhimbshme gjatë karrierës sime, tani më së fundmi është humbja e kolegut tonë, rreshterit Afrim Bunjaku, të cilin edhe e kam pasur vartës për shumë vite, dhe kumtimi i lajmit në familjen e heroit Afrimit për humbjen e tij. Edhe pse nuk kam shkuar personalisht tek familja, përgatitja e stafit për t'i dërguar atje, dhe përgatitja për mënyrën e kumtimit të lajmit të hidhur, është një barrë dhe një ndjenjë e ftohtë dhe mjaft e rëndë”.

Edhe pse të vetëdijshëm se profesioni i policit është i tillë dhe çdo herë janë në rrezik për jetë, prapë se prapë, nuk është aspak e lehtë mënyra për t'ia kumtuar lajmin e dhimbshëm familjes.

Puna në shërbim të vendit sjellë edhe shumë momente të mira dhe krenarie. Për Afërditën, ndër momentet më

të lumtura, por edhe më të vështira gjatë karrierës së saj, ashtu si për Policinë e Kosovës, është vlerësuar kalimi dhe marrja nën kontroll dhe mbikëqyrje e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Veri në Mitrovicë. Transformimi ndodhi në nëntor të vitit 2022, që erdhi pas dorëheqjes së zyrtarëve policorë të komunitetit serb në veri.

“Kemi marrë dhe ruajtur integritetin territorial të katër komunave veriore. Kjo është realizuar me një strategji konkrete por edhe gjithëpërfshirëse, të kujdesshme dhe dinjitetshme dhe me një qasje tejet të matur. Me veprimet operativo-taktike kemi arritur të parandalojmë zhvendosjen (braktisjen e pronave) nga disa banorë shqiptarë të cilët banojnë në pjesën veriore. Krejt kjo fazë sfiduese kishte kaluar pa asnjë incident apo ankesë të vetme”.

Pas rreth çerek shekulli në ofrimin e sigurisë, Afërdita vazhdon të punojë pa shkaktuar asnjë skandal dhe duke bërë numër të pafund kalkulimesh në trurin e saj që ta zbatojë ligjin në mënyrën më të mirë, të jetë pranë komunitetit me shumë projekte dhe të udhëheqë me shumë objektivitet mbi 600 vartës dhe 200.000 banorë të rajonit të Mitrovicës, rajon ky me probleme të mëdha ekonomike, sociale e politike. Secila shtresë e popullatës është më e ndjeshme se tjetra.

Falë punës së saj të palodhshme, sot, Afërdita gëzon respekt, si në punë ashtu edhe në komunitet.

“Asgjë nuk është gratis dhe falë në këtë botë, e në këtë rast as respekti. Kështu që falë punës, angazhimit të vazhdueshëm, përkushtimit maksimal, seriozitetit në punë, vullnetit tejet të lartë, vetëbesimit, guximit, etikës dhe integritetit tim personal dhe profesional unë gëzoj respekt të madh nga vartësit dhe eprorët e mi”.

Pozitën e drejtoreshës rajonale në rajonin më sensitiv dhe kompleks në Kosovë, Afërdita e mban tashmë gjashtë vite. Për disa vite me radhë (2018, 2019, 2020), rajoni është shpallur si ai me besueshmërinë më të lartë të qytetarëve ndaj punës, etikës dhe integritetit të tij, si dhe me performancën më të lartë policore nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe, në vitin 2021, nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).

“Me këtë fakt dëshmohet se sa e pranuar kam qenë dhe jam nga të gjithë, por, më duhet të jem e sigurtë, ndonjëherë më tepër të pranon vet shoqëria, qytetarët dhe komuniteti se ndoshta vet institucionet. Konsideroj se në heshtje në botën mashkullore (jo tek të gjithë) ekziston një ego që nuk e pranon se një grua është shumë e zonja të udhëheq me institucione dhe pozita të larta vendimmarrëse. Kjo nuk ka t'bëjë me mua personalisht, por është një gjë që nuhatet disi në përgjithësi, por për mua vlerësimi më real dhe më i çmuar është ai i qytetarit, për shkak se qytetari di, sheh, dhe dëgjon shumë, pra është një barometër matës shumë objektiv, transparent dhe i paanshëm”.

Në anën tjetër, Afërdita u është shumë mirënjohëse atyre kolegëve që e kanë përkrahur që në fillim dhe tani. Ata mirëkuptojnë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që ajo u cakton, madje edhe atëherë kur këto përgjegjësi janë jashtë domenit të tyre.

“Ata janë aq të vetëdijshëm dhe mirëkuptueshëm se qëllimi i çdo detyre dhe obligimi shtesë ka të bëjë me sigurinë dhe vendin, dhe asnjëherë të vetme nuk ka ndodhur që të kundërshtohem nga koleget për asnjë detyrë dhe obligim”.

Përkundër kësaj, tentojnë që të bëjnë edhe më shumë punë dhe me rezultate edhe më të mëdha sesa që unë kërkoj, dhe jam shumë mirënjohëse ndaj tyre”.

Përveç punës në polici, Afërdita kishte punuar edhe në themelimin e Shoqatës së Grave Police në Kosovë në vitin 2013, dhe që nga ajo kohë është anëtare e bordit drejtues.

“Para se të themelohej kjo shoqatë, rrugëtimi ka qenë tejet me përkushtim dhe me një intensitet të shtuar pune me organizata ndërkombëtare, në këtë rast me “UN Women” [Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave]. Iniciativa dhe kontaktet e para janë bërë nga ish-Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, sa ka qenë në strukturat udhëheqëse të Policisë së Kosovës, ndërsa këtë rrugëtim e kemi vazhduar edhe me koleget tjera”.

Shoqata ka për qëllim të mbështesë dhe të avancojë statusin e grave në strukturat e policisë përmes ofrimit të mbështetjes emocionale dhe

profesionale, organizimit të trajnimeve, seminareve, dhe përfaqësimit të interesave të tyre përpara strukturave të menaxhimit. Poashtu, synon të promovojë barazinë dhe diversitetin në punë, duke kontribuar në krijimin e një ambienti më të barabartë dhe mbështetës për gratë në polici. *“Ky rol është dëshmuar edhe në vendin tonë, ku shumë gra në policinë e Kosovës, dhe institucionet/agjencitë tjera të sigurisë kanë dëshmuar rolin dhe pozitën e tyre duke prezantuar suksese të ndryshme”.*

Nisur nga përvoja personale shumëvjeçare në një ambient të llojllojshëm dhe punës nën presion, Afërdita mendon se gratë kanë një ndikim të fuqishëm në parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes dhe ruajtjen e sigurisë, duke sjellë një perspektivë unike dhe të vlefshme. *“Falë intuitës së zhvilluar dhe aftësisë për të identifikuar shenjat e hershme të tensioneve, gratë krijojnë plane konkrete dhe të analizuara mirë që sjellin rezultate pozitive dhe ndihmojnë në ndërtimin e*

marrëdhënieve të forta në komunitetet e tyre”.

Gjatë gjithë jetës, Afërdita është udhëhequr nga motoja e saj personale “Vullnet dhe Guxim” që është sinonim i suksesit dhe arritjeve. Andaj edhe mesazhi i saj për gratë dhe vajzat e reja është që fillimisht ta duan vendin dhe punën sepse kur njeriu e do vendin e vet, nuk ka dyshim se do të ketë përkushtim dhe rezultate, e pastaj duhet të kenë vullnet dhe guxim.

Gjithmonë e buzëqeshur, Afërdita Mikullovcit është vet sinonim i vullnetit dhe guximit, suksesit dhe arritjeve. Me plane konkrete dhe të analizuara mirë, ajo arriti që të sjellë rezultate pozitive dhe të ndërtojë marrëdhënie të forta në komunitetin e saj. Është gruaja e parë dhe e vetme në Kosovë që udhëheq me sukses një Drejtori Rajonale të Policisë së Kosovës, dhe atë në vendin me më së shumti probleme dhe popullsinë më të shumëllojshme në Kosovë. Ta heqim kapelën, Afërdita!



*Diplomimi pas përfundimit të trajnimit bazik –
Gjenerata e parë - Viti 1999 - Realizuar nga : OSBE*



Ndërtimi i paqes përmes edukimit

“Feministët shprehin mendimin se filozofia e të qenit grua është krijuar nga burrat...të jesh grua do të thotë të jesh subjekt i disa pikëpamjeve dhe të kesh një rol të veçantë. Grua nuk lind, grua bëhesh është thënia e famshme e Simone de Beauvoir sepse femra është grua në masën që ajo ndjehet si e tillë”, - kështu nis eseja “Feminizmi si përballje e botës krijuese” shkruar nga Sala Ahmetaj, botuar në vitin 2010 në revistën Shkrepetima.

Znj. Sala citon ekzistencialisten franceze de Beauvoir sepse krahas leximit dhe ndikimit filozofik, ajo i ka jetësuar mësimet e de Beauvoir mbi dekonstruktimin e normave gjinore gjatë gjithë jetës. Sala Ahmetaj ka mishëruar idenë se të jesh grua është një proces i rrjedhshëm dhe i përcaktuar nga vetë individi, jo nga shoqëria.

Nëse kthehemi shtatë dekada e kusur më parë, në vitin 1950 në Radishevë atëherë kur është lindur Sala, kuptimi i të qenurit grua dallon në mënyrë thelbësore nga viti 2024 kur po shkruhet ky artikull. Në atë periudhë, konstrukti shoqëror ‘grua’ nënkuptonte një rol të caktuar që lidhej kryesisht me detyrat shtëpiake, kujdesin për familjen dhe përmbushjen e pritshmërive tradicionale. Gratë ishin shpesh të kufizuara në hapësirën private dhe rrallë kishin mundësi për të marrë pjesë në jetën publike ose për t’i ndjekur aspiratat personale e profesionale jashtë normave tejet të ngurta shoqërore.

Edukimi dhe puna, përtej qëllimit parësor të krijimit të familjes dhe

martesës, ishin aspirata më pak të menduara për gratë dhe vajzat gjithandej Kosovës. Veçanërisht më të theksuara për gratë dhe vajzat që jetonin në fshatra më të izoluar. Aty ku qasja në shkollim përveç që nuk ishte normë, ishte edhe fizikisht shumë më e vështirë. “Fshati im ka qenë i izoluar, shumë larg fshatrave tjera. I kishim pesë apo gjashtë kilometra deri tek fshati më i afërt, i cili ishte i rrethuar vetëm me male,” e përshkruan Sala fshatin e saj në atë kohë.

Edhe sot, duhet rreth një orë e gjysmë për të arritur në këmbë tek i njëjti fshat. Radisheva ishte përrallore. Natyra rrethonte çdo kënd të horizontit. Një rrafshinë në mes, rrethuar me male e kodra. Në mot të mirë shpërthejnë të gjelbrat, në të ftoftë mbulohet me borë. Sala, së bashku me bashkëmoshatarët e saj, kujdeseshin për kafshët dhe shikonin diellin teksa venitej mbi shpatet e këtyre maleve dhe hënë në teksa ngrihej gjithnjë e më lartë në qiell. Drita e yjeve që ndriçonte qiellin binte edhe mbi shtëpitë pa energji elektrike dhe mbi rrugët e hapura me këmbë mes maleve dhe kodrave të fshatit.

Sado që bukuritë e qetësia e Radishevës ishin unike, mu ashtu siç përshkruhet në libra, fshati nuk i ofronte të gjitha mundësitë për banorët e tij. Mungesa e një shkolle në fshat e detyroi Salën dhe shumë nga bashkëmoshatarët e saj të udhëtonin nga fshati i tyre për në Runikë. “Për të shkolluar në shkollë duhet të udhëtoja shumë gjatë nëpër male deri në Runikë. Ndoshta një orë e gjysmë në këmbë në një drejtim. Ka qenë një rrugë

malore, shumë e vështirë dhe e pjerrët për tu ecur në këmbë nga njerëzit,” rrëfen Sala duke qeshur, e për ta vizualizuar thepisjen, thotë “vetëm dhinë mund të kalonin në atë rrugë”.

Një rrugë e tillë mund të kishte qenë dekurajuese për shumë persona, por jo për Salën e cila kishte një etje të pashtershme për dije dhe dëshirë të thellë për ta parë veten jashtë kornizave që komuniteti i saj kishte paraparë për një grua dhe një vajzë. “Shumë shpesh duke shkuar në shkollë më lageshin këmbët. Mbaj në mend mësuesin tim i cili më ulte afër kofitorit që të më ngroheshin këmbët,” kujton Sala.

Bora dhe shiu ishin sfida natyrore. Mungesa e rrymës elektrike e bënte shkuarjen në shkollë dhe më të vështirë. Megjithatë, nuk venitej dëshira e saj për vazhduar tutje. Natën, pas një dite të gjatë duke u marrë me punët bujqësore të fshatit, ajo gjente mundësi dhe lexonte nën dritën e zbehtë të një llambe vajguri. Kjo rutinë vazhdoi edhe pasi përfundoi shkollën fillore, pasi Sala vazhdoi mësimet si nxënëse në shkollën normale në Mitrovicë. “Për herë të parë kam shkuar në Mitrovicë me babin tim në këmbë për të dhënë provimin pranues. I kemi bërë gjashtë orë për të arritë atje. Pasi u pranova në shkollë, këtë rrugë gjashtë orëshe e kam bërë shumë shpesh,” thotë Sala teksa përshkruan kohën e saj si nxënëse duke shikuar në largësi me nostalgji e mbase edhe admirim për vullnetin e saj të hekurit si e re.

Trajektorja e saj, Radishevë-Runikë-Mitrovicë, të cilën e përshkonte çdo ditë, duke filluar nga ora tre e mëngjesit kur zgjohej për t’u nisur në këmbë deri në Runikë, e më pas ta merrte autobusin nga Runika për në Mitrovicë, sot i duket si një ëndërr.

Një nga shtyllat kryesore në të cilat mbështetej Sala, e që në të njëjtën kohë ia lehtësonte jetën dhe ia mundësonte që të vazhdonte aspiratat për shkollim, ishte babai i saj. Ai vazhdimisht e inkurajonte atë për t’u fuqizuar dhe për t’u bërë e zonja e vetës. Një fat e përkrahje të tillë padyshim që nuk e gëzuan shumë bashkëmoshatare të Salës në atë kohë. Sikur në intervistat e tjera, Sala flet edhe për Radishevën edhe për babain.

“Babi im ka qenë autodidakt. Ka pasur shumë dëshirë të madhe dhe dashuri për shkollën që ka qenë diçka jo e rëndomtë për ato rrethana. Prandaj unë

babait tim i jam mirënjohëse, sepse ai më thoshte: veç mëso ti se unë kam më të çu në shkollë,” ndan ajo me shumë krenari dhe mirënjohje kujtimet për të atin. Të qenit vajzë nga fshati e cila shkollohet në një qytet në vitet e 60-ta, në Kosovë rëndom është pritur me paragjykim nga shoqëria e qytetit. Por, fatmirësisht, Salën e mirëpriti një rreth përfshirës i nxënësve dhe arsimtarëve. Secili prej tyre e admironte vullnetin e Salës për të nxënë dije, e kishin respekt të shtuar për gjithë rrugëtimin fizik dhe metafizik, vetëm për t’i realizuar ëndrrat.

“Unë kam qenë vajzë fshati. Vija nga bjeshka. Por që nga dita e parë, një shoqe nga qyteti ka kërkuar të ulet në bankë me mua. Ka qenë diçka jo e rëndomtë për atë kohë, se ka pas shumë e shumë paragjykim për nxënësi si unë,” rrëfen Sala, teksa përshkon gishtërinjtë përmes flokëve të saj të zeza, të shkurtra, por shumë të dendura.

Këto dallime shoqërore sot janë venitur, por në vitet e Salës ishin më të theksuara. Ajo është ndërjet gjithnjë krenare për origjinën e saj dhe gjatë gjithë jetës ka theksuar prejardhjen kudo. Ajo me shumë mjeshteri dhe maturi gjatë intervistës sonë deklaroi: “Origjina nuk ia siguron askujt suksesin, as madhësinë. Në qoftë se ti nuk je punëtor e nuk ke vlera njerëzore, nuk do arrish askund.”

Me një mentalitet të tillë në kokë, Sala u udhëhoq gjatë gjithë jetës. Puna e zellshme ia mundësoi që në vitin e tretë të shkollës normale të përzgjedhet nga kolektivi i arsimtarëve si nxënësjë më e mirë në shkollë, me ç’rast iu mundësua që një vepër e saj të botohet në një revistë me botimet e nxënësve më të mirë nga e gjithë ish-Jugosllavia. Në fakt, jo vetëm në Kosovë, por vitet e 60-ta dhe 70-ta shënuan revolucion mbarë botëror në emancipimin e grave dhe vajzave si dhe fuqizimin e tyre në hapësirën publike. Edhe pse kjo rrymë nuk përjashtoi as Kosovën dhe gratë e saj, sistemi shtypës si dhe normat e rrënjësura patriarkale u pamundësonin grave dhe vajzave fuqizimin me të njëjtin intensitet si në vendet e tjera.

Sala ishte e pandalshme dhe u shndërrua në një nga avokueset më të zjarra për shkollimin e grave dhe vajzave në Kosovë. Sapo e mbaroi normalen, vendi i punës për të ishte i siguruar si mësuese. Krahas përhapjes së njohurive tek nxënësit, ajo nxinte dije edhe për vete si studente në

Universitetin e Prishtinës në degën e gjuhësisë në Fakultetin Filologjik.

“Mezi kam pritë të punojë si mësuese. Por në të njëjtën kohë kam regjistruar fakultetin me korrespondencë dhe ajo ka qenë një nga ditët e mia më të lumtura. E kisha ëndërr që me punën time, veprimet e sjelljet e mia të ndikoj në rrethin shoqëror ku kam punuar që të arsimohen vajzat. Sepse shkolla nuk i prishë, ashtu si është paragjykuar atëherë”.

Gjithë energjinë e saj Sala e investoi si mësuese në fshatin Runikë, duke punuar me shumë përkushtim, dashuri, e pasion. Në mënyrë që nxënësve të saj t’ua rriste interesimin për arsimim, ajo ishte novatore në mënyrat se si mbante orën mësimore. Ndër të tjera, shfaqjet teatrale, publikimet e nxënësve në revistën ‘Shkrepëtim’, të cilën ajo e kishte krijuar së bashku me dy kolegë, sigurimi i materialeve shtesë për mësim, si dhe konsultimet e vazhdueshme për motivim të nxënësve, ishin rutina e saj si mësuese në Runikë. Më vonë, ajo u bë profesoresha e parë me diplomë fakulteti dhe gjatë asaj kohe punonte në Gjimnazin e Skenderajt (viti 1976-1978). Për punën e saj plot përkushtim u shkrua edhe në revistën “Zëri i Rinisë”, për klasën më të mirë në Kosovë, e cila ishte klasa e saj.

Edhe në këtë krijimtari të sajën kishte nuanca feministe. Nxënësit inkurajoheshin të shkruanin për pozitën e gruas në shoqëri e deri tek mendimet e poetëve të rilindjes shqiptare që mund t’i kishin përguan. Djemtë e vajzat lumturoheshin kur shihnin poezitë e shkrimet e tyre të publikuara në revistë. Për më tepër, edhe dramat të cilat përzgjedheshin për shfaqje teatrale, kishin synim të edukonin nxënësit për rrethin ku jetojnë dhe për ndikimin që veprimet e tyre kanë në shoqëri. “Ne nuk kishim shumë mjete dhe mundësi financiare për t’i realizuar këto projekte. Por punonim me kolegët gjatë gjithë natës për t’i shtypur veprat një nga një me makinë të shtypjes. Ishte një proces i vështirë fizik, por të cilin e bënim me shumë dashuri,” deklaroi ajo duke buzëqeshur.

Pas disa vitesh, Sala u martua dhe u zhvendos në Prishtinë. Asnjëherë nuk e ndërroi mbiemrin, të cilin e mbajti me shumë krenari si pjesë të identitetit të saj. Madje, edhe bashkëshorti e përkrahi kur dëshmoi për respektin që ajo gëzonte falë punës në komunitet. “Burri është mrekullu nga dashuria e respekti që kanë pasur njerëz për

mua. Më ka thënë po më vjen gjynah ti me ndërru mbiemrin”, thotë ajo. Mbiemrin e vajzërisë e mbajti dhe me të edhe u citua e përfundoi studimet e doktoratës. Një arritje e pazakontë për kohën e kulturën në atë kohë.

Të njëjtin motiv dhe dëshirë për të shpërndarë dije, Sala i mirëmbajti edhe gjatë viteve të 90-ta, kur tensionet politike në Kosovë ishin në rritje e sipër. Përderisa personat në arsim persekutoheshin që flisnin në gjuhën shqipe, Sala dhe shumë intelektualë të tjerë ligjëronin pandërprerë në sistemin paralel të shkollimit për shkak se shkollat në gjuhën shqipe gjatë këtyre viteve ishin të mbyllura. *“Asnjëherë nuk jam stepur dhe jam përpjekur në të gjitha mënyrat të jap kontributin tim. Detyra jonë parësore ka qenë të punojmë me ndërgjegje dhe përkushtim.”* rrëfen ajo.

Prandaj, si rezistencë paqësore, sistemi i shtëpive-shkolla u mundësoi qindra mijëra nxënësve shqiptarë të shkollohen. Ishte po aq sfiduese për mësimdhënësit sa ishte për nxënësit. Në kushte të vështira, me burime të limituara financiare dhe materiale, mësimdhënësit mundoheshin të përçonin mesazhin që vetëm përmes edukimit, e ardhmja e Kosovës është më e ndritur. *“Unë asnjëherë nuk e kam humbur orën e mësimin. Ka pas raste kur ka ardhur policia [serbe] e na ka penguar. Kolegët mbledheshin e na thonin erdhën tek ne, tash do të vijmë edhe tek ju. Tregonin çka i kanë pyetur e si janë përgjigjur. E unë ju thoja: ‘hajt mos u brengosni se ndoshta mua më pyesin diçka tjetër,’”* kujton ajo duke qeshur me zë.

Duke qenë nga një familje patriotike, e lindur dhe rritur në fshatin e Shote Galicës, ndjenja për të kontribuar për kombin dhe çlirimin e tij ishte e natyrshme. Përveç angazhimit në arsim, ajo mori pjesë edhe në rezistencën paqësore duke qenë aktiviste në protesta të ndryshme që u organizuan në vitet e ‘90-ta. Në dhomën ku po intervistohet Sala, rrinte varur një fotografi e zmadhuar e një proteste paqësore. Aty shiheshin protestuesit me mbishkrimet ‘Paqe për Kosovën’ në dorë, të cilës ia hidhte sytë në mënyrë spontane kur fliste

për rezistencën dhe për humbjet njerëzore e materiale, sidomos të familjes së saj gjatë asaj periudhe.

Kosovën e pasluftës Sala e shumë të tjerë si ajo e gjetën të rrënuar. Por, ishin të motivuar për ta rindërtuar e për të punuar që ta ndërtonin paqen dhe të siguronin një bashkëjetesë të hareshme e të shëndetshme për të gjithë. Pas luftës, kontributin e saj e dha edhe përmes pozitës së deputetes në legjislaturën e parë dhe të dytë. Për të ishte nder dhe privilegj që gjatë këtyre dy mandateve të punonte direkt në ligjet që prekjin dy tema të rëndësishme për të: gjininë dhe edukimin. Ligji për arsim, ligji për barazi gjinore si dhe ligji mbi kuotën, të gjitha u hartuan në atë periudhë.

Sala Ahmetaj filloi karrierën e saj akademike si asistente në Universitetin e Prishtinës, duke arritur të bëhej profesoresha e parë grua në Fakultetin e Filologjisë, ku filloi punën që nga viti 1977. Me pasion dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, ajo u ngrit në radhët e fakultetit duke u bërë një emër i njohur dhe i respektuar. Sala është nga ato mësimdhënëse që kanë frymëzuar breza të tërë studentësh me dijen e vet të thellë dhe metodologjitë përparimtare të mësimdhënies. Kontributi i Salës dhe grave si ajo duhet dokumentuar në historinë e Kosovës, duke theksuar ndërtimin e paqes përmes arsimit dhe fuqizimit të komuniteteve. Historitë e tyre janë dëshmi e forcës dhe frymëzimit për brezat e ardhshëm në luftën për barazi dhe drejtësi. Po e përfundojmë këtë copëz shkrimi me një paragraf të fuqishëm nga fjala e Salës kur mori çmimin “Dielli Ilir” me rastin e 50 vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës. Le të shërbejë kjo si një përkujtes miqësor për ju, të dashur lexues të ZA-së:

Të reja ve u
them punoni me
idealizëm dhe
me dashuri sepse
idealistët i duhen
çdo epoke, e
edhe të sotmes
sepse ata punojnë
për të mirën e
përgjithshme pa
pritur shpërblim. Ata
dhurojnë dashuri
pa kushte sepse
për ta shkenca dhe
arti bëhen për të
mirën e njerëzimit.
Shkencëtari idealist
është sikur Dielli, ai
ngroh dhe bën dritë
për të tjerët.

Përpijekjet e Albulenës për një drejtësi më të mirë

“A do të mund t’ia dal?” — 4 shkurt 2020, kjo ishte pyetja që Albulena Haxhiu po ia bënte vetes gjatë marrjes përsipër të detyrës si ministre në Ministrinë e Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës.

“Isha shumë e vetëdijshme për sfidat që më presin, për angazhimin që duhet ta jap dhe për ndjeshmërinë që ka pozita që mbajë. Që nga fillimi e kam pasur me rëndësi që secili veprim i imi të jetë i përgjegjshëm dhe të jem në shërbim të zotimeve që kemi dhënë para qytetarëve”.

Albulena luan një rol të rëndësishëm në drejtimin e reformave të nevojshme për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Me një angazhim të theksuar për luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, ajo synon që të sjellë transparencë dhe efikasitet në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Që nga dita e parë e punës, Albulena ishte zotuar që do të angazhohej e të kontribonte për vendin e saj dhe të punonte për të mirën e qytetarëve. Të njëjtën e kishte bërë para shumë dekadash edhe gjyshi i saj, patrioti i çështjes kombëtare, Ahmet Haxhiu, i cili edhe e kishte pagëzuar mbesën e tij me emrin Albulenë.

“Gjyshi im ka qenë i burgosur politik dhe veprimtar i çështjes kombëtare, patriot i madh që edhe përkundër maltretimeve e burgosjeve nuk u ndalë deri në frymën e fundit sikur edhe shumë veprimtarë të tjerë. Sigurisht që emri që mbaj ndërlidhet me triumfin e Gjergj Kastriotit kundër forcave osmane, pasi që beteja e Albulenës, përbënte një nga betejat më të laudishme të zhvilluara nga Skënderbeu.”

E lindur dhe e rritur në Prishtinë, fëmijërinë e pati shumë të lumtur së bashku me dy motrat dhe dy vëllezërit e saj. Rritja në mesin e pesë fëmijëve, kishte krijuar një atmosferë të mbushur me dashuri dhe harmoni. Çdo ditë

za | e nisën nga zero



ishte një aventurë e përbashkët. Të gjithë ndanin së bashku momentet e gëzimit, e vështirësitë e përditshme i kalonin më lehtë së bashku.

Çdo moment i kaluar së bashku ka kontribuar më mirë në ndërtimin e një fëmijërie të pasur me kujtime të çmuara dhe dashuri të pandërprerë. Albulena ishte një fëmijë i qetë dhe shumë e ndjeshme.

“Mendoj që secili individ ka tiparet e veta që e bëjnë ndryshe nga tjerët. Këtë krahasim e gjej edhe tek fëmijët e mi kur bëhet fjalë për mendimet, sjelljet apo

gjendjen emocionale të tyre. Unë kam mësuar shumë nga përvojat, gabimet apo edhe sukseset”.

Por, të bëhej politikane nuk hynte në listën e synimeve që do të dëshironte t’i arrinte kur të rritej. As më vonë kur erdhi koha të zgjedhte profesionin. Kishte dëshirë të bëhej prokurore prandaj dhe i vazhdoi studimet në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Pas përfundimit të studimeve filloi angazhimin si praktikante në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Si juriste e sapodiplomuar, puna në këtë gjykatë e ndihmoi Albulenën që njohuritë e fituara në teori t'i shihte të zbatuara në praktikë. U njoh për së afërmi me sistemin e drejtësisë si dhe funksionimin e organeve të rendit në Kosovë. Edhe pse me një personalitet të qetë, angazhimi i rinisë për të kontribuar në të mirën e vendit, e zgjoi brenda Albulenës shpirtin luftarak dhe filloi të mendonte edhe rreth inkuadrimit të saj në politikë.

“Nga shtatori i vitit 2010 jam angazhuar në Lëvizjen Vetëvendosje. Para kësaj kohe nuk kam zhvilluar aktivitet politik përveçse si qytetare isha pjesë e protestave që organizoheshin nga Lëvizja Vetëvendosje. E çmoja angazhimin e të rinjve për vendin, dhe besoja në vizionin e tyre, derisa u anëtarësova edhe vet”.

Albulena u zgjodh deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës për tri mandate, në legjislaturën e katërt, të pestë dhe të gjashtë. Dhjetë vite më vonë, në muajin shkurt, Albulena u emërua ministre në Ministrinë e Drejtësisë. Asnjë nga arritjet gjatë karrierës së saj politike, qoftë si deputete apo ministre, Albulena nuk i trajton si personale, por si punë ekipore.

“Gjithçka kam arritur me shumë punë, shumë mund e sakrificë. Të gjitha detyrat që kam marrë përsipër, çfarëdo arritje, kanë qenë grup njerëzish që janë angazhuar aq shumë; jo rrallë pikërisht ata që japin kontributin më të madh nuk shihen por unë njoh dhe çmoj kontributin e tyre si në parti, poashtu edhe në ministri”.

Në fillim të mandatit të punës si ministre, Albulena u bë nënë, për herë të tretë. Dy djemve të saj, Malit dhe Tomorit, u erdhi në jetë motra, Andrra. Ishte kjo koha kur qeveria e atëhershme pati lëkundje dhe Albulena nuk e mendoj se do të kthehej në pozitën e ministres të cilës në vitin 2020 i shërbeu katër muaj. Ajo u zgjodh përsëri Ministre e Drejtësisë, në shkurt të vitit 2021.

“Në atë periudhë nuk isha ministre sepse ndodhi rrëzimi i Qeverisë Kurti, dhe as deputete, sepse në momentin kur jam bërë ministre, mandati i deputeti pushon. Mendoja që të paktën në atë periudhë do të kisha mundësi dhe kohë më shumë për fëmijët e mi”.



Albulena Haxhiu me vajzën e saj.

“

Mos u dekurajoni nga sulmet që i bëhen grave në politikë, angazhohuni dhe luftoni për atë çfarë synoni në jetë. Nuk mund të ecim si shoqëri nëse nuk ka angazhim të grave qoftë si politikane apo si mbështetëse. Të jeni solidare me njëra tjetrën dhe të jeni shembull i mirë për shoqërinë.

Lindja e Andrrës solli një fillim të ri në jetën e Albulenës. Përveç që ndryshoi dinamikën e familjes si vajza e parë, solli edhe emocione të ndryshme. Ishte ndjenjë e thellë gëzimi dhe përmbushjeje, por gjithashtu përbënte sprovë të reja. Ishte një dimension i ri i jetës së saj që kërkonte menaxhim të kujdesshëm të kohës dhe energjisë. *“Përgjatë gjithë kësaj kohe jam munduar të tregojë që prindërimi nuk është pengesë për angazhim politik. Është gabim kur mendohet që shtatzënia apo lindja e fëmijës duhet të ndalë zhvillimin profesional ose politik të kujtudo sikurse është edhe diskriminim nëse dikush për shkak të shtatzënisë apo lindjes së fëmijës pengohet në punësim, zhvillim profesional apo avancim. Balanci, jo çdo herë është i mundur dhe kurrsesi s’ka qenë i mundur në fillim të mandatit”.*

Mbështetja familjare normalisht bën balancimin e karrierës dhe jetës personale më të lehtë. Ishin prindërit e Albulenës dhe bashkëshorti, ata që e ndihmuan atë në punë dhe në rritjen e fëmijëve. Ata ofruan ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme, duke bërë që Albulena të mund të përqendrohej në zhvillimin e karrierës së saj, ndërkohë që menaxhonte angazhimet dhe përgjegjësitë familjare.

“U jam mirënjohëse gjithë jetën për dashurinë dhe kujdesin ndaj fëmijëve të mi sikurse edhe Albanit për mirëkuptim dhe mbështetje të fortë”.

Edhe pse të jesh nënë dhe të udhëheqësh një institucion vital në vend është një sfidë mjaft e madhe, mbështetja familjare dhe vullneti për të bërë ndryshime pozitive në sistemin e drejtësisë ishin ndër faktorët kryesor që Albulena i tejkalon telashet politike.

“Varet si e sheh dhe e merr angazhimin politik. Ka shumë politikanë në Kosovë, dhe jo secili nga ta e kryen me përgjegjësi detyrën që ka. Megjithatë për gratë është më sfiduese sepse fatkeqësisht kujdesi ndaj fëmijëve dhe shtëpisë ende konsiderohen përgjegjësi e grave”.

Kur shohim gra si Albulena, shoqëria ndjehet më e prirur të pranojë se gratë udhëheqin dhe mbajnë pozita të larta publike. Ajo është një shembull i qartë se përkushtimi dhe aftësitë e grave mund t'i ndryshojnë normat dhe të kontribuojnë në përparimin dhe zhvillimin e shoqërisë.

“Mendoj se shembujt e mirë të shumë



Ministria Haxhiu priti në takim zyrtar homologun nga Republika e Maltës

grave dhe puna e tyre e kanë ndryshuar pozitivisht perceptimin e qytetarëve për gratë në pozita udhëheqëse. Mediat këtu luajnë rol të rëndësishëm sepse kam përshtypjen që në sytë e tyre nuk shihen njësoj burrat dhe gratë që udhëheqin institucione. Shumë më shumë gjykohej veprimet e grave, ato dhe janë nën llupën e tyre. Mendoj që nuk duhet të ketë amnisti për shkak të gjinisë por ama duhet të ketë trajtim të barabartë dhe jo paragjykes, mizogjen e seksist”.

Sulmet që u bëhen grave politike nëpër media, me apo pa dashje, ndikojnë shumë herë që gratë t'i shmangen politikës. Teksa angazhimi i tyre në politikë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e shtetit, nuk duhet të komentohen e gjykohej

ato se ku bëjnë flokët apo nëse mbajnë dietë, vetëm pse janë gra.

“Përparimi i shoqërisë është i pamundur pa angazhimin e grave. Kuotat gjinore kanë ndihmuar në përfaqësimin e grave në institucione, dhe partitë politike duhet të rrisin numrin e anëtarëve gra, për të pasur një ndikim të vërtetë dhe për t'i promovuar politikën femine. Sulmet ndaj grave në politikë shpesh synojnë dekurajimin e tyre, duke përfshirë objektifikimin, komentet mbi dukjen e tyre, dhe gjuhën seksiste, të cilat i bëjnë gratë më të pasigurta në angazhimin politik”.

Përmes pjesëmarrjes aktive të grave të forta në vendimmarrje, më së miri korrigjohet ambienti diskriminues. Gratë janë efikase edhe në zbatimin e



strategjive dhe reformave që adresojnë nevojat me të cilat përballen gratë dhe vajzat.

“Ne që jemi gra e dimë më së miri shtypjen dhe diskriminim që na bëhet, prandaj duhet të angazhohemi për fuqizim të pozitës së gruas në shoqëri dhe për politika feministe. Por, në këtë drejtim duhet angazhim edhe i burrave. Mendoj se goxha ndikim do të kishte që burrat të iniciojnë politika për fuqizimin e gruas. Mendoj që angazhimi i të dyja gjinive është jetik për ndryshim të gjendjes”.

Sipas Albulenës, angazhimi për barazi gjinore dhe fuqizim të gruas nuk duhet t'i takojë vetëm njëerës gjini, në këtë rast vetëm grave, por të dyja gjinive. Për më tepër, nuk duhet menduar që dikush

që angazhohet për gratë është kundër burrave. Edhe vet Albulena ndodhë të gjykohet se është kundër burrave dhe angazhohet vetëm për gratë.

“Nuk jam kundër burrave, jam kundër dhunuesve që i shohin gratë e vajzat si prona të tyre, jam kundër atyre që duan t'i shtypin vajzat dhe gratë, që i përjashtojnë ato nga prona e trashëgimia dhe atyre që përmes veprimeve të tyre bëjnë diskriminim”.

Vendi ynë ka shumë shembuj të grave që kanë qenë të suksesshme në pozitë e tyre dhe kanë shtyrë përpara shumë politika për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në rolin e ministres së drejtësisë ka pasur më herët gra në qeveritë kosovare. Mirëpo, edhe gratë e thonë që shpesh mungon mbështetja e grave për gratë.

“Solidariteti gjinor është shumë i rëndësishëm. Mbështetja për njëra tjetrën do të ishte shembull edhe për gjeneratat pas nesh. Këtë nuk e shoh gjithmonë, më duhet ta pranoj dhe më vjen keq për këtë. Sidomos gratë në pozita udhëheqëse duhet t'i ndihmojnë gratë tjera dhe jo t'i shohin si konkurrencë e rrezik të njëjtat”.

Në politikat dhe planet e Albulenës, qysh në fillimet e karrierës së saj si politikane, një vend të veçantë e zë çështja e grave. Ajo ka zgjedhur një temë të ndjeshme, çështjen e grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë. Në fillim të mandatit ka qenë pjesë e procedimit të Ligjit për Vlerat e Luftës, i cili parashih njohjen e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Albulena shprehet se kjo ishte koha kur partia e saj ishte në opozitë dhe kishin më pak deputetë në grupin e tyre parlamentar.

“Mezi ia kemi dalë që t'i bëjmë votat. Vazhdoj të angazhohem për adresimin e sfidave që ato kanë. Kemi takime të vazhdueshme me gratë e dhunuara gjatë luftës, përfshirë edhe me të mbijetuarit burra. Por, i inkurajomë vazhdimisht që t'i adresojnë rastet e tyre në institucionet e drejtësisë si dhe të aplikojnë për njohjen e statusit sepse konsiderohet që rreth 20 mijë persona janë dhunuar seksualisht gjatë luftës, përfshirë burra”.

Angazhimet e mëdha që ka, i bëjnë ditët e saj më të gjata. E shohim çdo ditë në takime të ndryshme në vende të ndryshme të Kosovës. Albulena demonstroi angazhim të thellë

dhe përkushtim të palodhur për të kontribuar në zhvillimin e politikave dhe zgjidhjen e çështjeve kyçe për shoqërinë. Përveç aktiviteteve politike, ajo mundohet që sa më shumë të jetë e pranishme në jetën e fëmijëve të saj duke marrë pjesë në angazhimet e tyre.

“Mëngjesi është më sfiduesi zakonisht për shkak se shumë prej aktiviteteve nisin në mëngjes. Nuk kam ndonjë orar të rregullt të punës. Dal në mëngjes dhe kthehem pasdite vonë. Ka javë që jemi në zyre dhe shumë të tjera në aktivitete brenda dhe jashtë Prishtinës”.

Gratë si Albulena, kur janë në pozitë kyçe, sjellin perspektiva të reja dhe ndikojnë në krijimin e marrëveshjeve më të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Ato luajnë një rol kyç në arritjen e paqes dhe drejtësisë. Prandaj, përkrahja dhe sigurimi i një roli të barabartë për to në këto procese është një hap i rëndësishëm për arritjen e stabilitetit dhe harmonisë globale.

Drejtesia është një fushë e ndjeshme, politika dhe ky sektor duhet të jenë të ndara në mënyrë më të prerë. Albulena jep një përgjigje profesionale dhe pavarësinë e drejtësisë nuk e ndërlikohet me gjininë.

“Përgjegjësitë janë të ndara. Kjo nuk ka të bëjë me gjini. Unë nuk ndërhyj në kompetencat e një pushteti tjetër mirëpo sa herë shoh që diçka nuk funksionon siç duhet e adresoj edhe publikisht. Nuk tentoj të krijojë ndonjë balancë sepse Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi tashmë e ka përcaktuar këtë”.

Në fund të intervistës, Albulena e ka një mesazh të fuqishëm për gratë.

“Mos u dekurajoni nga sulmet që i bëhen grave në politikë, angazhohuni dhe luftoni për atë çfarë synoni në jetë. Nuk mund të ecim si shoqëri nëse nuk ka angazhim të grave goftë si politikane apo si mbështetëse. Të jeni solidare me njëra-tjetrën dhe të jeni shembull i mirë për shoqërinë”.

Albulena Haxhiu, një grua udhëheqëse dhe e përkushtuar ndaj përmirësimit të sistemit të drejtësisë, ngjallë shpirtin e angazhimit dhe reformës. Ky përkushtim e pozicionon atë si një model për përpjekjet e ndryshimeve pozitive dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke i mundësuar asaj që sot të përgjigjet me besim në pyetjen që dikur kishte: *Po, ajo ia ka dalë!*

Unë gjithmonë
e kam pas atë
idealin e drejtësisë
dhe sot e kësaj
dite kjo më
udhëheqë në jetë.



Drita e guximit dhe drejtësisë

“Unë kam mujt me qenë njëra prej juve, kjo ka mujt me i ndodhë secilës femër në Kosovë”.

Drita Hajdari është një nga figurat më të spikatura të drejtësisë në Kosovë. Ja pse, profili i saj është i pasur në çdo segment të kësaj fushe. Dashuria dhe këmbëngulja e saj ndaj të drejtës dhe të vërtetës janë dy nga veçoritë që e karakterizojnë atë. E lindur në Prishtinë, por siç thekson *“fëmijërinë e kam kalu në Vushtrri, pasi prindërit e mi kanë punuar në shtëpinë e shëndetit”*, fillon rrëfimin me fëmijërinë e saj.

Rrugëtimin drejt profesionit tejet fisnik, atë në fushën e ligjit dhe drejtësisë, zonja Drita e filloi menjëherë pas diplomimit në Fakultetin Juridik, në Universitetin e Prishtinës në vitin 1982. *“Unë gjithmonë e kam pas atë idealin e drejtësisë dhe sot e kësaj dite kjo më udhëheqë në jetë”*, tutje ajo rikthehet prapë në Vushtrri për ta filluar misionin e gjyqtarës. *“Pas regjistrimit në Fakultetin Juridik në Prishtinë unë vetëm edhe njëherë jam kthyer në Vushtrri për të punuar si gjyqtare për tri vite, e pastaj në vitin 1987 u ktheva në Prishtinë si bashkëpunëtorë profesionale në Gjykatë Supreme”.*

Periodha gjatë së cilës, Drita kishte shërbyer si gjyqtare ishte mjaft e vështirë. Të ishe grua dhe shqiptare ishin dy kombinime sfiduese. Kjo e karakterizoi përvojën e saj të drejtësisë në periudhën e Jugosllavisë. *“Në vitin 1988 kalova në Gjykatën Komunale në Prishtinë, punova si gjyqtare për të mitur, por pengesat e vërteta filluan në fund të viteve 80-ta kur filluan t'i largojnë shqiptarët nga puna”*, rrëfen Drita. Largimin nga puna ajo nuk e shihte si moment dorëzimi. *“Unë u ngrita përsëri në këmbë, vetëm një vit isha pa punë dhe vazhdova tutje si avokate”*. Ajo ka arritur t'u qëndronte besnike synimeve të saja madje edhe kur është ndjerë e rrezikuar. *“Si avokate kam hasë në shumë provokime”*. Madje ajo shpeshherë edhe i ka mbrojtur palët e saj falas. *“Unë mendoj që secili qytetar e jep kontributin e vet në mënyrën e vet, jo të gjithë mund të luftojnë me pushkë, luftohet edhe me laps e intelekt”*, shpjegon Drita.

Përkundër dashurisë së madhe për drejtësi, sprovat e jetës ndonjëherë të detyrojnë të heqësh dorë nga gjëra të cilat edhe mund t'i duash shumë. E tillë ishte periudha e luftës së fundit në Kosovë edhe për Dritën. Ajo u detyrua të largohej nga Kosova dhe të qëndrojë në Mal të Zi bashkë me familjen, mirëpo ishte rikthyer pasi kishin ardhur Misioni i Sigurisë në Kosovë, KFOR dhe Kosova ishte ende nën administrimin e misionit ndërkombëtar të krijuar nga Kombet e Bashkuara, UNMIK.

“Jam kthyer në Kosovë dhe isha në grupin e parë të Prokurorëve të emëruar nga Përfaqësuesi Special i UNMIK-ut të asaj kohe”. *“Së bashku me disa gjyqtarë kemi qenë një ekipë e vogël mobile, madje na thërrisnin “fly judges and prosecutors” pasi çdo ditë kemi udhëtuar me helikopter nëpër vende të ndryshme të Kosovës ku i prananim dhe i shqyrtonim rastet e ndryshme”*, shpjegon se si ishte të punohej në Kosovën e pas luftës si prokurorë, që në këtë rast ishte edhe e vetmja grua në atë ekip. *“Ishte mjaft e vështirë pasi nuk i kishim ende të formuara institucionet tona të drejtësisë e një kohë nuk kishim as zyre, punonim nëpër burgje”*. shton Drita. Ajo ishte një nga shqiptarët e para që zbriti në kampin amerikan “Bondsteel” me bazë në Ferizaj, ku trajtonte rastet e pranuar nga KFOR-i amerikan.

Kosova e pasluftës ishte e rrënuar dhe e varfër. Plagët ishin ende të hapura, kështu që trajtimi i krimeve nuk ishte një proces i lehtë për gjykatësit dhe prokurorët e asaj kohe. Çdo gjë ndërtohej nga fillimi, e bashkë me të edhe sistemi i drejtësisë.

Puna dhe këmbëngulja e Dritës dhe njerëzve si ajo që besonin në ngritjen dhe ndërtimin e vendit ishte drita në fund të tunelit, ashtu si emri i saj.

“Unë dhe kolegët e mi kemi punuar nga 12 deri në 15 orë, punonim edhe të shtuneve, nuk kemi pas orar, pasi është dashur me i përpunuar rastet të shumta”. Por, ideali për ndërtimin e drejtësisë në Kosovën e pasluftës ishte forca për të qëndruar dhe vazhduar tutje.

“Gjatë udhëtimeve me helikopter kam pas rast me pa se sa ishte e shkatërruar Kosova. Për shembull Peja dukej si Hiroshima, si dhe shumë vende të tjera ishin totalisht të rrënuara, gjë që tek unë shkaktonte shqetësim dhe dhimbje. Sidomos e ndjeja dhimbjen për humbjen e jetëve të shumta, për viktimat e luftës, por mbizotëronte shpresa se Kosova do të rindërtohet dhe do të bëhet shtet i pavarur”.

Pasojat e luftës së Kosovës ishin të mëdha. Krimet e kryera nga ushtria serbe, masakrat, vrasjet dhe dhunimet. Ishte Drita ajo e cila zbuloi shumë nga to. *“Gjatë muajve të parë unë kam zbuluar shumë raste të krimeve që kanë ndodhë, ishte shokues dhe tronditës ballafaqimi me to. Unë dhe kolegët e mi filluam t'i procedojmë këto raste, dhe në fund të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000 i kemi ngritë aktakuzat e para për krimet e luftës në Kosovë”*, tregon Drita se si kanë arritur t'i ngrisin aktakuzat e para për krime të luftës. Këto krime ende vazhdojnë të jenë plagë e hapur dhe e pazgjidhur. Shtetndërtimi nuk është proces që bëhet shpejtë, ndërsa fusha më sfiduese për arritjen e paqes sot e kësaj dite mbetet drejtësia.

“Se çka ndodhi në vitin 2000, nuk e di, por vetëm na thanë, dorëzoni rastet e krimeve të luftës, do t'i marrin ndërkombëtarët me i procedu”, rrëfen Drita shqetësimin e saj duke shprehur zhgënjimin por edhe detyrimin për t'ia dorëzuar ato raste ndërkombëtarëve.

Ndonjëherë idealet kushtojnë, dhe jeta të detyron të bësh zgjidhje të dhimbshme. Prokurorja Drita u gjend para një situatë të tillë pas përfundimit të luftës. Për shkak të pagave tejet të vogla të asaj kohe, e ballafaquar me mungesën e mjeteve për jetë, ajo u detyrua të hiqte dorë nga profesioni i prokurorës. *“Unë e cila u gëzova që shumë që do ta ushtrija profesionin e prokurorës në Kosovën e re e të lirë, u detyrova të hiqja dorë nga profesioni i prokurorës pasi nuk kisha mjete të mjaftueshme për jetesë”* rrëfen me mallëngjim Drita.

Ajo vazhdoi misionin e saj duke kontribuar në përgatitjen e gjeneratave të reja të policisë së Kosovës, si

ligjëruese në Shkollën Policore në Vushtrri. Në vitin 2001, rrugëtimin e saj e vazhdoi si inspektore. Pastaj si kryeshefe e Njesisë për Inspektim Gjyqësor në kuadër të Departamentit për Drejtësi të UNMIK-ut. Detyra e saj ishte hetimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore e në veçanti për shkelje të etikës profesionale. Në këtë detyrë shërbeu deri në vitin 2008.

Gjatë kësaj periudhe diçka i mungonte. Ajo thotë se nuk ishte e lumtur, nuk ishte e përmëshur profesionalisht, zemra e thërriste diku tjetër. Ndonëse ajo kaloi në tri profile të ndryshme të drejtësisë, si gjyqtare, avokate dhe si prokurore, ky i fundit ishte dashuria më e madhe e Dritës dhe ajo i qëndroi besnike deri në fund. “Të jesh prokuror nënkupton një dinamikë dhe aktivitet. Hetimi është një sfidë e madhe, të zbulosh dhe të sigurosh prova se a është kryer vepra apo jo”, tregon Drita. “Mirëpo të gjitha këto profesione më kanë krijuar si një person që i shikon gjërat nga disa perspektiva, më kanë mësuar të jem analitike dhe tu qasem problemeve nga shumë aspekte”.

Në vitin 2010 ishte shpallur riemërimi dhe vetingu për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës. Ndaj, Drita vendosi të rikthehej përsëri në gjenezën e saj, si prokurore në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë. Fillimisht ajo trajtonte raste nga më të ndryshmet për të vazhduar më pas si prokurore e specializuar në sferën e korrupsionit. “Kosova e lirë, e dashur dhe e paguar me gjak, tash po ballafaqohet me një fenomen i cili është kancer i shoqërisë”. Kjo sëmundje kishte depërtuar aq shumë në shoqëri, sa që u themeluan trupa mbrojtëse në nivel kombëtar. Drita që paraqitur si vullnetare për të punuar si prokurore kundër këtij sindromi.

Me vendimin e kryeprokurorit të atëhershëm, Drita u emërua koordinatore kombëtare kundër korrupsionit. Detyrat e saj ishin hetimi dhe ngritja e aktakuzave për korrupsion e njëherit mbikëqyrja dhe koordinimi i rasteve të korrupsionit në të gjitha Prokuroritë e Kosovës. Në këtë detyrë, ajo dëshmoi se askush nuk është përmbi ligjin, duke pasur guxim që të ngrisë aktakuza për veprat penale të korrupsionit në të cilat akuzoheshin zyrtarë të lartë të pushtetit.

Kosova ishte tashmë shtet i pavarur dhe kishte institucionet e veta, e plagët e së kaluarës së afërt i kishin rrënjët e thella. Disa nga këto ishin aq të mëdha e të dhimbshme sa që guximi për t'i hapur e shikuar ishte i domosdoshëm. Sidomos ishte e ndjeshme çështja e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Në vitin 2013, Drita vazhdoi rrugëtimin e saj në Prokurorinë Speciale në Kosovë, e tri vite më pas zëri ndërgjegjes e dërgoi pikërisht tek heroinat e dhunës seksuale.

“Në vitin 2016 kur filloi dorëzimi i kompetencave për krimet e luftës nga prokurorët ndërkombëtarë tek prokurorët vendor, u paraqita vullnetare për prokurore të krimeve të luftës dhe u caktova pastaj edhe shefe e këtij departamenti”. Mirëpo procesi i dorëzimit të lëndëve mori plot dy vite, periudhë kjo mjaft e gjatë e cila edhe i zvarriste procedurat. “Ka qenë një kaos në lëndët në të cilat i kemi pranuar”, shton Drita.

Kërkimi për ligjshmëri të merituar, për të mbijetuarat

e dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë mbetet padyshim një nga sukseset më të mëdha por edhe krenaritë e sfidat më të mëdha të karrierës së saj. “Në kuadër të krimeve të luftës janë paraqitë edhe dhunimet, të cilat janë një kategori e ndjeshme dhe më delikate për tu proceduar”. Në mesin e tërë këtyre rasteve të bartura nga Administrata Ndërkombëtare e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë tek Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë ishte vetëm një rast i gjykuar. “Ishte tashmë rasti i njohur i Vasfije Krasniqit, i cili ka dështuar”, tregon ndër të tjera Drita. Pas marrjes së kompetencave Drita është përpjekur që ta rihapë rastin e Vasfijes, por për fat të keq ka hasur në barriera juridike, në përsëritjen e procedurës.

Rrethanat e punës për të dhe kolegët e saj ishin mjaft të vështira, duke mos pasur as edhe një ndihmë apo model të mëhershëm veprimi.

Drita i është qasur këtyre rasteve me shumë kujdes. Stigma në shoqëri ishte jashtëzakonisht e madhe për të mbijetuarat. “Ato ndiheshin të turpëruara dhe në faj për atë se çfarë u kishte ndodhur, ishte shumë e vështirë për to që të flisnin hapur për rastin, gjithmonë nga frika mos po zbulohet identiteti i tyre”. Drita kështu krijoi praktikat për mbrojtjen maksimale të të mbijetuarave.

“Unë bisedova me organizatat joqeveritare që kanë në fokus këtë problematikë dhe dhashë idenë që këto viktimat të merren në pyetje brenda hapësirave të këtyre organizatave në prezencën e psikologut”. “Kjo metodë ka qenë më mbrojtëse pasi ardhja e tyre në ndërtesat e prokurorisë paraqiste një mundësi të ekspozimit të të mbijetuarave”. Tejet e kujdesshme, zonja Drita ka paraqitur kërkesë në gjykatë që emri i të mbijetuarave të shënohet me kod të caktuar si dhe të mos publikohet asnjë shkresë apo informacion i cili mund të zbulojë identitetin e të mbijetuarës. Ajo poashtu kërkonte gjykime jopublike për këto raste.

Të punosh me atë kategori të grave, është jashtëzakonisht e vështirë, plaga që ato bartin është e dhimbshme, e të fitosh besimin e tyre është mrekulli, shprehet ajo. “Besimin e tyre e kam fitu me sinqeritet, jam taku me to në mënyrë grupore dhe individuale. Fjalja e parë që u thosha ishte: “Unë kam mujt me qenë njëra prej juve, kjo ka mujt me i ndodhë secilës femër në Kosovë. “Ju nuk keni asnjë faj për atë që ju ka ndodhur”. “Pas këtyre fjalëve të mia, vërejtja një shkëlqim në sytë e këtyre grave të pafajshme”, shton Drita për ZA-në.

Drita shton edhe një element tjetër të rëndësishëm. Në mënyrë që gratë dhe meshkujt e dhunuar të denoncojnë rastin dhe të dëshmojnë për atë që iu ka ndodhur nevojitet në radhë të parë përkrahja e familjes dhe gjithë shoqërisë në tërësi. “Ato viktimat, e sidomos gra, që i tejkalojnë këto sfida dhe dëshmojnë për rastet e tyre janë vërtetë heroina, sepse e bënin të kuptohej e vërteta e luftës në Kosovë, që dhunimi ishte armë lufte e armikut dhe se me këto krime qëllimisht e kanë goditur gruan si shtyllë e rëndësishme e familjes dhe shoqërisë sonë në përgjithësi”.

Ballafaqimi me të vërtetën, me dhunuesin, ishte procesi më i rëndë. Drita thotë që gratë shqiptare e kanë një forcë që rrallë kund mund të gjendet. “Dhunimet zakonisht kanë ndodhë nga pjesëtarët armiqësor të uniformuar,

në mënyrat më brutale të mundshme, duke mos kursyer as nga moshja, madje as gratë shtatzëna, disa ishin të dhunuar edhe në prezencë të burrave e fëmijëve”, rrëfen Drita. Guximi i saj për të nxjerrë të vërtetën në dritë ka rrezikuar edhe vetë ekzistencën e saj, “Kam pas një kërcënim nga Serbia, por kjo nuk më ka ndalë, veç kam qenë pak më e kujdesshme në jetën private e një kohë isha edhe me përcjellje policore”.

Seancat gjyqësore ishin një sfidë në vete. Për të mbijetuar aty ka emocione, frikë, një lloj turpi për atë që iu ka ndodhur edhe pse pa fajin e tyre. Një forcë e brendshme për të marrë drejtësinë e merituar nxirrte krahë që nuk dinin që i kishin. Vetë Drita kishte qenë dëshmitare se si dhimbja e mbledhur brenda ishte kthyer në një shpërthim force brenda një sekonde, gjatë përballjes së të mbijetuarës me dhunuesin në seancën gjyqësore.

“E mbijetuara e cila tanë kohën gjatë gjyqimit rrinte e tërhequr, kokëulur, në një moment kur i akuzuari i thotë: “Këqyrem në sy, ti po rren”, ajo në atë moment ngrihet nga karriga dhe i drejtohet të akuzuarit me një fuqi të paparë: “Kush po rren, këqyrem ti mu në sy kur të thom, ti je ai që më ke dhunu kur isha shtatzëne në muajin e tetë, për shkak teje i humba dy foshnje binjake, ti je ai që më ke goditë me çizme në shpinë pas dhunimit”. I akuzuari kishte ulë kokën dhe kishte heshtur. Drita kishte ndërjet krenari, dhe i kishte thënë të heroinës së dhunuar “Bravo, bravo”, rrëfen me krenari dhe mallëngjim vet ajo. Ata që duhet të turpërohen dhe ulin kokën, janë dhunuesit.

Çështjet e pazgjidhura të luftës së

**Ju them,
nuk jeni
vetëm, nuk
do të jeni
vetëm, nuk
ju lëmë
vetëm.**



Foto e huazuar nga rrjetet sociale.

Kosovës janë pengesë për një paqe të qëndrueshme në vend. Pa u vendosur drejtësia për të mbijetuarat e luftës, për të zhdukurit, qetësi nuk mund të ketë. “Nuk mund të flitet për pajtim dhe paqe, kur kemi sa e sa raste që ende nuk janë paraqitë për dhunë seksuale, kur ende nuk janë kapë kriminelët e luftës si dhe kur nuk kemi bashkëpunim me shtetin fqinj për gjetjen e të zhdukurve”, shpjegon Drita.

Ajo me krenari rrëfen se si deri në pensionimin e saj, në dhjetor të vitit 2023, ka vazhduar dhe ka ngritur gjithsej gjashtë aktakuza për krime lufte. “Dy në prezencën e të pandehurit, një nga të cilat ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë me 13 vite burgim, si dhe katër raste të tjera janë ngritë në mungesë”, por përmbushja e saj më e madhe pak para pensionimit është kjo:

“Dy ditë para se me u pensionu e kam ngitë aktakuzën për masakrën më të madhe në Kosovë, Masakrën e Mejës, dhe kam dalë nga prokuroria me krenari që e kam përmbush detyrën time, pasi Meja ka qenë dhimbja ime e madhe personale e profesionale”.

Në Masakrën e Mejës të Gjakovës, të cilën zonja Drita e quan “Srebrenica e Kosovës” janë vrarë rreth 370 civilë të pafajshëm dhe 7 ushtarë të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës.

Drita kontaktin me viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës e vazhdon ende. Ajo gjen mënyra të ndryshme për të qenë afër tyre. Afërsinë e tyre e shpjegon kështu: “Kur kam dalë në pension ka pasë gra që kanë qaj të, thojshin çka bojmë pa ty, unë u thosha: jo jo, po mbetem unë me juve”. Drita jo vetëm që mbanë kontakte por iu ndihmon me procedurat të cilat ato duhet ndërmarë për të paraqitë rastet. “Ju them, nuk jeni vetëm, nuk do të jeni vetëm, nuk ju lëmë vetëm”. Kontributi i Dritës vazhdon ende në mënyra të ndryshme, pasi dashuria për të drejtën, vendin e të mirën nuk ka moshë pensionimi.

Kjo grua e hekurit, e mençur dhe e guximshme, tërë jetën ia kushtoi kauzës së drejtësisë. Kështu e përmbyllë rrëfimin e saj me një porosi të fuqishme duke iu drejtuar të gjitha vajzave dhe grave që synojnë të merren me drejtësi: “Duke filluar nga hapat e parë në karrierë dhe në asnjë rast të mos i lejojnë vetes pranimin e ndonjë favoriti sepse do bëhen peng të atyre favoreve. Duhet të krijojnë imazhin e vet personal dhe të dallohen nga profesionalizmi dhe personaliteti i fuqishëm”.

Flutura për
lirinë e medias
në Kosovë

Flutura Kusari

E lindur dhe rritur në Gjakovë, Flutura Kusari është një nga gratë e rralla në Kosovë në profesionin e saj. Është e veçantë dhe këmbëngulëse. Thuhet se fluturat e vërteta nuk e shohin bukurinë e krahëve të vet. I shohin të tjerët. E tillë duket edhe puna e zonjës Kusari. Përpyekja e saj e vazhdueshme për lirinë dhe demokracinë e medias si një pushtet i katërt i çdo shteti në botë është mbresëlënëse.

Etika profesionale e Fluturës i ka rrënjët thellë qysh në fëmijërinë e hershme të saj, ndonëse e rritur gjatë periudhës së luftës në Kosovë, dhimbja e asaj kohe e bëri atë edhe më të fortë duke i dhënë krahë për të vazhduar tutje. *“Fëmijëria ime ka qenë e ngjashme me atë të shumë fëmijëve në Kosovë, me kushte shpesh të vështira ekonomike, nën ndjenjën që një ditë do të ketë luftë siç edhe ndodhi dhe me mungesë të lirisë dhe pavarësisë së shtetit tonë”*, fillon rrëfimin e saj për ZA-në Flutura, duke theksuar pasigurinë dhe të panjohurat e asaj kohe.

Bindja ndaj të mirës dhe drejtësisë janë trashëgimi e asaj që prindërit i kanë dhënë Fluturës. *“Jam rritur me këshillat e nanës dhe babit që të duam njëri tjetrin, të ndihmojmë kur kemi mundësi, t'i përkushtohemi shkollës, të jemi të drejtë në raport me të tjerët, të ngrisim zërin për vete dhe të tjerët kur shohim padrejtësi, të mos dorëzohemi para sfidave dhe të mos frikësohemi asnjëherë”*, tregon Flutura me buzëqeshje krenarie.

Flutura forcoi bindjet e saj për çështjet e aktivizimit shoqëror kur filloi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Mirëpo rrjedha e jetës e dërgoi atë tek një fushë shumë specifike në studimet master dhe kur fitoi një bursë nga qeveria Britanike.

“Bursa e Qeverisë Britanike Chevening më ka ndihmuar që si juriste të specializohem në fushën e mbrojtjes së lirisë së medias. Pastaj, studimet e doktoratës në të Drejtën e Medias në Universitetin e Gentit më kanë ndihmuar tutje që të profilizohem edhe më shumë”, rrëfen për edukimin e saj Flutura.

Rrugëtimin e saj të juristes, zonja Kusari e filloi menjëherë pas përfundimit të studimeve. *“Unë kam filluar si praktikante në Këshillin për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe pastaj kam punuar për disa organizata joqeveritare vendore, si hulumtuese,*



za | e nisën nga zero

e nisën nga zero



Flutura Kusari për çështjen e Klan Kosovës.
Foto e huazuar nga rrjetet sociale.

koordinatore e projekteve dhe më pas si këshilltare ligjore”, rrëfen ndër të tjera Flutura për fillimet e saj në profesion gjatë vitit 2004.

Përkrahja e Fluturës si dhe puna e saj e vazhdueshme për ta promovuar dhe mbrojtur lirinë e atyre që paraqesin të vërtetën e vendit, pra të gazetarëve, është për tu admiruar.

Në një vend pa liri të mediave nuk mund të thuhet që ka demokraci. “Mbrotjtja e gazetarëve dhe profesionit të gazetarisë është e rëndësishme në këtë kohë kur në mbarë globin ka rënie të demokracive, sundimit të ligjit dhe garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut”, rrëfen zonja Kusari për revistën ZA.

Njëlloj si të gjitha gratë e tjera edhe Flutura ka hasur në paragjykitime dhe vështirësi sidomos për faktin se nuk është burrë. Madje ka pasur individë të caktuar që janë marrë edhe me pamjen dhe dukjen e Fluturës, duke anashkaluar punën dhe përkushtimin e saj.

Flutura si një zonjë e cila përgjigjet me punë dhe sukses edhe kësaj here vendosi të mos i përgjigjet këtyre komenteve të pavenda. Madje në prononcimet e saja të mëhershme dhënë mediave ajo ishte shprehur: “E kam si princip që asnjëherë nuk i komentoj dhe nuk reagoj ndaj atyre komenteve, madje kur e shoh që një person po i denigron gazetarët apo po më drejtohet personalisht mua, i bllokoi pasi nuk dua të kem qasje me të. Për mua është kyçe të mos përfshihem në atë debat”, kishte deklaruar Flutura.

Për Fluturën pabarazia mes burrave

dhe grave është më se e vërtetë dhe ajo vërehet në çdo fushë. “Pozita e gruas në shoqëri është larg nga të qenit e barabartë me pozitën e burrave dhe një gjë e tillë reflekton edhe në media”, rrëfen Flutura.

Delegjtimimi i grave duke përdor pamjen dhe seksin e tyre dhe jo aspektin profesional është një nga strategjitë e liga që edhe individët në Kosovë e përdorin.

“Qasja patriarkale dhe shtypëse, trajtimi seksist dhe diskriminues për shkak të gjinisë ndaj gazetarëve gra është normalitet i pranuar në raport me gratë dhe vije si nga jashtë nga politikanët dhe biznesmenët për të cilët raportojnë gratë gazetare ashtu edhe përbrenda redaksive dhe shtëpive të mediave”, tregon Flutura.

Ajo mbron gazetarët pa dallim të gjinisë, por vëren se ndonjëherë për gra puna si gazetare vështirësohet. “Gratë gazetare kanë dëshmuar që janë më të gatshme ta rrezikojnë jetën e tyre për t’i shërbyer publikut duke e informuar atë në kohë pandemie apo në kohë pasigurie si për shembull gjatë sulmeve në Veriun e Mitrovicës dhe rrjedhimisht janë më të rrezikuara”, thotë Flutura.

Ndonëse në publikimet e saj në rrjetet sociale, ajo njerëzit i ndanë në dy kategori, ata që i mbrojnë gazetarët dhe ata që flasin keq për ta si dhe shtron pyetje rreth kësaj çështje, gjatë intervistës ajo nuk hyri në këtë temë duke na lënë neve vend të hulumtojmë dhe shohim të vërtetën. Duke përdorë kategorizimin e saj, ne po themi, njerëzit besoj ndahen në dy grupe, ato gra që flasin për jetën personale dhe atë që e lënë punën e tyre të flasë. Flutura nuk është në kategorinë e parë. Ajo

është e martuar, ka familje por nuk preferon t’i prezantojë në media apo media sociale.

Flutura tregon që në media, komercializmi në ditët e sotme është mjaft i pranishëm dhe fatkeqësisht kjo gjë po ndikon në zbehjen e profesionalizmit dhe ruajtjes së etikës profesionale. Sipas Fluturës gratë kanë arritur t’i qëndrojnë besnike profesionalizmit dhe nuk janë ndikuar nga paratë apo fama.

“Përderisa shohim shumë gra gazetare në terren, ka më pak të tilla që përfshihen në debate televizive politike kryesisht për shkak se debatet e tilla janë shndërruar në show televiziv ku burrat kritikojnë njëri-tjetrin ose të tjerët më shumë për show se sa për të mbajtur përgjegjësi pushtetin”, rrëfen Flutura për ne. Madje në bazë të përvojës së saj ajo çmon lartë vendosmërinë e grave për t’i qëndruar besnike profesionit të tyre. “Shumë pak gra janë të gatshme që të heqin dorë nga profesionalizmi dhe t’i bashkohen spektakleve televizive politike që bëhen për t’i kënaqur masat”, thotë ndër të tjera Flutura.

Kusari thekson një dallim mes përfshirjes se grave në terren dhe atyre në studio. Si juriste për të drejtën e medias ajo shqetësohet shumë për prezantimin jo dinjitoz dhe të mangët të grave në mediat dhe televizionet tona dhe këtë Flutura e sheh si përgjegjësi dhe njëkohësisht mangësi. “Përgjegjësia për të siguruar më shumë gra prezente iu takon mediave. Drejtuesit e mediave duhet të sigurohen që të krijojnë ambiente të sigurta për gra në mënyrë që ato të ndajnë më publikun dhe shoqërinë perspektivën e tyre. Prezenca e grave gjatë transmetimeve nuk është prioritet nga shumica e mediave e sidomos nga televizionet, deklaroi Flutura.

Për një aktiviste të medias dhe gazetarëve, mediat kanë po aq rol të rëndësishëm, si në luftë ashtu edhe në paqe.

“Media luan rol thelbësor në shoqëri, qoftë në kohë lufte apo paqeje. Misioni i saj për ta informuar publikun për çështje me interes të përgjithshëm është tejet i rëndësishëm prandaj shtetet duhet t’i ndërmarrin të gjitha veprimet që të sigurojnë një ambient të përshtatshëm dhe të lirë për veprimtarinë mediale”, jep mendimin e saj Flutura Kusari.

Nga organizatat që analizojnë lirinë e mediave, si për shembull “Freedom

House“, liria e medias në Kosovë shihet si deri diku e kufizuar. Janë shënuar incidente dhe tendenca shqetësuese në vitin 2023. Për më tepër kjo organizatë me seli në Uashington thotë se në Kosovë mediat shfaqin hezitim për t'u angazhuar në mbulimin kritik të qeverisë. Këtë gjë e pohon edhe vetë Flutura. *“Në tri vitet e fundit, puna e mediave dhe gazetarëve është vështirësuar për shkak të pasigurisë online dhe offline, kampanjave linçuese kundër gazetarëve që vijnë nga pushteti dhe iniciativat e ndryshme si sentiment mbyllja e televizionit Klan Kosova dhe aprovimi i ligjit për Komisionin e Pavarur për Media pa i përfillur rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare”,* shprehet Flutura për ZA-në.

Sipas ekspertës Kusari, duhet ende shumë punë në përmirësimin e kushteve në të cilat mediat ushtrojnë profesionin e tyre. *“Përveç që nuk ka hapësirë për lavdërim, ka hapësirë për frikë për vazhdimësi të politikave që synojnë censurimin e mediave dhe debumanizimin e gazetarëve dhe aktivistëve”,* rrëfen Flutura ndër të tjera.

Janë bërë tashmë 10 vite Flutura punon në Leipzig të Gjermanisë në Qendrën Europiane për Liri të Shtypit dhe Medias, e cila është një organizatë joqeveritare që vepron bazuar në rregullat dhe parimet e Kartës Evropiane për Lirinë e Shtypit si dhe Kartës për të Drejtat Themelore të Unionit Europian, e cila qendër merret me monitorimin dhe mbrojtjen e lirisë së medias.

“Aty drejtoj programin ligjor që ndër vite ka ofruar mbrojtje për më shumë së 200 gazetarë në tërë Europën”, tregon Flutura.

Gjatë këtyre viteve ajo ka hasur në përvoja nga më të ndryshmet me gazetarë të vendeve të ndryshme të botës. *“Kam pasur nderin që të mbështesë gazetarë në vende si Turqia, Hungaria, Polonia, Belgjika dhe vende tjera, të cilët janë ballafaquar me padi apo arrestime”,* ndanë përvojat ndërkombëtare Flutura me ZA-në.

Një rast të spikatur Flutura e kishte përjetuar me rastin e gazetares malteze Daphne Caruana Galizia e cila u vra vetëm për shkak se raportoi shkeljet e kryera nga pushtetarët e vendit të saj.

Daphne kishte shërbyer si gazetare, redaktore në Maltë për më shumë se

30 vite. Ajo kishte marrë vazhdimisht kërcënime për aktivitetin dhe shkrimet e saja, shtëpisë së saj i kishin vënë flakën dy herë, dhe tre qentë e saj shtëpiak ishin vrarë nga persona të panjohur.

“Rasti më i rëndësishëm në jetën time mbetet rasti i vrasjes së gazetares malteze Daphne Caruana Galizia, e cila është vrarë për shkak se ka ekspozuar korrupsionin që përfshinte qeverinë malteze. Familja e saj ende lufton për drejtësi dhe unë vazhdoj ta mbështes familjen së bashku me shumë organizata tjera ndërkombëtare. Ky rast vë në pah rrezikshmërinë e profesionit të gazetarisë dhe obligimin e shtetit që t'i mbrojtë gazetarët, në të cilin obligim Malta ka dështuar”, tregon Flutura.

Caruana Galizia asnjëherë nuk aplikoi për asnjë çmim dhe nuk kërkoi nominimin e saj. Ajo ishte fituese e shumë çmimeve për gazetari dhe jo vetëm, si dhe pas vdekjes së saj shumë çmime, institute dhe dhoma gazetarie janë emëruar sipas saj në nderim të veprës dhe jetës së Daphne.

Flutura, në Kosovë asnjëherë nuk rresht së ngrituri zërin ndaj çdo padrejtësie. Një nga çështjet që e shqetëson më së shumti atë si grua është dhuna që ushtrohet ndaj grave dhe sidomos me etikën e gazetarëve gjatë raportimit të këtyre rasteve.

“Sa i përket adresimit të dhunës ndaj grave, duhet të ndërmerren tre hapa: Pushteti duhet t'i respektojë gazetarët në përgjithësi dhe gratë në veçanti dhe duhet të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të përkeqësohet në sulm ndaj tyre, duhet të ndryshojë legjislacionin penal duke ashpërsuar sulmet ndaj gazetarëve, sidomos gazetarëve gra dhe duhet të promovojë aktivisht një kulturë të transparencës dhe respektimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias”, shpjegon tre hapat konkret Flutura.

Për Fluturën kritikantat janë të mirëseardhura, por gjithmonë kur janë me vend dhe nuk i tejkalojnë kufijtë e një kritike. *“Kritika e bazuar dhe qëllim-mirë, sado e ashpër që mund të jetë, kontribuon në përmirësimin e një situatë, procesi të caktuar. Mirëpo, në shoqëri rolet janë të ndara, që do të thotë politikanët nuk kanë të drejtë të sulmojnë gazetarët në baza personale në emër të kritikës. Ata duhet të jenë tolerantë ndaj kritikës, edhe kur ajo mund të jetë e ekzagjeruar. Diskutimet për median dhe kualitetin e punës së tyre duhet të*

ndodhin në vazhdimësi por me kushtin që ato diskutime të bazohen në fakte dhe të kenë qëllim të mirë”, deklaroi Flutura.

Angazhimi i saj shumëvjeçar, përkushtimi si dhe puna e mirëfilltë e bazuar në etikë e humanitet, ka kaluar kufijtë e vlerësimit edhe jashtë Kosovës. Flutura është juristja dhe aktivistja e parë e Kosovës që është dekoruar me Urdhrin e Meritës së Republikës Federale të Gjermanisë.

“Çmimi Urdhri i Meritave të Republikës Federale të Gjermanisë nga ana e presidentit të Gjermanisë Frank-Walter Steinmeier është njohje e punës dhe motiv për të vazhduar aktivizmin. Ndjehem jashtëzakonisht e nderuar dhe tejet falënderuese”, rrëfen Flutura duke theksuar se si asnjëherë më parë është e nevojshme mbrojtja e lirisë së mediave në Kosovë dhe Evropë për shkak të demokracive të sfiduara e të limituara.

E zonja, bujare, e dashur e njerëzore, gjithmonë këmbëngulëse ndaj kauzave të mira e të drejta, Flutura është frymëzim për shumë gra e vajza të reja të cilat janë të rrethuara me ëndrra e qëllime në shoqëritë e sotme të ashtuquajtura demokratike. *“Për vajzat që e lexojnë këtë shkrim, iu them: lexoni, mësoni dhe merreni shkollën seriozisht. Ju mund të jenë të pavarura dhe të jetoni jetën ashtu siç keni qejf vetëm nëse arrini të shkolloheni dhe punësoheni. Poashtu, iu them: ngrisni zërin kur ju bëhen padrejtësi juve ose të tjerëve”,* përfundon rrëfimin e saj Flutura me një porosi për të gjitha vajzat që iu bie në dorë shkrimi i saj, gjithmonë modeste dhe e buzëqeshur por edhe e hekurt ndaj çdo kauze që i beson. Flutura, publiku po e sheh më së miri punën që po bën në mbrojtjen e lirisë së mediave dhe gazetarëve. Paqe e siguri, me gazetarë të guximshëm.



Diskutimet për median dhe kualitetin e punës së tyre duhet të ndodhin në vazhdimësi por me kushtin që ato diskutime të bazohen në fakte dhe të kenë qëllim të mirë



**Solidariteti është gjithçka,
dhe se duhet te ketë
përkrahje në mes nesh.
e po ashtu, asnjëhere
nuk duhet ndaluar, se në
momentin që ndalesh do
ecës mbrapa për tre a
katër hapa.**

- Flora Macula



Një jetë në shërbim të komunitetit


Është frymëzuese të takosh dikë me përvojën dhe arritjet si të Flora Maculës. Ajo ka kaluar tërë jetën duke i shërbyer komunitetit dhe duke punuar për të mirën e të tjerëve. Zonja Macula e përshkruan jetën e saj me urtësi dhe përlulësi, duke falënderuar të gjithë ata që e ndihmuan në arritjen e qëllimeve mirëdashëse. Prej Mitrovicës në Ukrainë, Bangladesh, e deri në Jemen, ajo ka dhënë kontribut të madh në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në ngritjen e figurës së gruas në shoqëri.

Një nga momentet më të rëndësishme të punës së Florës ishte mbështetja për themelimin e organizatave të grave, të cilat ofronin ndihmë pas korrikut 1999, veçanërisht për gratë dhe vajzat. Ajo kujton nisjen e kurseve të shkrimit dhe leximit në Skenderaj dhe Drenas, ku gratë e angazhuara mblodhën të dhëna për statusin social, nivelin e arsimit dhe numrin e fëmijëve. Ky angazhim ishte thelbësor për avokim në strukturat vendimmarrëse dhe lidhjen e ndihmës humanitare me intervenime afatgjata. Pavarësisht sfidave, ajo thekson se mbështetjen më të madhe e kishte nga prindërit e saj. Ajo u rrit me katër motra dhe dy vëllezër, dhe falënderon babanë për përkrahjen e palëkundur që ofroi për të gjithë fëmijët. *“Fëmijët e marrin modelin nga familja”*, thotë Flora, duke treguar se si udhëheqja e prindërve të saj e ndihmoi atë të ngritej.

Flora u lind në Mitrovicë, atje përfundoi shkollën fillore dhe vitin e parë të Gjimnazit të Përgjithshëm. Për shkak të aftësive dhe përkushtimit të saj, ajo u përzgjedh si një nga nxënëset më të mira për të vazhduar studimet në Gjimnazin Matematikor në Prishtinë, i cili kishte një kurikulë më të rreptë. Macula kujton se ky ndryshim përkthehej në një pavarësi më të madhe dhe në kujdes të shtuar për veten dhe punën gjatë studimeve. Ajo përmend ditët e gjata të studimit intensiv me kolegët e saj, që shpesh zgjatnin deri në 24 orë, për të përmbushur kërkesat rigorozë të programit *“Në atë kohë, ky lloj gjimnazi ekzistonte vetëm në Kiev të Ukrainës, Beograd dhe Prishtinë”*,

thekson ajo, duke shtuar se detyra e vetme e studentëve ishte të mësonin me përkushtim. Ajo përmend gjithashtu kolegen e saj, Teuta Sahatqija, një diplomate e shquar dhe ish-ambasadore e Kosovës në Kombet e Bashkuara, si pjesë e gjeneratës së fundit të këtij programi, dhe shton se të diplomuarit nga ky gjimnaz funksiononin si një lokomotivë e suksesit. *“Arsimi dhe shkollimi atëherë ishte shumë më serioz”*, deklaroi Flora.

Duke kujtuar rininë e saj, Flora rrëfen se gjithmonë ka qenë e gatshme të ngrëjë zërin kundër padrejtësive. E udhëhequr nga një kuriozitet i pashuar, ajo gjithmonë fillonte diçka ndryshe, bënte pyetje dhe kërkonte përgjigje pa u ndalur tek vështirësitë. Ajo beson se pikërisht kjo mendësi e ka ndihmuar



në angazhimet e saj si aktiviste e re. Përfshirja e saj në organizimet shoqërore gjatë kohës së luftës në Kosovë erdhi natyrshëm, pasi ndjenja e nevojës për t'i luftuar padrejtësitë ishte tashmë e rrënjësor brenda saj. Gjatë jetës së saj në Mitrovicë, Flora u përfshi edhe në arsimin e të rinjve, ku së bashku me kolegët e saj kontribuan në edukimin dhe ngritjen e brezave të rinj. Ajo kujton me krenari një shembull kur një nga nxënësit e saj u përzgjidh për ta përfaqësuar Mitrovicën në një nga garat rajonale në matematikë, të cilat shpesh dominoheshin nga studentë serbë.

Përkundër përgjegjësive të mëdha, Flora e konsideron këtë periudhë si një nga arritjet e saj të para në karrierë.

Tëksa shpalos jetën e saj, Flora tregon se është një studente e përjetshme, gjithmonë e etur për të mësuar diçka të re. Ky përshkrim bëhet real kur ajo tregon se përfundoi studimet e saj të fundit të masterit në fushën e Ligjit dhe Integritimit Evropian në moshën 50-vjeçare. *“Në grupin tim kishte studentë shumë më të rinj se unë, dhe në ceremoninë e diplomimit mbaj mend prindërit e tyre, të cilët ishin moshatarë me mua, duke u thënë se kurrë s'është vonë”* thotë ajo, duke theksuar se për të, moshja nuk ka pasur kurrë rëndësi në ndjekjen e ambicieve.

Në vitet 90-ta, Flora dhe kolegët e saj u përjashtuan nga puna, dhe ajo refuzoi të qëndronte duarkryq, duke u angazhuar si aktiviste. Një moment kyç në karrierën e saj ishte angazhimi në çështjet gjinore, të cilat atëherë nuk emërtoheshin si të tilla. Ajo kujton se aktivistët mblidheshin çdo të diele për të diskutuar për të drejtat e grave, pa ekzistuar ende koncepti i grave në siguri. Për Florën, këto diskutime mujore ishin të domosdoshme, pasi mësonin nga praktika dhe ekspertët që ishin prezent. Ajo thotë: *“Krejt çka kemi mësuar ka qenë duke parë dhe dëgjuar, gjithmonë duke qenë të interesuar për këto çështje”*. Nga viti 97' ajo kujton se si kontributi në shoqëri ishte i domosdoshëm pasi konfliktet zhvilloheshin nga të dy anët, jo vetëm në Kosovë por edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shoqëria gjendej në kushte të mjerueshme dhe ekzistenca nuk ishte e garantuar por drejtohej nga mundi i njerëzve si Flora. *“Gjatë kohës së luftës në Sarajevë/Bosnjë, përmes Agjencisë Adventiste për Zhvillim dhe Ndihmë Ndërkombëtare (ADRA-s),*

dërguam ndihma bazike si sheqer e qumësht për fëmijë”, thotë Flora për të treguar se ishin mjetet elementare ato që vlerësoheshin nga ata në nevojë. Flora sigurisht që vazhdoi angazhimin e saj si aktiviste edhe në vendlindje gjatë kohës së luftës në Kosovë.

Pas çlirimit të Kosovës, Flora kujton se vendi u mbush me një valë ndërkombëtarësh, duke përfshirë trupat e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO-së), Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-un), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-në) dhe Bashkimit Evropian, si dhe rreth 150 organizata të tjera ndërkombëtare. *“Dukej sikur kishte më shumë ndërkombëtarë se sa vendas”*, thotë Flora, duke shpjeguar se qëllimi kryesor i punës ishte kthimi i të zhvendosurve gjatë luftës.

Në vitet 1997-98, Flora mori rolin menaxheres së Zyrës së Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit (IRC), një nga përvojat më frytdhënëse të karrierës së saj. Për këtë eksperiencë ajo thotë: *“Kam mësuar shumë mbi punën në komunitet, mbaj mend që shkoni në Gjilan për t'u ulur dhe diskutuar mbi prioritetet e tyre. Asnjë punë sado e madhe që ishte nuk bëhej pa u diskutuar me pjesëtarët e komunitetit e tek më pas me eprovet”*. Në vazhdimësi të këtij angazhimi, Flora vazhdoi punën edhe në Maqedoninë e Veriut me udhëheqjen e kampit në Neproshten, një angazhim që e konsideron një detyrë morale, pasi atje ndodheshin njerëzit e saj në nevojë. Ajo kujton se ndodhej në Kosovë gjatë bombardimeve, por rreth datës 30 mars, ajo dhe shumë të tjerë u deportuan nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe drejt Maqedonisë, ku u mbajtën si pengje afër kufirit për katër ditë. Edhe kjo përvojë e forcoi tutje.

“Kam udhëtuar çdo ditë, dhe për të mos e kuptuar njerëzit që nuk isha aty me ta, zgjohesha në 4 të mëngjesit për të marrë autobusin për në Gostivar-Tetovë...unë çdo mëngjes isha aty, mirëpo kur erdhën bordi për ta vlerësuar gjendjen dhe më kërkuan që t'i udhëheq, unë i drejtova tek fëmijët pasi që vetëm ata mund t'i tregonin se çfarë po ndodhte me të vërtetë”.

Edhe ky moment, tregon Flora, ishte simbolik për qasjen e saj në punë — për të, dëgjimi dhe vënia në qendër e atyre që përjetonin vështirësitë ishte mënyra

më e mirë për ta kuptuar realitetin dhe për të siguruar që ndihma e dhënë ishte reale dhe me ndikim. Përkushtimi për të qenë aty, fizikisht dhe shpirtërisht, tregon thellësinë e angazhimit të saj ndaj misionit që kishte.

Flora thekson se fokusi i saj ka qenë gjithmonë mbrojtja e të drejtave të grave dhe fuqizimi i tyre, mirëpo në ato kohë ishte e vështirë që të siguroheshin grante mbi këtë temë. Për këtë ajo punoi shumë në gjetjen e fondeve për tre organizata që u angazhuan për t'i ndihmuar gratë dhe fëmijët në Kosovë dhe Tetovë. Flora me dhimbje të thellë kujton kohën kur takoi nëna që kishin lindur fëmijët e tyre në mal dhe gra që kishin humbur bashkëshortët duke i parë të vdisnin para syve. *“Kam parë e dëgjuar shumë raste, shumë trauma, mirëpo asnjëherë asnjë nuk e harroj”* deklaroi Flora, teksa qëllimisht nuk sjell raste të tjera po kështu të ndjeshme.

Pas kthimit nga Maqedonia e Veriut, ajo udhëhoqi tri programe në IRC lidhur me zhvillimin e komunitetit, punën e organizatave të grave dhe shoqërisë civile. Këto angazhime i ofruan një bazë të fortë, por ajo thekson se ndihmën më të madhe e merrte nga bashkëpunëtorët e saj, vajza dhe gra nga 15 fshatra, të cilat i organizoi për të mbledhur informacion mbi situatën. Megjithatë, IRC-ja nuk kishte fonde të mjaftueshme për të ofruar ndihma. Ajo vendosi të kontaktonte organizata të tjera për të kërkuar fonde dhe zgjidhje. Gjatë kësaj periudhe, iu ofrua një punë nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR-së), por e refuzoi, pasi nuk dëshironte të linte përgjysmë angazhimet dhe iniciativat për gratë në komunitet.

Një nga momentet më të rëndësishme të punës së Florës ishte mbështetja për themelimin e organizatave të grave pas korrikut 1999, veçanërisht për gratë dhe vajzat. Ajo kujton nisjen e kurseve të shkrimit dhe leximit në Skenderaj dhe Drenas. Ajo kujton me humor dhe mall, duke shpjeguar që aftësitë mësohen: *“Kur hyra në kursin e parë, takova vajza 15-18-vjeçare dhe i pyeta nëse ato dinin më shumë apo unë. I pyeta nëse dinin të gatuanin, të punonin në fushë, të qëndisin, dhe të gjitha më thanë po. Unë u thashë se nuk i dija të shumtën e këtyre gjërave, por se mund të mësonim bashkë”*. Flora ishte ajo që hodhi themelet e këtij përparimi, duke i përqendruar përpjekjet e saj në

fuqizimin e grave përmes arsimit dhe ndërgjegjësimit.

Në vitin 2000, ajo angazhohet në Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UNWomen), në atë kohë UNIFEM, organizatë që krijon dhe zhvillon programe për fuqizimin ekonomik të grave, mekanizmat gjinorë në nivel lokal dhe kombëtar, dhe dhunën në baza gjinore. Ajo rrëfen një rast kur një propozim nuk përputhej me nevojat reale të komunitetit. “... ju thash që projektin do e bëjmë në 6 fshatra, ku do të mbledhim forumet grave dhe ata do të vendosin kush do të përzgjedhet. Me përfundim të trajnimit ato do të fillojnë të menaxhojnë kosheret e tyre dhe kjo iniciativë do shndërrohet në një biznes”. Kjo ishte qasja e cila e shndërroi plotësisht procesin e planifikimit të projekteve me bazë në komunitet.

Koncepti i “Grave në Siguri” ishte ende i panjohur për Florën, një fushë e re për eksplorim. “Aty ku je, duhet të mësosh sa më shumë dhe nuk duhet të presësh që dikush tjetër të bëjë diçka”, thekson ajo teksa rikujton sesi konceptet e para gjatë bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare ishin ende të reja për të gjithë. Flora ka një përvojë prej 33 vitesh në fushën e të drejtave të grave, prej të cilave 18 i kaloi si shefe e zyrës së UN Women në Kosovë. Puna e Florës luajti një rol kyç në avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në Kosovë, veçanërisht përmes përfshirjes së saj në hartimin e strategjisë së parë për barazinë gjinore në vend. Kjo strategji jo vetëm që vendosi themelet për mekanizmat qeveritarë që ekzistojnë edhe sot, por gjithashtu hapi rrugën për adresimin e të drejtave të grave në kontekste pas-konfliktit.

Udhëheqja e Florës, si përgjegjëse për Paqe dhe Siguri për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, ishte gjithashtu thelbësore në zbatimin e Rezolutës 1325 të OKB-së. Gjatë viteve, Macula bashkëpunoi ngushtë me institucionet qeveritare, sistemin gjyqësor dhe shoqërinë civile, duke dhënë një mbështetje të rëndësishme për prokurorinë në trajtimin e krimeve të luftës dhe adresimin e dhunës seksuale gjatë konfliktit. Ajo angazhoi ekspertë ndërkombëtarë dhe përfshiu prokurorinë dhe gjyqësorin në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe mobilizoi e aktivizoi gratë në politikë

dhe aktivistet për të drejtat e grave nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Puna e saj përfshinte gjithashtu avokimin për reparacione për të mbijetuarat e dhunës seksuale, duke mbështetur dhe misionin e Zyrës së Presidentes Atifete Jahjaga gjatë mandatit të saj.

Flora ka një mirënjohje të thellë për presidenten Jahjaga dhe punën e saj në këtë fushë. Ajo thekson se mbështetja e saj ishte jetike në avancimin e kauzës së të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës, duke forcuar institucionet dhe mekanizmat që mbrojnë të drejtat e grave në Kosovë. Për Florën, ky bashkëpunim ishte një nga momentet më të rëndësishme të karrierës së saj, duke ndikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të pashlyeshme në të ardhmen e grave në vend.

Me kalimin e kohës, përvoja e Florës u pasurua me sfida dhe arritje. Ajo kaloi nga pozitat operative në ato vendimarrëse, duke u përpjekur të balancojë jetën personale dhe profesionale. Ajo kujton me humor një rast kur u kthye në shtëpi gjatë ditës, duke shkaktuar shqetësim tek të tjerët. Flora falënderon bashkëshortin për mbështetje, pasi angazhimet e saj kërkonin përkushtim të plotë. Megjithatë, ajo thekson se përpjekjet për t'i rritur fëmijët ndërkohë që punonte ishin sfiduese. “Puna ka qenë pjesë e jetës time”, thotë Flora, duke shtuar se fëmijët rriten shpejt dhe koha e humbur me ta është e pakthyeshme. Një nga sfidat më të mëdha gjatë drejtimit të UNWomen në Kosovë ishte zgjedhja e angazhimeve ku duhet të ishte fizikisht prezente, pasi shpeshherë ishte e pamundur t'i mbërrinte të gjitha.

“Shpesh më thonin erdhi ky buldozeri (makina e punës), por mua nuk më interesonte. Unë vetëm doja t'i kryeja punët”, kujton ajo, duke theksuar se për të rëndësi kishin rezultatet, jo fjalët apo personat e përfshirë. Flora ka pasur gjithmonë parimin që të mbajë një integritet të lartë dhe të mos përfshihet në identitetet politike të kohës. “Gati të gjithë rrogën e jepja në terren” rrëfen ajo, duke theksuar rëndësinë e transparencës në ndihmën ndaj atyre në nevojë. Për të, angazhimi ekonomik dhe punësimi i grave ishte çelësi për fuqizimin e tyre.

Flora nuk eci vetëm, ku edhe sot e kësaj dite ajo është falënderuese për kontributin e ndihmën e atyre që e

shoqëruan. Ajo veçon dy mentore të rëndësishme, Osnat Lubrani dhe Joanne Sandler, për mbështetjen dhe udhëheqjen e tyre gjatë rrugëtimit të saj profesional. Udhëtimi nëpër shumë vende të botës i ka ofruar një perspektivë të gjerë për jetën, por është shoqëruar poashtu edhe me sfida të shumta. Një ndër to edhe ndarja nga fëmijët e familja, të cilën Flora tregon se asnjëherë nuk mund ta anashkalojë.

“Muajt e parë janë gjithmonë sfidues, por ndiej gjithmonë një kënaqësi të veçantë që kam pasur mundësinë të përjetoj kaq shumë pjesë të ndryshme të botës”, thotë Flora, duke vlerësuar secilin vend ku ka jetuar. Ajo përmend me admirim kulturën unike të Bangladeshit, forcën dhe rezistencën e grave dhe burrave në Ukrainë, si dhe bukuritë e pashoqe të vendeve si Jemeni, që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e saj.

Në vitin 2021, Flora u nderua nga UN Women në New York me çmimin prestigjioz “Arritjet më Inovative Individuale” (The Most Individual Innovative Achievements), një vlerësim që njohu përkushtimin dhe kontributin e saj të jashtëzakonshëm në fushën e fuqizimit të grave dhe zhvillimit të komuniteteve. Megjithatë, me thjeshtësinë dhe modestinë që e karakterizon, ajo thekson se ky çmim nuk është vetëm i saj. Flora deklaroi: “Nuk duhet ndarë ky lloj çmimi pasi këto arritje unë nuk kisha mundur t'i bëja vetëm”. Ajo beson se çdo sukses është rezultat i punës së përbashkët dhe mbështetjes nga ekipet e saj, bashkëpunëtorët dhe partnerët me të cilët ka punuar ndër vite.

Sot, edhe pse në prag të pensionimit, Flora vazhdon punën e saj me refugjatët e Sirisë në kampet e Jordanit, një vend që ajo e përshkruan si shumë të pastër dhe të bukur. Edhe pse malli për familjen dhe vendin e saj nuk është shuar kurrë, ajo me krenari tregon se ka pasur rastin të takojë gra kosovare edhe në këtë skaj të botës. Si një mesazh për vajzat e gratë, lexuesit e revistës ZA, Flora thotë se “solidariteti është gjithçka, dhe se duhet të ketë përkrahje mes nesh. E poashtu, asnjëherë nuk duhet ndalur, se në momentin që ndalesh do ecësh mbrapa për tre a katër hapa”.

za | burrat për gratë

Nuk është fare e thjeshtë të përcaktohet kufiri mes asaj që dijmë dhe asaj që nuk dijmë, sepse vizualisht, kjo nuk është bardh e zi, por në mes ka plot nuanca të hirta. Edhe pse është përdorur në kontekste të ndryshme, mund ta keni dëgjuar apo lexuar shprehjen: "*Ka gjëra që dijmë se i dijmë; ka gjëra që e dijmë që nuk i dijmë; ka gjëra që nuk dijmë që i dijmë, por ka edhe gjëra që nuk dijmë që nuk i dijmë.*" Kjo frazë referohet si në botën akademike ashtu edhe në atë politike për të folur mbi kompleksitetin dhe rrezikun e të panjohurave në siguri. Ish-ministri i mbrojtjes Donald Rumsfeld, në SHBA e tha këtë në vitin 2002. Kjo shprehje është relevante edhe sot, por me një përshtatje të vogël kur flasim për vajzat dhe gratë e Kosovës.


Ka gra që kanë kontribuar, dhe ne dijmë për to; ka gra që kanë kontribuar, por ne e dijmë që nuk dijmë për to. Ka gra që kanë kontribuar dhe nuk e dijmë që dijmë për to. Por, këtu është thelbi i ndryshimit: nuk ka gra për të cilat dijmë që nuk kanë kontribuar. Pse? Sepse edhe nëse ato janë kufizuar në rritjen e fëmijëve apo në ndihmën për familjen, kanë dhënë kontribut.

Historitë e pavdekshme të “Syrit të Tretë”

Duhet të kesh një zemër të fortë e dozë të admirueshme guximi për t'i dëgjuar rrëfimet e pavdekshme të Hazir Rekës. Rrëfimet e tij në celuloid¹ nuk mund t'i fshijë askush, ato janë të pashlyeshme për shkak se flasin për njerëz. Këto rrëfime të shtypura në fotografi janë zëri i popullit. Historitë që i ka portretizuar Haziri kanë udhëtuar në ballinat e mediave botërore. Ato janë referencë historike që kanë rrëfyer e dokumentuar rrugëtimin e shqiptarëve në kthesën e dekadave më të vështira të historisë së re të Kosovës.

1 Lëndë e fortë dhe e përkulshme, e ngjashme me bririn, që prodhohet nga celuloza dhe që përdoret për të bërë shiritat filmi, krehra, etj. (Fjalori i gjuhës shqipe).





NE KOSOVA

POLICIA SERBE

POLICIA SERBE
JASHTË
KOSOVËS!

STOP THE
POLICE-

PAQE

NË K

PEACE AND FREEDOM
IN

STOP THE
SERBIAN
TERROR!

PEACE AND FREEDOM
IN
KOSOVA

PO

SERBIAN POLICE-
KOSOVA
POLICE-
OUT
KOSOV

E DHE LIRI
KOSOVË

PAQE DHE LIRI



Fotografuar nga Hazir Reka

Fotografi i viteve të qëndresës së shqiptarëve të Kosovës tregon se shoqërimi i tij me aparatet fotografik nis me fillimin e viteve të 80-ta. Kjo miqësi me lentet ende vazhdon. E njeh atë lidhje në momentet kur e vëren Hazirin se si i sheh, si i kap dhe i trajton aparatet e tij fotografike e tij, me aq delikatesë mjeshtërore. Ai ende inspiron shumë fotografë të tjerë. Janë gjurmë të pashlyeshme në jetën e përditshme të shumë njerëzve në Kosovë.

“Puna ime me aparatet dhe fotografinë fillon në vitin 1982. Një vit më herët e kam pas fotografinë si lëndë profesionale në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në lëndën Bazat e Arsimit Teknik (BAT), kam pas profesor Fadil Gacaferrin...dhe... aty nisi një lloj pasioni për këtë praktikë artistike”, shprehet Hazir Reka, i cili tani si 63 vjeçar është tërhequr më shumë në studion e tij në fshat. Në këtë studio, Haziri e ka krijuar edhe një koleksion fantastik të aparateve fotografike, ku secili prej tyre e ka historinë e vet mbresëlënëse. *“Ka qenë*

e pamundur me punu si fotoreporter gjatë demonstratave sepse edhe për studentët edhe për policinë aparati ka qenë diçka tepër e ndijshme dhe rrezikshme”, shprehet ai për fillimin e viteve të 80-ta.

Ai rrëfen se dikur në vitin 1981 ka qenë dashur që t'i ndërpresë studimet për shkak të demonstratave të studentëve shqiptarë të Universitetit të Prishtinës. Studimet i kishte filluar prapë një vit më vonë, por fatmirësisht Haziri shumë shpejt fillon punën si fotoreporter e me këtë merr hov edhe pasioni i tij për të kapur tregime nga jeta e përditshme në rrugët e Kosovës. Në atë kohë, ai bleu edhe aparatet e tij të parë, Yashica-në e famshme.

“Në vitin 1983 kam filluar të punoj si fotoreporter i gazetës studentore “Bota e Re”. Ajo ka qenë një përvojë fantastike për mua si fotograf i ri”, tregon Haziri duke shtuar se kjo punë dhe cilësia artistike e fotografive të tij i hapi shumë dyer bashkëpunimi me mediat prestigjioze të ish-republikave jugosllave.

Në vitin 1985 ka filluar të punojë në revistën për të rinj *“Zëri i Rinisë”*, e përjavshme kjo gjerësisht e njohur tek të rinjtë kosovarë të asaj kohe. *“Njëkohësisht, prej vitit 1987 fillova të punoja edhe për revistat më të njohura sllovene, kroate e boshnjake e me fotografitë e mia ata u njohën më mirë, më drejtpërdrejtë me realitetin e jetës tek ne”,* shpjegon Haziri dhe shton se ishin ato vite kur filluan të dridheshin themelet e shtetit të atëhershëm. Epiqendra e këtyre dridhjeve ishte në Kosovë, më konkretisht në Prishtinë ku edhe nisi greva e minatorëve shqiptarë. Hazir Reka e di mirë këtë sepse aparati i tij i ka dokumentuar të gjitha këto ngjarje. Aparati i tij – legendari Nikon F3 – ka dokumentuar secilën ngjarje të rëndësishme në Kosovë prej vitit 1986 e këndej.

Ai rrëfen se me fillimin e luftërave në ish-Jugosllavi është angazhuar në agjencinë franceze *“Sigma”* për të informuar publikun evropian për dhunën që zhvillohej kundër shqiptarëve të Kosovës.



Fotografuar nga Hazir Reka

“Për pak kohë, me sugjerimin e disa miqve kam kaluar në agjencinë prestigjioze “Reuters” me të cilën kam qenë i angazhuar deri tash vonë”, tregon Haziri duke sqaruar se puna me këtë agjenci britanike i ka ndihmuar atij që të plasojë punën në shumë media të njohura botërore e të krijojë rrjet profesional që vazhdon edhe sot.

Hazir Reka thotë se puna e fotoreporterit ka kërkuar shumë vendosmëri për ta shfaqur anën shqiptare të tregimit për Kosovës. *“Pushteti okupues ka qenë shumë i ndjeshëm në aparat e kamerë sepse dëshironte të kontrollonte se çfarë pamjesh e fotografish po dalin nga këtu”, tregon ai.*

Gratë në objektiv

Në kontekst të intervistës, Haziri tregon se gratë e Kosovës kanë pasur gjithmonë fokus të veçantë në objektivin e tij, si

gjatë kohës së paqes por veçanërisht në atë të trazirave, protestave e luftës. Sipas Hazirit, veprimtaria e grave shqiptare prej fundit të 80-tave ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në shumë dimensione të jetës publike, në arsim, shëndetësi e në mobilizim të masave për të kërkuar drejtësi.

Haziri shpjegon se gratë shqiptare kanë pasur rol kyç në lëvizjet e 90-tave, e bile edhe në fundin e viteve të 80-ta duke përmendur gruan ikonë të ish-pushtetit vetëqeverisës të Kosovës e cila në një nga momentet kritike është ballafaquar edhe me njeriun që më vonë bota e njohu si *“Kasapi i Ballkanit”*.

“Desha ta përmend qysh më herët Kaqusha Jasharin, ajo ka qenë një politikane e jona mjaft e guximshme që nga fundi i të tetëdhjetave është ballafaqu me (Sllobodan v.j.) Millosheviqin, për

të drejtat e shqiptarëve”, kujton Haziri i cili e mban në mend edhe një takim të rastësishëm me të.

Haziri shpjegon se më 1986 e ka pasur rubrikën *“Syri i Tretë”* në revistën *“Zëri i Rinisë”* dhe në atë kohë përcillte të gjitha seancat në ish-Komitetin Krahinor të Kosovës. *“Në një moment, gjatë pauzës së seancës po më afrohet Kaqusha dhe duke qeshur po thotë se unë në seanca gjithmonë po nxjerr diçka interesant”, thotë Haziri duke shpjeguar se gjatë atyre seancave kapte delegatë duke u kotur apo me gisht në hundë. “Kur më shihnin aty me aparat gjithmonë kujdeseshin që të mos i kapja në pozitë të pakëndshme”.*

Ai tregon shkurt për disa nga protestat më të dhunshme ku ka qenë prezent, dhe shpesh herë ka qenë i rrezikuar me jetë. Haziri kujton edhe ditën kur senatori amerikan Robert Doll [Robert

Dole] vizitoi Prishtinën bashkë me një delegacion të lartë amerikan, atë ditë kur Haziri ka shkrepur njërin nga fotografitë më ikonike të qëndresës së Faik Rexhepit këmbëkryq në sheshin e Prishtinës kundër shumë policëve serbë. Sot, kjo fotografi është e rikrijuar në skulpturë dhe zë vend në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë, e kjo flet shumë për gjurmët që kanë lënë imazhet e shkrepura të Hazirit në kujtesën tonë kolektive.

Ai mban në mend edhe seancën e veçantë të ndryshimeve kushtetuese në ish-Kuvendin Krahinor kur edhe Kosovës ju suprimua autonomia. *“E kam përcjellë atë seancë kur edhe Kosova humbi autonominë. Kanë qenë aty të pranishëm edhe deputetë që nuk kanë pasur të drejtë vote, si ish-deputeti Hysamedin Azemi e plot të tjerë që janë sjellë aty nga sigurimi por vota e tyre është numëruar. Me ato vota janë bërë ndryshimet kushtetuese”,* kujton Haziri.

Ai mban në mend edhe ditën kur forcat policore e kishin arrestuar në Prishtinë dhe kishin dashur që t’ia marrin punën e asaj dite për të parë se çka ka fotografuar. *“Ka qenë një episod kur më kanë arrestuar para Fakultetit Filozofik, ku është tash katedralja katolike “Shën Tereza” dhe më kanë dërguar në stacion policor në lagjen Dardania. Më thanë se duhet me t’i marrë filmat, dhe unë duke bërë kinse nuk di asgjë për fotografimin menjëherë i hapa aparatet e mi dhe nga drita filmat u dogjën...ata nuk morën gjë”,* qesh ai duke shtuar se ai moment ka qenë shumë me rrezik sepse ka marrë kërcënime serioze. Po atë ditë, Haziri thotë se gjatë protestave të asaj dite policia serbe kishte arrestuar edhe Fehmi Aganin.

Ai i mban në mend edhe Edita Tahrin, Edi Shukriun, Flora Brovinën e Sevdije Ahmetin në krye të lëvizjeve të grave përgjatë viteve të 90-ta e sidomos në protestën legjendare ‘Bukë për Drenicën’ ku ka qenë i pranishëm. *“Përpjekjet e aktivizimi i këtyre grave e shumë grave të tjera ka qenë tejet vetëmohuese. Që nga fillimi i okupimit e përgjatë të 90-tave, gratë kanë dhënë më shumë se çka mund të imagjinohet”,* kujton ai duke përmendur edhe Nekibe Kelmendin si njëra nga gratë e shquara të lëvizjes së shqiptarëve për të drejta e pavarësi.

Reka thotë se gratë kanë qenë gjithmonë jashtëzakonisht mirë të organizuara, duke filluar nga fundi i viteve të 80-ta. *“Ka shumë gra që kanë protestuar vazhdimisht. Ka qenë një grua e moshuar, me gjasë i ka pas 72 apo 73 vjet, atë e kam shumë vjet të fotografime në shumë protesta të ndryshme, prej protestave të nënave në të 80-tat kundër*

vrasjes së fëmijëve të tyre në ish-Armatën Jugosllave e deri te protesta kundër masakrës së Jasharajve tek Radio Prishtina”, kujtohet ai. Shumicën dërrmuese të protestave të grave, duke filluar nga fundi i viteve të 80-ta, Haziri i ka përjetësuar me aparatën e tij dhe i ka botuar si dokumente të së vërtetës, ato janë fakte të kapura që dëshmojnë kontributin e grave në sigurinë dhe paqen e sotme.

Një moment që ai nuk mund ta harrojë është edhe dita kur forcat policore e vranë 16-vjeçaren Ylfete Humolli në fshatin Lupç afër Prishtinës në shkurt të vitit 1990.

“Kur është vra Ylfete Humolli kam qenë në spital me Blerim Shalën, kolegun e Zërit, edhe kemi pasë informacion, kemi shku si vizitorë. Kur kam hyrë brenda i kam futur aparatat nën jaknen e fërmerkës sepse ka pasur shumë policë. Brenda Ylfetja ka qenë e shtrirë në korridor, e gjujtun në ballë”, tregon ai se si më vonë me vështirësi kishte ikur nga spitali dhe kishte shkuar në redaksi për t’i zhvilluar filmat. *“Ka qenë një fotograf slloven në Kosovë i cili të nesërmen ka pasur të kthehej në Maribor dhe jam marrë vesh që atij t’ia lë fotografitë e zhvilluara para derës së banesës së tij në Prishtinë”,* rrëfen Haziri i cili thotë se pamjet e para të Ylfetes së vranë janë botuar në Slloveni me fotografitë e Hazirit. Kësë marifete për t’i ikur policisë – që sot përngajnë vetëm me skenat e filmave - kanë qenë një gjë e zakonshme në përpjekjet e përditshme për të treguar për padrejtësitë dhe dhunën sistematike që po ushtrohej ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Hazir Reka nuk është person që ka dëshirë të flasë shumë në publik, e nuk e shohim shpesh në intervista. Mjaftueshëm i flasin fotografitë e ato tregojnë se sa shumë gjëra kanë parë sytë e tij. Tani nuk përcjellë më ngjarje të përditshme dhe nuk e gjen më rrugëve të qytetit duke përjetësuar jetën e njerëzve si dikur. Tani, *“Syri i Tretë”* i është përkushtuar më shumë projekteve të tij personale për t’i dhënë jetë thesarit të tij arkivor. Për t’i ngjallur personazhet e tij nga ngjarjet e rëndësishme në kujtesën tonë. Këto ditë Haziri është duke përgatitur një ekspozitë fotografish nga koha e Grevës së Minatorëve më 1989 dhe është duke gurmuar njerëzit që i ka fotografuar para 35 vjetësh për t’i ftuar që të jenë pjesë e kësaj ekspozite. *“Kam lënë shenjat e mia në kohë dhe dua që këta njerëz të jenë bashkë me mua që ato kohë t’i kujtojmë bashkë, se bashkë e kemi bërë të pamundurën, atë që ka qenë e paimagjinueshme”.*



Kam lënë shenjat e mia në kohë dhe dua që këta njerëz të jenë bashkë me mua që ato kohë t’i kujtojmë bashkë, se bashkë e kemi bërë të pamundurën, atë që ka qenë e paimagjinueshme



Burimi, një rrëfim mbështetje dhe dashurie.

Edukata, mirësjellja, mishërimi i konceptit të ndihmës dhe solidaritetit, kërkesës mos me qenë lakmitar (në asnjë formë) janë një trashëgimi intelektuale nga prindërit e mi.

“Më së shumti jam ndjerë krenar, kur Rona ka ardhur në jetë. E kam pasur ëndërr që fëmijën e parë ta kem vajzë. Bashkëshortja ime Fatlinda ma ka dhanë atë kënaqësi”, kështu shprehet një baba krenar për lindjes e vajzës. Burim Karahoda, i lindur dhe rritur në Prishtinë, por me prejardhje nga qyteti i bukur i Prizrenit, ishte fëmija më i vogël i familjes. Në periudhën e fëmijërisë Burimi vlerëson dashurinë dhe sinqeritetin me të cilin prindërit e tij e rritën.

“Ajo që e karakterizon fëmijërinë time është një dashuri e sinqertë prindërore, e cila ka reflektuar dhe ka krijuar një lidhje të pakëputshme mes neve fëmijëve. Një përkrahje e vazhdueshme e të gjithëve gjatë rrugëtimit dhe zhvillimit tonë fëmijëror”, thotë Burimi me buzëqeshje duke përshkruar kështu raportin e shkëlqyer me prindërit e tij, teksa vë në theks rolin e veçantë të nënës së tij, nënës Emine. *“Nëna edhe pse amvise, ka qenë shtyllë e familjes, e dashur dhe gjithmonë me një aurë mbrojtëse”,* duke na bërë kështu të kuptojmë se kjo butësi dhe dashuri që vërehet në fjalët e Burimit është trashëgim i nënës Emine.

Shkollimin fillor, të mesëm dhe atë universitar Burimi i përfundoi në Prishtinë. Diplomoi në Fakultetin Teknik, në Universitetin e Prishtinës, si Inxhinier i Elektroteknikës. Rrugëtimi i tij i dijes nuk përfundoi me kaq. Vazhdoi një master në Greqi për Administrim Biznesi gjatë viteve 2007-2008, përvojë kjo që sipas tij *“është karakterizuar me një bashkëpunim të frytshëm dhe korrekt”.* Profesionin e tij nuk është një nga më të lehtët. A ka qenë ky profesion ëndërr e një burri që pa pushim përkrahë fëmijët e tij? *“Pas përfundimit të shkollës së mesme në vitin 1979, unë kam pasur interesim për të studiuar farmacinë. Por ky drejtim atëkohë nuk ka ekzistuar në Universitetin e Prishtinës, dhe dëshira ime për të studiuar farmacinë në Zagreb, për shkak të rrethanave të caktuara, mbeti e porealizuar”,* rrëfen për ZA-në Burimi, ndërsa vazhdon tutje rrëfimin duke shtuar, *“vendosa t'i përzgjedhja studimet në fakultetin teknik, pasi drejtimi i elektronikës ka qenë si profesion mjaft i kërkuar në atë kohë”.*

Dashuria e tij për të studiuar farmacinë nuk u realizua. *“Edhe pse unë nuk e kam kryer farmacinë jeta më ka lidhur pasi bashkëshortja ime e ndjerë ka qenë farmacistë”,* ajo po ashtu ka poseduar edhe dyqanin e saj farmaceutik dhe me përkushtim u kujdes për nevojat e pacientëve për më shumë se dy dekada.

Burimi na tregoi se Fatlinda ka qenë edhe profesoreshë e lëndëve farmaceutike në Shkollën e Mesme të Mjekësisë *“Dr. Ali Sokoli”* në Prishtinë.

“Mbi 17 vjet është përkushtuar ndaj edukimit të brezave të rinj të nxënësve”, rrëfen Burimi me krenari dhe me sytë e përlotur nga mallëngjimi teksa përmend bashkëshorten e tij të ndjerë Fatlindën e cila nuk ka ende një vit që ka ndërruar jetë.

“Kur jemi njoftuar, ajo ishte duke studiuar farmacinë në Beograd, dhe kam qenë edhe unë ai që e kam mbështetë në këtë drejtim, madje vitet e fundit të studimeve ajo i kreu derisa ishte shtatëzanë”. Është për tu admiruar mënyra se si ai flet me respektin dhe dashurinë më të pastër për bashkëdhënëtarën e jetës së tij, nënën e Ronës, Artit dhe Donit.

I qetë, i sjellshëm në bashkëbisedim, Burimi është mishërim i një fëmije, burri, babai dhe njeriu fisnik. *“Edukata, mirësjellja, mishërimi i konceptit të ndihmës dhe solidaritetit, kërkesës mos me qenë lakmitar (në asnjë formë) janë një trashëgimi intelektuale nga prindërit e mi”* shton më tutje Burimi.

Raporti i shëndoshë që ai ka gëzuar me prindërit e tij është padyshim arsyeja kyçe pse ai tashmë e gëzon të njëjtin raport me tre fëmijët e tij. *“Mbi këto parime fundamentale bashkëshortja dhe unë kemi mbështetur zhvillimin e fëmijëve tonë, ne i kemi mbështetur duke u ofruar atyre liri të jenë vetvetja dhe të zgjedhin jetën sipas mënyrës që e shohin më të përshtatshme”,* vazhdon të flasë Burimi. Por, sipas tij është me rëndësi që fëmijëve veçanërisht vajzave të mos iu mohohet liria dhe që të jenë vetvetja.

Burimi si baba i tre fëmijëve mbështetjen e fëmijëve e sheh si *“obligim biologjik dhe moral në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre”.* Ai thotë se *“prindërit në fakt e formojnë zhvillimin intelektual të fëmijëve të tyre duke filluar nga edukimi, monitorimi, bisedat e hapura të cilat duhen të jenë të sinqerta, ndihmesa për përkrahje në vendimet të cilat shpesh edhe mundën me qenë sfiduese”,* rrëfen për ZA-në.

Siç duket dashuria e Burimit për studimin e farmacisë ishte aq e pastër saqë përveç bashkëshortes këtë rrugëtim e ndjek edhe Rona, gëzimi i parë i Fatlindës dhe Burimit.

Rona, shkollën fillore dhe vitin e parë të shkollës së mesme i përfundoi në Prishtinë, për të vazhduar më pas rrugëtimin e saj të dijes larg Kosovës.

“Qysh në fëmijëri ka treguar dëshirë për shkencë natyrore dhe dëshirë që të mësojë dhe zhvillohet në rreth ku mundësohet nxënia e mësimi praktik dhe eksperimental”, shprehet Burimi. Dëshira e Ronës për dituri buronte pikërisht nga dy prindërit e saj, duke mos lënë anash as karakterin këmbëngulës të saj.

Në moshën 16 vjeçare, Rona filloi shkollimin dy vjeçar në Kolegjin Seaford në Mbretërinë e Bashkuar. Më pas përzgjedhi studimet në një universitet prestigjioz, *“Charles University”* në Pragë të Republikës Çeke. Rona ka përfunduar fillimisht studimet master në farmaci, e pastaj edhe studimet e doktoratës dhe tani është e punësuar si profesoreshë.

Largimi fizik i të vetmes vajzë në moshë të re nga familja ishte vështirësi në vetë për Burimin dhe Fatlindën. *“E vetmja formë komunikimi, për fat të mirë, ka qenë ajo që ka shfrytëzuar teknologjinë, për shembull i kujtoj bisedat e gjata dhe diskutimet që i kemi pasur për të gjitha çështjet të cilat e kanë preokupuar qoftë Ronën qoftë neve prindërit”,* shpjegon si e kanë luftuar largësinë fizike të vajzës së tyre.

Vajzat dhe gratë janë të zonjat e vetes dhe padyshim secila është e aftë që vetë të arrijë gjithçka, mirëpo është nevojë njerëzore e shpirtërore të marrësh përkrahjen e të dashurve tu dhe të tjerëve. Qoftë një fjalë e mirë, një përqafim, një *“unë besoj në ty”*, janë mbështetje të vlefshme drejt suksesit. Burimi këtë përkrahje nuk e ka kursyer asnjëherë. *“Natyrisht, meritat i takojnë Ronës pasi këtë sukses ajo e ka trasuar dhe arritur vet, janë rezultat i qasjes së saj profesionale ndaj kërkesave dhe detyrave të cilat i ka pas dhe i ka ende”.* Burimi, nuk harron së përmenduri dhe vlerësuar meritat e bashkëshortes së ndjerë.

“Mbështetja jonë ka synuar që Rona të ketë të njëjtat mundësi dhe kushte për të arritur potencialin e saj të plotë, pa marrë parasysh barrierat shoqërore”, kështu e sheh ai mbështetjen e prindërve. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për vajzat që t’i tejkalojnë këto barrierat dhe për të siguruar që ato të kenë mundësi të barabarta për edukim dhe karrierë.

Një burrë që i vlerëson thellësisht gratë, një bashkëshort i shkëlqyer që edhe pas nëntë muajsh nga ndarja e bashkëshortes së tij nga jeta, mban simbolin e kurorezimit të dashurisë së tyre, një unazë ngjyrë ari. Nuk mund të mos përmendet mënyra se si Burimi fliste për Fatlindën. Dukej se për të Fatlinda ishte ende aty. Për dashuritë e vërteta si të Burimit e Fatlindës, ndarja nuk ekziston.

Burimi ka arritur të formohet si një njeri i matur dhe i cili e kupton rëndësinë e rolit të tij, përveç një baba ai arrin të jetë shok dhe mentor për Ronën dhe dy djemtë e tij. I hapur për të diskutuar gjithçka, përkrahës i pakusht, ai çdoherë arrin të mbajë lidhjen mes tij dhe Ronës, të dashur e të afërt. Por, nuk rresht së respektuari personalitetin dhe identitetin e saj.

Baba i tre fëmijëve, burrë i përkushtuar, profesionist në fushën e tij, përvoja e jetës e ka mësuar Burimin shumë, por më e bukura nga të gjitha për të ishte ajo e rritjes së fëmijëve.

“Rritja e fëmijëve në parim është një proces i vazhdueshëm që përcjell me plot sfida dhe situata ndonjëherë të paplanifikuar. Për shkak të natyrës dhe karakterit të ndryshëm individual të cilat i kanë Rona, Arti dhe Doni, rritja e tyre për mua dhe bashkëshorten ka rezultuar me përvoja të ndryshme” rrëfen Burimi, por më e rëndësishmja për të është që *“si prind duhet përvojën jetësore ta transferoj në dobi të zhvillimit personal të fëmijëve, në ofrim të edukimit të vazhdueshëm për tu përballë me sfidat e jetës”.*

Ndonëse çdoherë indiferent ndaj miteve shoqërore që bëjnë ndasi gjinore apo në çfarëdo baze, dhe krejtësisht larg këtyre paragjytimeve, Burimi ka pasur rastin të përjetojë këto paragjytime përmes Ronës. Suksesi i saj, gjinia, e madje shpeshherë edhe prejardhja e saj etnike kanë qenë shkas për paragjytime. *“Në ato raste, ne gjithmonë i kemi ofruar mbështetje të pakushtëzuar dhe e kemi inkurajuar që të mos lejojë që këto situata ta ndikojnë atë negativisht. E kemi këshilluar që të fokusohet në arsyen pse ishte aty – për të mësuar, për të punuar dhe për të ndjekur ëndrrat e saj – dhe të mos lejojë që paragjykimet e të tjerëve ta pengojnë në rrugëtimin e saj, suksesi është përgjigja më e mirë ndaj të gjithëve”,* rrëfen Burimi se si e këshillonin Ronën.

Çdo prind padyshim u gëzohet sukseseve të fëmijëve të vet, ato janë përmbushje për prindërit. Ekziston si shprehje që diskriminimi i vajzave fillon në bark të nënës. Për Burimin krenaria më e madhe ka qenë fakti që fëmija i tyre ka qenë vajzë. *“Më së shumti jam ndjerë krenar atëherë kur Rona ka ardhur në jetë, e kam pasur ëndërr që fëmijën e parë ta kam vajzë”,* rrëfen me buzëqeshje e çiltërsi Burimi, *“po rrëqethem sepse ka qenë dëshirë e jemja, ka lindë në situatë të vështirë pasi ka lindë në vitin 1993, më kujtohet kur ka ardh motra në shtëpi dhe më ka thanë “A e ke dashurë çikën bre, ec me e pa se të ka ardh”.*

Kjo Rona, vajza që e gëzoi Burimin arriti të tregojë sukses të jashtëzakonshëm gjatë zhvillimit profesional dhe karrierës së saj. Ajo është shpërblyer me çmime nga më të ndryshmet për hulumtimet e saja shkencore, ka marrë medaljen e qytetit *“Hradec Kralove”,* dhe është shpërblyer si studentja më e mirë e diplomuar në Charles University, ndër të tjera.

Sukseset e tilla janë krenari jo vetëm për Burimin si baba por për çdo qytetar të Kosovës, pasi dituria dhe arritjet e qytetarëve janë disa nga ambasadorët më të mirë të Kosovës në botë.

Burimi është shembulli më i mirë i një burri, një bashkëshort dhe një baba si ai i duhet çdo familje. Dashuria, përkushtimi dhe çiltërsia e veprimeve të tij na dëshmon se ka burra që i duan dhe i vlerësojnë gratë, dhe mbi të gjitha shtojnë rrugën nëpër të cilën ecin ato gra.

Për Burimin ndarjet gjinore janë një mit jo i drejtë i shoqërisë. *“Prindërit nuk duhet në asnjë mënyrë me pas paragjykim në aspektin e pozicionimit pro-vajzë apo pro-djalë, por duhet të jemi modele të mira dhe të promovojmë barazinë gjinore në çdo aspekt të jetës”,* duke vazhduar më tutje se, *“mbështetja përfshin edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e djemve për rëndësisë e barazisë gjinore dhe respektit ndaj grave, që të krijojmë një mjedis të shëndoshë dhe mbështetës për të gjithë”,* përmbyllë rrëfimin e tij Burimi.

Nga një fëmijë që është rritur nën kujdesin e nënës Emine dhe mbështetjen e babait Xhafer, Burimi u formua si një bashkëudhëtar i dashur dhe mbështetës për Fatlindën. Edhe pse Fatlinda nuk është më me ta, ajo vazhdon t’i ndihmojë dhe t’i udhëheqë, sidomos Burimin, i cili ruan kujtimin e saj me shumë përlulesi dhe dashuri. Ai e mban atë afër zemrës së tij më shumë se kurrë. Burimi është babai i Ronës, Doktorëshës së Shkencave të Farmacisë, babai i Artit, Inxhinierit të Shkencave të Kompjuterike dhe Softuerike, dhe Donit, një student i Fakultetit e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Kjo është historia e Burimit, bashkëshortit besnik, përkrahës e të dashur të Fatlindës si dhe baba përkrahës që dashurinë nuk e kurseu asnjëherë. Ai i meriton të gjitha këto epitete. Historitë e tilla si të Burimit na tregojnë se sa e madhe është forca e dashurisë, qoftë ajo bashkëshortore apo ajo prindërore.

za | Faktet mbi Gratë në Paqe dhe Siguri (GPS)



Lauren Lowe

Agjenda e Grave, Paqes dhe Sigurisë (WPS), e miratuar zyrtarisht përmes Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (RKSKB 1325) në vitin 2000, shënon një moment kyç në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Kjo rezolutë bën thirrje për “pjesëmarrje të plotë, të barabartë dhe kuptimplote” të grave¹ në ndërtimin e paqes, negociatat e paqes dhe në proceset kyçe të politikave dhe vendimmarrjes. Rezoluta 1325 e KSKB-së përqendrohet në shtyllat vijuese: pjesëmarrja, mbrojtja, parandalimi (tri P-të: participation, protection, prevention) dhe lehtësimi dhe rikuperimi. Agjenda WPS (duke përfshirë rezolutat e mëvonshme) synon avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave dhe shërben si kornizë për gratë që të kërkojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre të barabartë në paqe, siguri dhe politikë. Agjenda WPS nuk do të ishte këtu ku është sot pa avokuesit e barazisë gjinore në shoqërinë civile dhe institucionet politike dhe të sigurisë, të cilët kanë qenë një forcë shtytëse në konceptimin, miratimin dhe zbatimin e saj të vazhdueshëm.

Përparimet dhe sfidat në Kosovë sot

Ndikimi i këtij katalizatori për ndryshim dhe barazi është veçanërisht i dukshëm në Kosovë, ku studimet e mia mbi rolet dhe kontributet e grave në ndërtimin e paqes, dhe rezistencën ndaj strukturave të dëmshme patriarkale, ka treguar rëndësinë e njohjes së WPS-së si një komponent integral për ndërtimin e një paqeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Duke qenë se vij nga Australia, kjo gjë ka formësuar përvojat dhe perspektivat e mia për paqen dhe sigurinë, nganjëherë të ngjashme por shpesh të ndryshme nga konteksti në Kosovë. Australia është zotuar të jetë “kampionet globale” në ruajtjen e Agjendës WPS,² dhe ka zbatuar strategji në të gjithë sektorët për të rritur numrin e grave. Pavarësisht progresit në Australi, çështje kritike si dhuna me bazë gjinore e minojnë sigurinë e grave dhe barazinë gjinore, ku 1 në 3 gra përjetojnë dhunë fizike dhe 1 në 5 përjetojnë dhunë seksuale nga mosha 15 vjeçare.³ Edhe pse Australia dhe Kosova janë larg njëra-tjetrës, asnjëra nuk është immune nga ndikimet e pabarazisë gjinore, dhe e nevojën dhe shtytjen për ndryshim e kemi të përbashkët. Më poshtë do t’i ndajë ca fakte mbi progresin dhe sfidat me të cilat përballlet Kosova 25 vjet pas luftës dhe 16 vjet nga pavarësia.

Paralufte dhe gjatë luftës në Kosovë kishte shumë njëanshmëri gjinore, ku gratë përballeshin me shtypje që bazën e kishte në gjini, përkatësi etnike dhe tipare tjera demografike. Hulumtimet gjithnjë e më shumë i kanë kushtuar vëmendje roleve të grave në luftimet e armatosura dhe lëvizjet e rezistencës civile, si dhe përvojat e tyre të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në

Kosovë.⁴ Megjithatë, këto role dhe përvoja shpesh anashkalohen, pasi përvojat e luftëtarëve meshkuj kanë marrë primatin në kujtesën publike, diskursin dhe sferat politike. Përderisa praktikatat e përjashtimit dhe heshtjes ndryshojnë ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë (pra, përkatësi etnike, (pa) aftësisë, moshës, e kështu me radhë), ajo që është e evidente është se gratë mbeten të anashkaluara dhe të marginalizuara nga proceset e paqes dhe sigurisë edhe përkundër miratimit të Agjendës WPS.

Fundi i luftës në Kosovë përkoi me miratimin e Rezolutës 1325, duke u bërë kështu një nga misionet e para paqendërtuese në kuadër të Agjendës WPS (edhe pse komuniteti ndërkombëtar shpesh është kritikuar për dështimet e veta për t’u angazhuar në mënyrë kuptimplote me gratë). Që nga pavarësia e Kosovës në vitin 2008, ka pasur zhvillime pozitive në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen politike të grave. Kjo përfshin, për shembull, zgjedhjen e dy presidenteve femra, shtatë kryetare femra në 14 Komisionet e specializuara të Kuvendit, afërsisht 25 për qind e ambasadorëve të Kosovës janë gra dhe kontributet e Edita Tahirit si Kryenegociatore e Kosovës në Dialogun me Serbinë. Megjithatë, pavarësisht këtyre përparimeve, ende mbeten sfida dhe pabarazi e madje edhe paragjykimet gjinore vazhdojnë. Për shembull, gratë përbëjnë një të tretën e Parlamentit aktual (33.3 për qind), i cili edhe pse përputhet me kuotën 30 për qind në Ligjin për Zgjedhjet Lokale, nuk arrin objektivat e pjesëmarrjes së barabartë në Ligjin për Barazi Gjinore.

Gjithashtu, ka nevojë për rritjen e numrit të grave në institucionet e sigurisë, ku vetëm 14.79 përqind e Policisë së Kosovës janë gra (shumica e të cilave janë shqiptare)³ dhe vetëm 11 përqind e rekrutëve të rinj në Forcën e Sigurisë së Kosovës në vitin 2021 ishin gra.⁶ Liderhipi mbetet i dominuar nga meshkujt, si në Policinë e Kosovës ashtu edhe në Forcën e Sigurisë ku gratë kryesisht kanë grada më të ulëta, ndërsa në sektorin gjyqësor gratë përbënin 34.5 përqind të gjyqtarëve në vitin 2023. Gratë gjithashtu kanë munguar në pozitave udhëheqëse në ekipet negociatore që nga koha e Edita Tahirit, dhe as nuk janë përmendur dispozita specifike që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë e grave në marrëveshjet e nënshkruara. Më tej, pak gra janë emëruar në pozita udhëheqëse në misionet ndërkombëtare në Kosovë që nga viti 1999. Goetz argumenton se “...gratë lidere nuk konsiderohen si pjesëmarrëse të vlefshme...” si rezultat i “...dominimit të meshkujve në institucionet ndërkombëtare, gjë [që përforcon] patriarkatet lokale...”⁷ Kështu pra, pavarësisht disa zhvillimeve, gratë mbeten në qoshe pasi institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe praktikat e sigurisë vazhdojnë t’i privilegjojnë burrat si zëra autoritar dhe ekspert për siguri.

Gjithashtu, paqja dhe siguria e grave po cenohet edhe nga dhuna me bazë gjinore, e cila mbetet një çështje kyçe në Kosovë. Mitrovica ndërmjet viteve 2021-22 ka shënuar rritje prej 34 përqind të rasteve të raportuara të dhunës në familje në krahasim me periudhën 2019-2020, ndërsa Gjakova ka shënuar rritje prej 12 përqind.⁸ Vetëm në periudhën janar-mars 2024, në Kosovë janë bërë 698 raportime për dhunë me bazë gjinore.⁹ Vrasja e dy grave nga duart e partnerëve të tyre brenda të njëjtës javë në prill të vitit 2024 nxiti protesta në mbarë Kosovën dhe rezultoi me shpalljen e Ditës Kombëtare të Zisë nga Presidentja Osmani. Edhe pse trendet tregojnë një numër në rritje të rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici, shumë prej tyre vazhdojnë të mos raportohen duke e bërë të vështirë identifikimin e plotë në lidhje me atë se sa e përhapur është dhuna ndaj grave, veçanërisht në komunitetet pakicë.

Në një kohë kur pasiguria globale është në rritje, Agjenda WPS është gjithnjë e më e rëndësishme për t’iu kundërvënë kërcënimeve të reja për paqen. Qeveritë dhe komunitetet ndërkombëtare duhet të riangazhohen për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin kuptimplotë të grave në proceset kyçe të vendimmarrjes dhe t’i mbështesin përpjekjet e shoqërisë civile për ta forcuar dhe mbështetur Agjendën WPS. Nivelet e larta të dhunës me bazë gjinore dhe pabarazitë gjinore të vazhdueshme janë rikujtim i nevojës për përkushtim të vazhdueshëm për avancimin e Agjendës WPS në Kosovë – dhe në mbarë botën – dhe për ta parë këtë agjendë si thelbësore në adresimin e sfidave me të cilat përballemi në një kontekst gjeopolitik që po ndryshon me shpejtësi. Megjithatë, pavarësisht sfidave të vazhdueshme, shumë akterë vazhdojnë të avokojnë pa u lodhur për një përfshirje dhe përfaqësim më të madh të grave, duke kërkuar që zëri i grave të dëgjohet dhe siguria e tyre të merret seriozisht. Përpjekjet e avokuesve të barazisë gjinore në shoqërinë civile dhe institucionet politike dhe të sigurisë janë një dritë shprese për zbatimin e tërësishëm dhe kuptimplotë të vlerave dhe parimeve të WPS-së, por edhe shpresë për të ardhmen e grave dhe vajzave në Kosovë. Megjithëse Australia dhe Kosova janë larg nga njëra-tjetra, të dyja mund të nxjerrin shumë mësimë të ndërsjella, duke pranuar se barazia gjinore dhe paqja dhe siguria e grave është një çështje globale që kërkon bashkëpunim, veprime të përbashkëta, dhe shkëmbim të përvojave.

Si studiuese e doktoraturës në fushën e Shkencave Sociale, unë fokusohem në kontributin dhe rolet e grave në ndërtimin e paqes në Kosovë, si dhe që paqja dhe siguria të jenë procese më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të ndryshme. Më është kërkuar të kontriboj me një artikull mbi faktet e WPS në Kosovë në këtë numër të revistës ZA, një temë që më intereson shumë për një vend që e kam përzemër. Pas kohës që kalova në Kosovë në fillim të këtij viti, u preka nga fuqia, motivimi dhe qëndresa e grave që avokojnë jo vetëm që zëri i tyre të dëgjohet, por edhe zëri i të tjerëve. Është nder të kontriboj në këtë çështje dhe të vazhdoj të mësoj nga përvojat e grave për paqe dhe siguri.

“Fakte mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë: Përparimet dhe sfidat në Kosovë” është shkrim nga Lauren Lowe. Lowe, studiuese nga Australia që e hulumton këtë temë në vendin e saj, ka zgjedhur Kosovën, po pra, vendin e vogël në Gadishullin Ballkanik, me qëllim të kërkimit të zërave të grave në Kosovë të cilat avokojnë për t’u dëgjuar. Australia e Kosova - dy vende krahasimisht të kundërta, e disi larg - por me një temë që i bashkon.



- 1 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së (2023) Gratë dhe paqja dhe siguria: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm. <https://digitallibrary.un.org/record/4024756?ln=en&v=pdf>.
- 2 Departamenti i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë i Qeverisë Australiane (2021) Plan i dytë australian i veprimit për gratë, paqen dhe sigurinë 2021-2031. <https://www.dfat.gov.au/publications/second-australian-national-action-plan-on-women-peace-and-security-2021-2031>.
- 3 Our watch (2024) Fakte të shpejta rreth dhunës ndaj grave. <https://www.ourwatch.org.au/quick-facts>.
- 4 Shih për shembull Chao 2020; Luci dhe Gusia 2015; Krasniqi 2021.
- 5 Policia e Kosovës (2023) Raporti i vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2023. <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2024/03/RAPORTI-I-PUNES-PER-VITIN-2023-ANGLISHT.pdf>
- 6 Dobranja D, Jahaj R dhe Loshaj J (2024) Analiza gjinore: Një pasqyrë e shumëanshme e drejtësisë gjinore në Kosovë, Friedrich Ebert Stiftung. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/21012.pdf>.
- 7 Goetz AM (2020) 'Parathënie: Drejt instrumentalizimit strategjik', në Basu S, Kirby P dhe Shepherd L (eds.) Drejtme të reja për gratë, paqen dhe sigurinë, Bristol University Press, f. xxiv.
- 8 Avdimetaj T (2022) Raporti fillestar mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë: Perceptimet e komunitetit dhe palëve të interesuara, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <https://qkss.org/en/publikimet/raporti-per-vleresimin-baze-te-dhunes-ne-baza-gjinore-ne-kosove-perceptimet-e-komunitetit-dhe-paleve-te-interesit>.
- 9 Hasani A (2024) Forcimi i mekanizmave parandalues ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <https://qkss.org/en/publikimet/strengthening-protection-mechanisms-of-gender-based-violence-in-kosovo>.

Za

ZA {shq}

Zëri është fuqi! Na e mundëson që të komunikojmë me të tjerët, të shprehim gëzimin, hidhërimin dhe të gjitha ndjenjat e idetë që kemi. Pavarësisht gjuhës apo mënyrës se si e komunikojmë, të gjithë kemi zë. Në raste të caktuara është zëri arsenali më i fuqishëm që e kemi për të shtyrë përpara drejt ndryshimeve që kërkojmë. Në këto raste edhe një zë i vetëm dhe i butë mund të bëjë jehonë.

ZA {srb}

E përkthyer në gjuhën shqipe, za do të thotë për. Kjo revistë është dedikim për të gjitha vajzat e gratë që përballojnë sfida e paragjykime të jashtëzakonshme dhe përkundër asaj qëndrojnë të forta dhe shërbejnë si shtyllat kryesore të familjes e shoqërisë. Është dedikim për të gjithë vajzat, djemtë, gratë e burrat që luftojnë për barazi dhe besimin e plotë në të drejta të barabarta e tregojnë përmes veprave dhe jetës së tyre. Për të gjithë ata që mundohen ditë e natë në të mirë të shoqërisë – jeni inspirim dhe shembull për ne. Ju jemi falënderues!